



*Kundroj qiellin me dy sytë e mi
teksa ai... më shikon me mijëra sy-yje...
jeta, herë mëndafshi, herë hekuri këmishë,
...shtigje, udhë, botë e botëkryqe...*

S U V E N I R

Diku në një botë tjetër...

... pikas të dyzuar veten ...

Nata e qetë pa hënë, por gjithsesi me yje të shndritshëm, e deti me valëza nanuritëse që i përkëdheleshin bregut disa hapa larg, ishin krejt e kundërta e asaj që ndodhte në shpirtin e gruas së lëshuar mbi rërë, ku re të zeza e të ngarkuara nxitonin e mblidheshin duke përgatitur stuhinë e paevitueshme. Parandjente diçka te keqe, e megjithëse përreth nuk kish frymë njeriu veç saj, ishte e ndërgjegjshme se ajo qetësi nuk ishte veçse ajo kohë e ngrirë pezull përpara se të fillojnë pikat e parae të shpërthejë stuhia. “Duhet të marr diçka më të fortë, kjo dozë nuk më bën më punë”. Nuk ishte e vjetër, por jo e re sa të mos e dinte se rinia të jepet një herë e pastaj të merret, kjo nuk ishte në dorë të saj. Për të tjerat... ato që kishte humbur, ose ato që mund ti humbiste një herë e mirë nëse do të vazhdonte kështu, kish qenë faji i saj. E famshme dhe e suksesëshme një kohë, kish filluar si topmodele në moshë të re e kish braktisur studimet, pastaj stiliste, mbështetur financiarisht nga i ati pasanik e pastaj i shoqi, por edhe famën e suksesin jeta ti jep me mundim e ti merr lehtë, gjithsesi nuk mund të jenë të përjetëshme. Ndërsa pjesa tjetër, ajo që i mbërthente zemrën në një morsë të pamëshirshme... O zot, si jam katandisur! Ndjeu erën të mërmëriste ndën peshën e disa hapave e brofi më këmbë.

- Putanë! - e pështyu ai,- i solle paratë?

- Jo,- tha me gjysmë zëri gruaja.

Burri e goditi me grusht në fytyrë, gruaja humbi ekuilibrin e u rrëzua.

- Të lutem mos!- rënkoj ajo.

Pa ja vënë veshin ulërimave të saj, e shkëlmoi i tërbuar derisa u lodh e ju muar fryma. Pastaj u përkul mbi të dhe e tërhoqi për flokësh.

- Shko e merrja tët shoqi!

- ***Nuk më jep!***

- Nesër mbrëma dua paratë ! E shkreta ti nëse nuk mi sjell këtu!

Ja zhyti kokën në rërën e plazhit e u largua. Gruaja priti derisa u zhduk në errësirë e u çua duke ju marrë këmbët. I gjithë trupi i dhimbte. Efekti i dozës që kish marrë po mbaronte dhe ajo kish nevojë për një tjetër. Nuk kish para, i kish mbaruar dhe kartat e kreditit ja kishin bllokuar. U fut në det. Uji me vakësinë e mbrëmjes sikur ja lehtësoi dhimbjet e ja kthjelltësoi mendimet. Do të shkonte në shtëpi, aq i bënte

se ç' do të thonin ata. Pastaj... e kish marrë malli për të vegjëlit, ata nuk e gjykonin, mjaft të ishte në shtëpi. Eshtë koha të kthehem, mendoj tek lante bërrylet e përgjakura. I shoqi, aq i bënte për të, ai ishte martuar me punën. Po ... si do t'u dilte përpara? Do të ishte më mirë... të zhytej e të mos dilte më? Do t'u vinte ndopak keqkur ta gjenin të mbytur? Përse duhej ta mendonte këtë, problemi i tyre. Këmbët e çuan më thellë e ndjeu ujin ti arrinte në brez. Sa e kish dashur detin. Ishte i madh, do ti bënte vend e do ta falte. Befas u ngrit një erë e fortë dhe ajo ngriti sytë drejt qiellit. Një njollë e shndritëshme si një sy i madh afrohej, e në qendër të saj një bebe zezë sterrë, vinte duke u zmadhuar. Dukej sikur gëlltiste edhe dritën e yjeve. E frikësuar rendi drejt bregut, por uji i ngadalësonte lëvizjet. Një vrungull ere epërfshiu dhe e ngriti lart. E tmerruar pa sipërfaqjen e detit që largohej me shpejtësi... nuk do të ishte varri i saj...

Në botën tonë... e njëjta kohë

...tek më mundon e njëjta gjëagjzë...

Ishte errësirë kur Era doli dhe mori makinën. Ku të ketë shkuar? Megjithëse mundohej ta largonte nga mendja, si një gozhdë fikse e torturonte dyshimi për kolegen e re të Mirit. E kish dëgjuar ta përmendte shpesh por nuk i kish dhënë rëndësi. Madje një ditë i kish thënë se kish shkuar t'i bënte disa punime hidraulike në shtëpi. E kish parë një herë atë grua dhe i ish dukur mjaft simpatike. Kish kaluar mesnata kur parkoi pranë pallatit të saj. Zbriti nga makina dhe kontrolloi emrat në targetën e shkallës. Vetëm mbiemrat dhe ajo nuk ja njihje. U kthye në makinë dhe priti e sulmuar nga një kundërshti ndjenjash. I vinte turp që rrinte aty e përgjonte të shoqin. Pas kaq vitesh martesë... Pa duart e saja të vyshkura e të lodhura nga puna e rëndë, orë e orë pastrimi nëpër shtëpira të huaja e mendoj se... edhe fytyra... Psherëtiu. Ik në shtëpi, i tha vetes, edhe po të jetë aty, më mirë të mos e shikosh.

Vendosi të largohej kur nga porta e pallatit doli Miri me atë tjetrën. Uli kokën, ai mund ta shihte e nuk i shpëtonte diskutimit të cilit befas ju trëmb, nuk dinte se ç'rrugë merrte e nuk donte ta humbiste të shoqin. I kaluan pranë pa e vënë re, të përqaftuar teksa ai i pëshpëriste në vesh e qeshnin mbyturazi. Hipën në makinë dhe u nisën. I ndoqi me kujdes e u tmerrua kur ndaluan para pallatit të saj dhe i shoqi

zbriti e u zhduk nëpër shkallë, ndërsa ajo u largua. Po tani? C'do të bënte po të hipte lart, sherr, shamatë, pastaj • c Ndezi makinën dhe u largua.

- & -

Një fill drite kish filluar të zbardhte horizontin, por ajo e pështetur pas parmakut të urës së madhe të qytetit, nuk e vuri re. Gjithshka sterronte. Ai ishte i dashuruar me atë tjetrën. I dashuruar. C • fjalë e madhe! Edhe ajokish qenë e dashuruar me të shoqin. Eshtë e vërtetë se në dashuri njëri fiton ndërsa tjetri humbet, e ajo kish humbur? Fëmijët... edhe ajri i shkaktoi dhimbje në mushkëri nga ky mendim. Andi nesër kish provimin e parë të universitetit... Elona... Fëmijët rriten, vënë krahë e shpejt do të marrin fluturim... Miri mund ta linte... ajo mund ta përzente... ai mund të rrinte... ajo mund t'a... falte... C'jetë do të ish ajo e saj, kur kuptimi që i kishte dhënë deri tani, brenda një momenti ishte bërë pluhur. Ndjeu shpirtin të transformohej nën presionin e dhimbjes, çdo ndjenjë e çdo ndjesi e bukur ju kthye në vrer e urrejtje. Më keq akoma, në mëshirë për vetveten e ky ishte kulmi. Të ishte katandisur deri në këtë pikë?! Je katandisur, dëgjoi një zë të brendshëm, ke falimentuar... si grua, si bashkëshorte ... ç'nënë do të jesh, ke më shumë helm se gjak në damarë...

U ngjiti mbi parmakun e urës. Le ta priste në shtëpi, le ta priste dhe ai turn i lodhshëm e raskapitës i mëngjesit. Një rreze e përgjakeshme agimi e pështolli dhe ajo vështroi një çast duart që dukeshin sikur pikonin gjak. Pa poshtë dhe ju morën mendtë. Kish dëgjuar se për sa kohë zgjat rënia, sheh gjithë jetën si në film. Befas era që filloi, e ndërgjegjësoi për budallallëkun që po kryente, në shtëpi e prisnin të bijtë. U kthye nga ana e urës dhe kërceu. Këmbët e saj nuk e cekën dyshtemenë e urës, ishte ende në ajër, kur një shkullm i fuqishëm e rrëmbeu dhe e rrotulloi në fillim ngadalë e pastaj fort e më fort, derisa humbi ndjenjat.

Një jetë tjetër

*...po të kisha marrë rrugën tjetër...
si do ta kisha pasur jetën...*

Zhurma e pulëbardhave e zgjoi nga gjumi dhe ajo e gjeti veten në një plazh të madh me rërë. Brofi më këmbë e pa rreth e rrotull. Tabelat e publiciteteve në gjuhën e saj edhe se nuk i thonin gjë, ai bregdet pa fund e bënë të kuptonte se nuk ndodhej më në atë qytet të huaj ku kish vite që jetonte, ndodhej në vendin e saj. Disa të rinj që po vendosnin çadrat e diellit e shezlongët, e flisnin në gjuhën e saj, ja përforcuan bindjen. Si kish ndodhur? Pyeti një vajzë të re se si quhej ai plazh dhe në ç'qytet ish. Vajza ju përgjigj duke e parë me kërshtëri nga këmbët deri tek flokët, duke qeshur ndën buzë. Ishte në qytetin e saj të lindjes dhe ky ishte plazhi i saj... ku ishte njohur me Mirin. I tregoi se ku mund të merrte autobusin e të kthehej në qytet. U drejtua për nga i tha vajza, e cila e ndoqi me sy një copë herë duke shtrembëruar buzët.

- Lina, - i thirri dikush, - çfarë ke?

- Asgjë, -tha ajo, - më duket se është ajo gruaja që ka disa muaj që po e kërkojnë. Nuk jam e sigurtë. E di se si janë ato fotografitë e gazetave, nuk dallohen mirë...

- & -

Doli në rrugë dhe u detyrua të bënte kujdes se trafiku ishte goxha i ngarkuar. Makinat që kalonin, ju dukën pak ndryshe, por nuk i dha rëndësi, kushedi nga i kanë importuar, fundja nuk ishte se merrte vesh shumë nga makinat. Gjeti pa mundim stacionin e autobusit dhe priti. Edhe mënyra e të veshurit të njerëzve i bëri përshtypje, ishin... të veshur pak si ndryshe, nuk ishte moda e këtij viti, as atij të mëparshmit, madje nuk ish në gjëndje të përcaktonte se cilës periudhe i përkisnin, easaj nuk i pëlqyen. Autobusi mbërriti e ajo hipi pa e fshehur admirimin, ishte komod dhe i ri. Unë budallaqja që ika në vend të huaj, mendoja se

nuk do të bëhej asnjëherë ky vend, është më i bukur nga sa e kam lënë e me sa shikoj, njerëzit jetojnë mirë. Ironi e fatit. Do të marr fëmijët e do të kthehem, le ta bëjnë shkollën këtu, Miri të bënte ç'të donte. Papritmas ishte bërë indiferente karshi tij. Faji ishte i saj që kish kaq vite pa ardhur e parë vendin e saj. Së pari do të shkonte në shtëpinë e saj, çelësat i kishte. I erdhi për të qeshur kur mendoi se ai fiks im që të mbante çelësat e shtëpisë së braktisur për vite të tëra në çantën e saj, tani po i hynte në punë. Autobusi ndaloi në qendër të qytetit. Zbriti pa jua vënë veshin shikimit të kalimtarëve. Ç'kish për t'u çuditur? Ish veshur ndryshe e asgjë tjetër. Qëndroi një moment duke parë rrotull. E kish të vështirë për t'u orjentuar. Përveç një ngjashmërie të lehtë, asgjë nuk ishte si më parë. Ndërtesat anash rrugëve dukeshin sikur ngjanin ndopak me ato që mbante mend, ato të vjetrat, por asnjë nuk ishte ashtu siç kish qenë. Filloi të shihte tabelat e emrave të rrugëve që niseshin nga qendra. Nja dy a tri emra ju dukën të njohur. Kaloi dhe nja dy kryqëzime dhe më së fundi mori rrugën që e çonte në rrugicën ku ndodhej shtëpia e saj. Do Zoti, gjej ujë dhe drita, mendoi kur kujtoi se herën e fundit... prit kur ka qenë, pothuaj dhjetë vjet më parë, mungonin. Edhe rrugica e saj kishte ndryshuar shumë. Sa ndërtime që ishin bërë... Tani duhej të ishte afër, nr 8, nr 9, nr 10, 11, 12, nr... ja dhe shtëpia e saj... Zemra i rrahu në krahëror, kish mall për atë shtëpi të hijshme të cilën gjyshi i Mirit e kish ndërtuar që në kohë të Italisë e materialet i kish sjellë që andej. Koha sikur e kish kursyer pa i bërë shumë dëm edhe se ishte braktisur. Nxorri çelësat nga çanta dhe nxitoi të hapte portën e oborrit. Celësi nuk hynte në bravë. E dëshpëruar ngriti kokën dhe gjaku i ngriu. Në ballkon pa rroba të sapo ndera. Vetëm atëherë pa emrat në targën e portës, nuk ishte as emri i Mirit dhe as i saj. Mendimi se dikush kish abuzuar e kish hyrë në shtëpinë e saj e zemëroi dhe ajo shtypi me forcë butonin e ziles. Dhe ai ishte ndërruar. U hap një dritare mbi kokën e saj dhe një fytyrë e qeshur gruaja u shfaq në të.

- C'kërkoni?- pyeti ajo buzagaz.

- Hape derën!- i briti me mllef.

- Kush jeni?

- Jam Era Kruja, e zonja e kësaj shtëpie. Hape derën!

Gruaja hyri brenda e mbylli dritaren. Priti se mos zbriste poshtë. Minutat kalonin e gruaja nuk po dukej duke e lënë të bluhej në vorbullën e mllefrit e zemërimit. Pas pak, dy policë me uniformë u gjenden pranë saj.

- Ejani me ne zonjë!

I pa e frikësuar e ngriti kokën në drejtim të dritares. Gruaja ish shfaqur në të e po e shikonte. Siç duket i kish thirrur ajo.

- Nuk kam bërë asgjë të keqe,- kundërshtoi Era,- ajo më ka grabitur shtëpinë.

- Ejani me ne, do ta sqarojmë në komisariat.

Pa e zgjatur, duke e shoqëruar për krahësh, e çuan tek makina e policisë që e kishin lënë në hyrje të rrugicës. E detyruan të hipte në të dhe u nisën.

- & -

Kur e çuan në polici, nuk ja vuri veshin rrugës. Të tjera mendime i zienin në kokë. I bëri përshtypje se nuk i kërkuan dokumentat. Silleshin sikur e njihnin dhe kur u tha se dyshonte se i shoqi kish shitur shtëpinë, filluan të qeshnin. Një doktor, i mori gjak dhe urinë për analiza. E lanë të priste vetëm në një dhomë të zbrazët. Kish hequr dorë, nuk fliste më. Ishte e kotë, askush nuk donte ta dëgjonte. Diku erdhi doktori me fletën e analizave në dorë, bashke me të edhe dy policët. Nuk kuptoi shumë nga ato që folën mes tyre. Dëgjoi doktorin që thosh se nuk kish gjurmë droge, se ishte vetëm pak konfuze e se nuk mund ta shtronte në spital. Pastaj ai doli ndërsa një nga policët e ftoi ta ndiqte pas.

- Ku do të më çoni? - pyeti ajo.

- Në shtëpi zonjë.

I ndoqi pas e nënshtruar. E gënjenin, nuk kishin se si ta çonin në shtëpi, nuk kish më shtëpi këtu, as atje. Banonte me qera. Por nuk kish rëndësi shtëpia, Andi me Elonën kishin filluar t'i mungonin tmerrësisht.

Makina lëvizte ngadalë dhe ajo shihte se sa shumë kish ndryshuar qyteti i saj, gati nuk e njihnte. Dolën nga qyteti e rruga mori drejt një kodre. Në krye të saj ishte një grup shtëpish të lezeçme me kopësht dhe vazo lulesh në dritare. Ndaluan para shtëpisë së fundit. Shtynë derën e gardhit që ish e hapur e i thanë të vazhdonte brenda, ndërsa ata ndaluan aty. Era qëndroi një çast mëdyshas, pastaj u nis me hap të dridhur. C'do të kish pas asaj porte, e kujt ishte ajo shtëpi e bukur? Meqë asnjë nuk i jepte spjegim, duhej ta gjente vetë. Forca, i tha vetes, zgjati dorën për të shtypur butonin e ziles. Dora i mbeti në ajër. Në targetën e portës ishte emri i saj dhe i Mirit. Zemra filloi ti rrihte me rrëmbim. Shtypi butonin dhe priti. Paspak dera u hap dhe Andi u shfaq pas saj.

- Andi! - briti ajo dhe desh ti hidhej në qafë.

Por Andi i përplasi derën në fytyrë. Policët u afruan dhe i ranë ziles. Andi u shfaq përsëri pa e fshehu ndjenjën e bezdisë. La portën e hapur kanat, u ktheu krahët e u fut brenda. Policët e ftuan Erën të hynte brenda dhe e shoqëruan deri në një sallon të madh ku ajo zuri vend mbi një kolltuk. Pas kësaj e përshëndeten e u larguan. Ajo filloi të shikonte përreth. Ora e murit trokiti dhe ajo vuri re se ishte një e drekës. Cdo gjë ishte e bukur, duke filluar nga llampadarët e deri tek tapetet. Dritaret ishin të mëdha e drita e diellit zotëronte cdo skutë të atij salloni. Bimë të bukura i jepnin

pamjen e një kopshti ekzotik. Bukur, mendoi ajo, por zemra nuk i ndillte asgjë të mirë .Përse Andi i kish mbyllur derën ashtu? Ku ish zhdukur? Po Elona? Mos jam në ëndërr? Pickoi krahun fort, dhimbja therrëse i tha se jo.

- & -

Kish mbetur aty ku e kishin lënë, me kokën ndër duar e përpiqej të kuptonte nga sa i kish ndodhur që nga momenti që kishte parë Mirin me atë tjetrën. E lodhur dhe e ç'orientuar siç ish, kish zënë të kotej kur ra zilja e derës. Dëgjoi portën që u hap, zërin e Andit dhe britma fëmijësh. Sa hap e mbyll sytë ju hodhën në qafë një vajzë jo më shumë se dymbëdhjetë vjeçe dhe një djalë rreth të dhjetave.

- Mami, mami!- thërriste vajza.

- Mami, u ktheve mami!- thosh djali.

Nuk dinte ç'të bënte se nuk i kish parë kurrë në jetë të vet. Kush ishin? Një gjë dinte me siguri, nuk ishte nëna e tyre. Cfarë po i kurdisnin? Mos ishte një lojë që Miri e të bijtë po i kurdisnin? Si nuk e kish menduar më parë? Dhe ajo ishte lodhur të gjente shkakun e gjithë këtyre gjërave të çuditëshme që po i ndodhnin. Ishte veç një lojë, lojë simpatike. I përqafoi, u ledhatoi faqet e flokët, u puthi sytë e shikonte se ç'gëzim u shkaktonte kjo atyre. Sa aktorë të mirë, mendoi, duhet të jem edhe unë në nivelin e tyre. Por vuri re se nuk kish nevojë të shtirej. Cdo gjë i vinte natyrshëm, dhe ndjehej çuditërisht mirë. Ata filluan ti tregonin se ç'kishin bërë në shkollë atë ditë ndërsa ajo i pyeti se ç'kishin ngrënë për mëngjes. Pastaj i folën për një mësues që i kish rënë djalit në qafë kot së koti, dhe se nuk e njihte mësuesin, i dha të drejtë djalit. Kish mjaft gjëra që nuk kuptonte nga ato që i thonin, por duke qeshur u vinte pas fijes duke i bërë të dukeshin ende më të kënaqur. Ta rregulloj qejfin Andi, tha me vete, herë tjetër përgatit dialogje më me kuptim. Befas në derë u duk Elona.

- Elona, shpirt i mamit!

- E solle kokën? Më mirë të mos kishe ardhur!- i briti ajo.

Mbeti shtang. Si guxonte t'i fliste ashtu? As mos ta çonte nëpër mend ta trajtonte në atë mënyrë, qoftë edhe për lojë. Shtërngoi nofullat e u bë gati ti fliste, kur djali i vogël kërceu e briti:

- Mos i fol kështu mamit!

- Bëri shumë mirë që erdhi , - sytë e dymbëdhjetëvjeçares shndrinin nga lotët që mezi i mbante.

Elona i hodhi një vështrim përbuzës që e bëri Erën të ndihej keq.

- Si gjithnjë shfrytëzon dobësinë e të vegjëlve. Prit se do të rriten dhe pastaj do të shohësh në do të të dojë më njeri në këtë shtëpi. I shkreti baba!- tha ajo dhe u largua.

Era e ndoqi me sy e me zemër të dridhur. Ishte vërtet lojë? Bija e saj që e trajtonte ashtu... këta dy të huajt e vegjël që nuk u dinte as emrat. Desh ti pyeste se si i quanin, por ndërroi mendje. Se mos do ti tregonin emrat e vërtetë...

- & -

Fëmijët u larguan e ajo mbeti sërish vetëm. Kushedi ç' surpriza e prisnin akoma. U çua e qëndroi para një pasqyre të madhe me kornizë të gdhendur bukur të varur në mur. I pëlqenin pasqyrat. Shëmbëllimi fytyrës së saj ishte i lodhur dhe flokët i kish si mos më keq. I erdhi për të qeshur kur mendoi se sa stononte me atë ambient. Pa të shohim pjesën tjetër të shtëpisë. Fundja ç'të keqe kish, ish pjesë e lojës. Doli nga salloni. Majtas, hapej një ambient i madh ndenjës me divanë, kolltuqë e një televizor të madh sa ajo më këmbë, vendosur në një faqe muri. Në fund ishte një kuzhinë e madhe ngjyrë mjalti me një tryezë të madhe buke e karrike shumë të lezetshme. Ishte plot dritë. U afrua e filloi ti prekte me gisht. Përkëdheli lulet që ishin nëpër vazo. Ambienti ish i huaj për të, por i pëlqente shumë. Nuk kish asgjë që mund të ish jashtë shijes së saj. Ju duk vetja si në një ëndërr të bukur. Po të mos ishte për ata fëmijë që nuk i njihje dhe ...

- Qënke kthyer?- dëgjoi një zë pas vetes.

U kthye me rrëmbim. Një vajzë që duhej të ishte pak më e madhe se Elona, qëndronte para saj. Dhe i ngjante, veç se ishte pak më e gjatë e me sy të kaltër. Po kjo, mendoi, ku e kanë gjetur?

- Mirë ke bërë, babai mund të të falë sërish, siç ka bërë herët e tjera. Sara me Dejvin të kanë kërkuar pa pushim.

- Sara me Dejvin!?- arriti të thoshte Era me një fill zëri.

Vajza filloi të qeshte.

- Cka ndodhur me ty mama? Nuk dukesh e njëjta.

- Ashtu!?

- Duket se këtë rradhë të ka ecur keq. Je veshur për faqe të zezë. Të mos flasim për flokët.

Era nuk dinte si ti përgjigjej. Një valë inati bëri ti skuqeshin mollëzat. Mirë që e vinin në lojë po dhe e ofendonin.

- Ku është Andi me Elonën?- pyeti ajo.

- Kanë dalë dhe do të kthehen vonë. Nuk duan të jenë këtu kur të vijë babai. Ata nuk duan që ti të rrish këtu. Këtë herë e ke dreqosur fare.

- Mjaft! Cfarë kam bërë sipas jush?- shpërtheu Era e inatosur.

Befas vajza shpërtheu në të qeshura.

- E bukur edhe kjo. Jo, ti nuk ke bërë asgjë. Ti je një ëngjëll mama!- tha ajo dhe mori të largohej.

- Eja këtu ti vajzë e pacipë! Kujt i flet ashtu?- ulëriu Era. Tash ish e nxehur e nuk donte ta vazhdonte më këtë farsë që i cingriste nervat. Ish koha ti thonin se ç'po ndodhte dhe ç'i kishin kurdisur.

- Nuk jam e pacipë! Le që, thënë nga ti, duket kompliment. Ka të drejtë Andi me Elonën! - vajza doli duke përplasur portën.

- & -

Prapë vetëm e nuk dinte ç'të bënte. Kontrollloi raftet e kuzhinës dhe pa se ishte e pajisur mirë dhe ushqimet nuk mungonin. Nuk kishte uri. Në frigorifer gjeti një shishe verë të ftohtë. Etje po, e mori dhe u ul mbi divan. Mendoi të ndizte televizorin, kish ëndërruar të kish një të tillë, por nuk e bëri. Filloi të pinte me gllënjka të vogla verën në shishe. Ishte e mirë, ndoshta e kishin ruajtur për ndonjë rast. Aq i bënte për rastet, do t'ja paguanin këto që po i kurdisnin. E piu shishen deri në fund teksa ndjente alkoolin ti rridhte i ngrohtë në deje. As që duhej ta vriste më mendjen. Shishja e zbrazët i rrëshqiti nga dora e ra mbi tapet. Aq i bënte edhe për të. I vinte gjumë. U shtri mbi divan e u ndie rehat. Sa gjumë që kish, muzgu kish filluar të binte ngadalë e të errësonte shtëpinë pa i hequr aspak nga bukuria. Ju duk vetja si në ëndërr. E përse jo, nëse nuk ish, le të vinte ëndrra e ta merrte në krahët e saj, mjaft të ish e bukur. Sytë ju mbyllën e krahë resh të praruara e pështollën dhe e ngritën lart duke i falur ndjesi qetësie e rehatie për të cilat kish aq nevojë...

- & -

Heshtje dhe errësi kur u zgjua. Ndezi abazhurin mbi tryezën e vogël pranë divanit e pa orën. Dontë dhe pak të shkante katër. Nga dritarja shqoi një vijë të zbardhej në horizont. U çua dhe filloi të kërkojë për një banjo. E gjetiaty

në koridor. Hyri brenda e pasi kreu nevojat lau fytyrën. Doli e mori shkallët që të çonin në katin e sipërm. Sa shtëpi e madhe, në të dy anët e koridorit, dyer të mbyllura. Filloi ti hapte me kujdes pa bërë zhurmë. Ishin dhoma gjumi. E para ishte eDejvit dhe ajo e kundroi një çast atë pafajësi feminare tek flinte dhe u mallëngjye. E dyta ishte e dhomës së Sarës. Mbylli derën ngadalë e kaloi tek tjetra. Elona, zemra i rrahu me rrëmbim e luftoi kundër instiktit që ta përkëdhelte, nuk e kish idenë se si mund të reagonte, e të lëndohej ishte gjëja e fundit që i uronte vetes atë çast. Dhoma tjetër ishte e vajzës që nuk i dinte emrin emrin, e cila megjithëse nuk ishte vajza e saj, diçka shumë familjare i endej tipareve. Andi, që kish filluar të merrte tipare burrërore. Zemra i gufoi, ishte djalë i mbarë. Por përse ja kish mbyllur derën në fytyrë? E priste gjithëherë buzëgaz dhe e puthte në faqe. Cfarë të ish e gjithë kjo, mos ndoshta ndonjë nga ato emisionet me kamera të fshehura? Ndoshta, në këte rastçdo gjë ishte e qartë. Do ta merrte vesh. Kish mbetur edhe një derë. Ajo e hapi ngadalë e ndenji mëdyshas. Të hynte? Pas asaj që i kish punuar ai, këmbët nuk i bënë. Megjithatë hyri dhe qëndroi pranë shtratit. Ai ishte aty, njëherësh i dashur dhe i urryer. C'të bëj, ta zgjoj, ti flas për atë tjetrën, ta përzë nga shtëpia apo..? U largua pa zhurmë dhe e la derën hapur. Një herë të merrte vesh se ç'po i kurdisnin, pastaj të vendoste. Zbriti shkallët e doli jashtë në oborr. Po agonte e ngjyrat e agimit i ngjallën optimizëm. I ra rrotull shtëpisë duke admiruar kopshtin e bukur. Pas shtëpisë dalloj një kolibe. Një qen i madh ngjyrë kanelle doli nga kolibja e filloi të lëvizte bishtin.

- Po ti këtu!? Si e ke emrin?- qeshi ajo me zë të ulët dhe filloi ta përkëdhelte. Qeni i lëpiu dorën .

- Eja me mua,- i zgjidhi zinxhirin dhe e la ta ndiqte në shtëpi.U ul mbi divan ndërsa qeni ju shtri pranë këmbëve. Të paktën ky më bën shoqëri, mendoj, pastaj ish aq i bukur. Nuk dinte për sa kohë do ta kish, me siguri të zotët do t'ja merrnin. Ndenji dhe pak e kur rrezet e agimit ndriçuan dhomën u çua. Duhej të merrej me diçka për të shtypur atë ndjenjë shqetësimi e ankthi që ju kthye. C'surpriza do ti sillte dita e re? Vuri një përparëse që e kish parë në një nga sirtarët e kuzhinës dhe i hyri punës për të përgatitur mëngjesin. Së shpejti do të zgjoheshin të gjithë.

- & -

- Mama, ç'të ka gjetur?- para saj qëndronte sërish vajza së cilës nuk ja dinte akoma emrin.Zemërimi ishte zhdukur nga ata sy.

- Mirëmëngjes, – i tha Era.

Vajza nuk ja ktheu pershendetjen. U ul në një karrige e pasi provoi një nga omletat filloi të qeshte.

- Për zotin mama, këtë herë largimi të ka bërë mirë. Ke mësuar të gatuash.

U zemërua tek dëgjoi këto fjalë, gjithnjë kish ditur të gatuante, si kish fytyrë e i thonte një gjë të tillë. Hoqi përparësen duke menduar se si t'i përgjigjej kur ndërkohë ja behu Elona.

- Aromë e këndëshme. Le ti provojmë këto që na ke gatuar.

- Mirëmëngjes Elona,- i tha ajo me ëmbëlsi, por edhe ajo nuk ja ktheu përshëndetjen. Erdhi Andi dhe ajo pat shpresë se ai do t'i thosh ndonjë fjalë të mirë.

- Mirëmëngjes Andi.

Ai bëri sikur nuk e dëgjoi, madje as që u ul. Zbrazti kafënë në një filxhan e filloi ta pinte më këmbë.

- Përse nuk ulesh bir?

- Nuk kam uri, – qe më shumë si një hungërimë që i ngriu gjakun Erës.

- Mami, mami! - zëri i Sarës e thërriti nga lart. Shikoi një çast Andin dhe Elonën sikur priste ti thonin diçka, por ata e injoruan dhe ajo filloi të ngjiste shkallët ngadalë. Deri kur do të duronte kështu? Nuk kishte as dëshirë dhe as durim për të vazhduar këtë lojë.

- Mirëmëngjes Sara, për çfarë ke nevojë?

- Oh mami! - Sara kërceu nga shtrati dhe ju hodh në qafë.

- Doja të sigurohesha se je ende këtu.

- Jam këtu, - befas ndjeu se vajza ishte e sinqertë. Sytë i kishte të shndritur.

- Më premtose se nuk do të ikësh përsëri.

- Nuk do të iki.

- Të kam xhan mami!

- Edhe unë, - ja ktheu padashur ajo.

Ndenji aty dhe e shikoi tek vishej. Pantallonat ishin të gjëra dhe bluza që vuri sipër nuk i shkante aspak me to, le pastaj xhaketa, por nuk foli. As se si ishin veshur të tjerët nuk i kish pëlqyer. I ish dukur fare pa gusto, por nuk ishte kjo që e shqetësonte. Kur Sara mbaroi së veshuri i tha të zbriste poshtë e të hante mëngjes.

- Do ta zgjosh Dejvin mami? Kohët e fundit është bërë dembel e mezi çohet nga gjumi.

U drejtua kokëulur për në dhomën e djalit të vogël e desh u përplas me Mirin në korridor. Shtangu dhe e shikoi drejt e në sy, por ai ju shmang shikimit të saj.

- Miri, mund të më thuash se çfarë po ndodh në këtë shtëpi?

- Duhet të ta them unë?- ndjeu nota zemërimi në zërin e tij.

- Kush tjetër?

Ai e vështroi me përcëmim, gjë që e lëndoi shpirtin e saj dhe i ktheu krahët duke zbritur shkallët.

- Miri!- i briti ajo nga pas,- Shiko, se ke për të ma paguar!

Nuk ktheu as kokën, gjë që e zemëroi më shumë e deshi ta ndiqte pas.

- Mami!- dëgjoi Dejvin ta thërriste e në nerva e sipër u kthye pas, t'i thosh një herë e mirë se nuk ishte mamaja e tij dhe duhej ti jepte fund asaj loje. Por Dejvi kish dalë nga dhoma dhe ju hodh në qafë.

- Mami!

Mbeti sërish pa fjalë, ai trup i vogël që nuk i arrinte as deri tek supi, ngrohtësia dhe ajo erë e mirë fëmije e zbutën.

- Dejvi, çfarë ke ,- ajo u mundua ta shqiste.

- Asgjë, jam i lumtur që je këtu.

- Atëhere vishu e zbrit poshtë. Po deshe të hash të kam përgatitur diçka.

- Vërtet mami? – sytë e djalit shkëlqyen.- Po ta kesh përgatitur ti, do të ha.

- Ja një fjalë me mend. Vishu tani.

Ajo mori të dalë nga dhoma.

- Rri me mua, të lutem! - sytë e tij ishin lutës.

U ul në një kolltuk të vogël në qoshe të dhomës dhe e shikoi tek vishej. Sa ngjante me Andin kur kishte moshën e tij. Kjo e bëri ti zgjohen kujtime të atyre kohëve dhe shpirti ju mbush me mallëngjim. Filloi të vërente me kujdes dhomën. Kishte makina, shumë makina të vogla. Edhe mbi komodinën e vogël pranë shtratit. Ish dhe një kornizë aty. Zgjati dorën dhe e mori. Shtangu. Aty ish ajo me Dejvin në krahë . Dhe pas tyre, në një tryezë ishte një tortë ditëlindjeje me pesë qirinj. Ku e kishin bërë këtë foto? Si e kishin bërë? Aty, ajo ishte më e re. Nuk kish mundësi të ishte e vërtetë, me siguri ishte një fotomontazh. Deri këtu të kishin arritur?

- Eshtë fotografia që më pëlqen më shumë! E kam hequr nga albumi dhe e kam vënë në kornizë. Elonës nuk i pëlqen që ta mbaj.- Dejvi kish mbaruar së veshuri e qëndronte para saj.

- Ke bërë mirë, - mezi u përtyp Era. - Ku e ke albumin?

- Në kutinë sipër dollapit. Nëse do ta shohësh, ta zbres kur të vij nga shkolla. Tani jam vonë, babi më pret .

E ndoqi poshtë ku gjeti Mirin me Sarën, të tjerët kishin ikur.

- Bobo! Jashtë!- briti Dejvi,- çfarë bën ai këtu, ty të bën alergji mami,- ai rendi drejt genit.

- E futa unë brenda.

- Je e sigurtë mami? Nuk ta kanë bërë për inat?

- Jemi vonë bir. Ikim!- dëgjoi ajo Mirin.

Djali ju hodh në qafë dhe e puthi, e pas tij edhe Sara që i pëshpëriti.

- Të kam xhan mami. Po të bëri alergji Bobo, ktheje në kolibe!- dhe vrapoi pas të atit. Mira i ndoqi me sy derisa makina u zhduk në kthesën e rrugës.

- &-

Ishte e hutuar. Nga duhej t'ja fillonte? Diçka duhej bërë përndryshe do të çmëndej. Po çfarë? Të dilte, të telefononte, po kujt? Kish vite që nuk kish ardhur aty dhe i kish humbur lidhjet me shoqet që kish pasur. Kushedi ku ndodheshin, me gjithë atë ndryshim që kishte vënë re, me siguri do të kishin ndryshuar adresë. Ra zilja e telefonit dhe ajo rendi drejt tij. Ishte Miri.

- Në sirtarin e parë të komodinës ke çantën tënde me dokumentat dhe kartat e kreditit nëse do të duhen.

- Miri...

- Nuk janë të bllokuara, mund ti përdorësh.

- Miri...

Po ai e kish mbyllur. Përplasi receptorin dhe shfryu me mllef. Veç të kthehej po do t'ja rregullonte qejfin atij maskarai të ndyrë që pasi e kish tallur duke ja dredhur me gratë e botës tani po e luante mendsh. Veç të kthehej, po kishte për t'ja thyer kokën. Rrëmbeu një nga pjatat që ishin mbi tryezë dhe e përplasi me sa fuqi kish përdhe. Pjata u thërmua, e ciflat e goditën në duar e fytyrë. Mirë që kish të veshura ende xhinset që e mbrojtën nga këmbët. Rrëmbeu një pjatë tjetër kur nga pas dëgjoi një zë të ndrojtur gruaje.

- Mirëmëngjes!

U kthye me rrëmbim. Një grua që ju duk rreth të tridhjetave, e shikonte e habitur dhe e frikësuar.

- Po ti? Cfarë bën këtu? - i shfryu me inat.

- Atë që bëj çdo ditë.

- Hyn përditë në shtëpi të huaja pa lajmëruar?

Vuri re se habia e gruas vinte e rritej dhe kjo ja bëri qejfin. Mirë, tha me vete, nuk e njoh dhe nuk më bëhet vonë fare se kush është. Vetë më erdhi në shteg, do ta bëj të më paguajë për çfarë kam kaluar këto orë.

- Tani do të lajmëroj policinë dhe do t'u them se ke hyrë për të vjedhur.

- Zonjë, të lutem...

- Mos u lut hiç se nuk dëgjoj nga ai vesh. Shko e u shpjego atyre se ç'bën këtu në pikë të mëngjesit...

- Zonjë...

- Dhe mos më thuaj zonjë! Ulu aty dhe prit sa të vijë policia, ndryshe, të betohem se do të ma paguash shtrenjtë. - Era u afrua tek telefoni.

- Zonjë...

- Ose... - u mendua një çast, - ose më thuaj të vërtetën se ç'po ndodh dhe unë nuk e lajmëroj policinë.

- Nuk kam bërë asgjë të keqe zonjë. Bëj vetëm punët e shtëpisë.

- Vetëm kaq? Nuk ke bërë asgjë tjetër?

Gruas ju mbushën sytë me lot.

- Asgjë tjetër? - ngulmoi Era.

- Më fal zonjë, do të ta kthej fustanin që të kam marrë nga dollapi. Do të shkoja në një dasëm ...

- Fustanin!?

- Atë të kuqin. Nuk të kam luajtur gjë tjetër.

- Përse?

Gruaja nisi të qante, e për çudi dukeshin lotë të singertë.

- Më thuaj si ndodhi?

- Një ditë tek pastroja dhomën tënde të gjumit, hapa raftin. Kur pashë tërë ata fustanë të bukur, nuk i rezistova ngasjes për ti provuar. Pastaj kur mu nevojiti njëri...

- Këtë e dëgjova.

- E mora. Mendova se kur të ktheheshe do ta vija sërish në vend.

- Kthehesha nga ku?

Gruaja uli sytë.

- Nuk e di zonjë dhe nuk guxoj të bëj hamëndje. Janë folur shumë, por unë nuk merrem me thashetheme. Më kanë pyetur shumë vete por nuk kam thënë asgjë. Ti më njeh mirë, nuk të ka dalë as kaq nga unë, - gruaja tregoi majën e thoit.

- Përse, kishte kaq për të treguar për mua? - tha Era duke imituar xhestin e majit të thoit.

Gruaja vështroi sërish dyshemenë.

- Jo .

- Mirë atëhere, çdo të bësh tani?

- Punët e shtëpisë.

- Nuk kam nevojë, i bëj vetë. Ik tani se dua të rri vetëm.

- Po më pushon nga puna?

Era e shikoi në sy dhe pa atë ankth që e kishte provuar aq herë vetë dhe i erdhi keq.

- Jo. Më fal, po si të quajnë?

Tjetra e pa e habitur. Megjithatë u përgjigj me zë të përrulur si gjithë nevojtarët.

- Vera.

Vera? Nuk i thosh asgjë ky emër.

- Sa kohë ke që punon këtu?

- Dhjetë vjet.

Dhjetë vjet! C'paturpësi, një njeri që nuk e kish parë kurrë pretendonte se kish dhjetë vjet që punonte për të. Por fundja, nuk ishte faji i saj, e kishin detyruar të gënjente. Dhe kishin bërë mirë që ja kishin dërguar. Do t'ja nxirrte asaj, me grep, një e nga një... të tëra.

- Do të rrish, por vetëm me një kusht. Punët do ti bëjmë bashkë. Jam pak e çoroditur dhe shumë gjëra nuk i mbaj mend. Unë do të të ndihmoj në punët e shtëpisë dhe ti do të më ndihmosh të rifreskoj kujtesën. Dakort?

- Dakort zonjë. Nesër do të të sjell fustanin.

- Ta kam falur.

Një buzëqeshje e lehtë ndriçoi fytyrën e merakosur të Verës.

- Ju faleminderit.

Erës i pëlqeu kjo buzëqeshje.

- Kur të mbarosh punë, shko e zgjidh ç'të duash. Mund t'i marrësh të gjitha.

- Oh jo! Nuk do të guxoja. Janë të kushtueshme.

Era filloi të qeshte. Të kushtueshme!? E çfarë pastaj, se mos i kish blerë ajo? Kush kish marrë mundimin për të shpenzuar ato para për të, le ti shpenzonte dhe për këtë grua që kish filluar t'i dukej simpatike. E ndjente se do të bëheshin mikeshatë mira.

- Atëhere bëjmë kështu. I ndajmë bashkë.

- E keni me të vërtetë? Nuk do të lajmëroni policinë?

- Policinë!?

Vërtet, kish qenë ide e bukur. Tundi kokën e ngjiti shkallët. Bobo e ndoqi pas.

- Bobo! - i thirri e alarmuar Vera.

- Lëre. Fillo të bësh diçka këtu poshtë e unë po vë rregull lart. Pastaj mendojmë ç'të gatujmë për drekë.

- Do të drekoni në shtëpi zonjë?

Mira u kthye dhe e shikoi se mos po tallej, por fytyra e saj ishte serioze.

- Do të drekoj në shtëpi, nëse kjo nuk të bezdis.

Ngjiti shkallët e inatosur. E bukur dhe kjo, të ha jashtë, e kur kështu? Me përjashtim të ndonjë ditëlindje apo përvjetori, kishin qenë shumë të rralla rastet që kish drekuar jashtë. Nejse, po e kapërdij edhe këtë, po nga t'ja filloj?

Nuk e pat vështirë të vendoste se nga duhej të fillonte. Hyri në dhomën e Dejvit e uli kutinë nga sipër raftit. Gjeti vërtet një album të bukur me kapakë të praruar. E rrotulloi një copë herë ndër duar pa e hapur. C'do të gjente aty brenda? Edhe pa e hapur e dinte se çfarë. Montazhe, fotomontazhe. E futi përsëri në kuti dhe e ngjiti lart. Rregulloi shtratin e filloi të rendiste lodrat. Poshtë një makine mbi komo gjeti një kartolinë. Nju Jorku, Manhattan. E ktheu nga ana tjetër e lexoi. "Dejvit me dashuri. Mami" Ishte shkrimi i saj. Si kish mundësi, nuk e kish shkruar ajo dhe aq më tepër nuk kish qenë asnjëherë në Amerikë. Pa datën, Shtator 2004. Ktheu dhe e pa sërish me vemendje kartolinën. C'gënjeshtër, të paktën të kishin qenë më të kujdesshëm me datën. Aty ishin dy kullat binjake të cilat ishin fshirë nga faqja e dheut që më 2001, pas atij sulmi të tmerrshëm terrorist ku kishin humbur jetën mijëra njerëz të pafajshëm. Mori kartolinën dhe e futi në xhepin e pantallonave. Jua tregoj unë qejfin atyre. Doli nga dhoma por u kthye sërish. Ish më mirë të shihte dhe albumin. Zbriti përsëri kutinë poshtë dhe e nxorri. Nuk pati më asnjë çast mëdyshjeje. Edhe ti, kopuk i vogël, do të ma paguash, tha me vete ajo tek kujtoi Dejvin që i kish folur për të.

- & -

Kish mbetur aty përdhe, ulur këmbëkryq tek shfletonte e rishfletonte albumin. E gjente veten në çdo fletë të tij, me Dejvin e porsalindur në krahë, me Dejvin e Mirin. Si kish mundësi ti kishin bërë kaq origjinale. Emocione. Emocione përcillnin ato foto, shumë të përsosura si fotomontazhe. Pastaj ishin fotot e ditëlindjeve të Dejvit, dhe ajo shikonte veten e saj, viti pas viti, një grua gazmore dhe e shkujdesur. Të kish qenë vallë kaq e shkujdesur në jetë të vet? Ishin dhe të tjerët në to, Andi, vajza që nuk i dinte akoma emrin, Elona, Sara. Diçka e madhe luhej, por çfarë? Qëndroi tek fotoja e fundit. Dejvi që mbushte dhjetë vjeç, dukej qartë torta me dhjetë qirinj, ajo me Mirin, fëmijët e tjerë e... në sfond ishte një çift nuk dallohej mirë. C'rëndësi kish, nuk i interesonin se kush ishin, por... Kish dicka shumë familiare, diçka që truri i saj i lodhur nuk e kuptonte. Mori një lupë që ishte mbi komodinë e shkoi pranë dritares. Jo! Nuk kish mundësi, nuk mund të ish... n!7na e saj dhe... ai burrë i ngjante shumë babait të saj, por... ai nuk ishte më, kish më se njëzet vjet që kish vdekur. Kujtimi i tij i mbushi sytë me lot e shpirti i dhëmbi.

Baba, foli me vete, baba i dashur sa më ke munguar. Kush të ka vënë këtu dhe përse? Kaloi gishtin sipër fotografisë duke përkëdhelur atë copëz të vogël. Do të ma paguajnë , u betua me vete, do ta gjej dhe do të ma paguajë shtrenjtë kush ma

ka bërë këtë. Hoqi fotografinë nga albumi dhe e futi me kujdes në xhepin e xhinseve që të mos e prishte.

- & -

Dhoma e Sarës ishte e qeshur e gazmore si dhe ajo vetë. Kukulla të bukura me flokë e fustane shumëngjyrëshe, perde e kuvertë në ngjyrë rozë të bukur që të kujtonin trëndafilë të freskët pranvere e një parfum trëndafili sundonte tërë atmosferën e asaj dhome të këndëshme. Cudi, si nuk e kish vënë re në mëngjes? Cdo gjë ishte në vend të vet, ndaj ajo rregulloi vetëm shtratin. Pastaj hapi dollapin e filloi të kërkonte nëpër skuta. Nuk kish kartolina dhe as fotografi. As sipër raftit nuk kish gjë. Vështroi rreth e rrotull. Hapi sirtaret e komosë dhe ajo në ngjyrë të trëndafiltë. Në cepin e sirtarit të fundit gjeti një kuti të vogël. E hapi dhe pa se ishin bizhuteri. I tërhoqi vëmëndjen një zinxhir i hollë, i artë ku ish varur një medaljon në formë zemre. Kish patur dhe ajo dikur një të ngjashëm me të, ja kish dhuruar Miri kur kishte lindur Elonën. E përfshiu kujtimi i atij momenti të bukur dhe e shtërngoi fort medaljonin, i cili nga presioni u hap. Ishin dy fotografi në secilën pjesë të brendëshme të tij, në njërin ish ajo dhe në tjetrën Sara. Ajo dhe Sara!!! Atëherë duhej të kish edhe fotografi të tjera. U përkul e vështroi ndën shtrat. Thellë, ngjitur me murin ishte një baule e vogël. U shtri mbi tapetin me lule, zgjati krahun e kapi dhe e tërhoqi. Nuk ishte gabuar, mes sendeve të tjera ishte dhe një album fotografish . U ul këmbëkryq mbi tapet e hapi albumin. Fotoja e parë, ajo me një foshnjë të porsalindur në krahë, pështjellë në pelena rozë ... Mbi pelena qëndisur me shkronja në formë lulesh "Sara". Albumi i shpëtoi nga dora...

- Ndjeheni mirë, zonjë?- Vera qëndronte më këmbë në derën e dhomës. E shikoi një copë herë pa ditur se ç'ti thoshte.

- Jam mirë,- i tha më në fund.- Mund të largohesh!

- T'ju bëj një kafe ?

- Po, të faleminderit.

Vendosi albumin në baulen e vogël dhe e varrosi përsëri nën shtrat. E ka rradhën dhoma e Elonës, mendoi. Po ta pikaste se i kish hyrë në dhomë, çdo t'i thosh? Ashtu si ishte sjellë këto dy ditë nuk mund të priste asgjë të mirë, ndaj u step para derës. Mëmirë po zbres e po pi kafenë një herë. Vera po e priste me tabaka në dorë ku kish vendosur filxhanin e kafesë që avullonte.

- Urdhëroni zonjë!- zgjati tabakanë.

- Ku e ke kafenë tënde?

Vera vazhdonte ta shikonte e habitur pa i dhënë përgjigje.

- Nuk e pi kafenë ti?

- Po zonjë...

- Mos më thuaj më zonjë. Më thirr Era.

Vera u përtyp. Shihej qartë se ishte në siklet.

- Vera, bëj një kafe për vete e eja ulu pranë meje ta pijmë bashkë.

- Nuk mundem zo..

- Era!- ja preu shkurt ajo.

Vera mbushi një filxhan për vete e u ul pranë saj.

- Je e martuar?

- Po.

- Ke femijë?

- Tre. Por ti e di, përse më pyet?

Era u mendua një çast. Kështu nuk arrinte gjë.

- Nuk e kam idenë se ç'po ndodh këtu dhe ç'po ndodh me mua. Le ta zemë se kam humbur kujtesën.

Vera bëri buzën në gaz. Ishte shumë simpatike kur buzëqeshte.

- Vërtet? Nuk mban mend gjë prej gjëje?

- Gjë prej gjëje.

- Kjo është serioze, prandaj ke munguar kaq gjatë këtë herë?

- Sa gjatë? - Era u mundua të fashitëte valën e zemërimit që e sulmoi papritur.

- Tre muaj.

Rrufiti kafenë. Tre muaj?! Bukur!

- Sara me Dejvin të kanë kërkuar përditë.

- Po Andi, Elona dhe...më fal po nuk po ja kujtoj emrin...

- Arbenës? Si ka mundësi të mos i kujtosh emrin.

- E shikon? Jam një rast i dëshpëruar.

Verës ju mbushën sytë me lotë.

- Më vjen shumë keq zonjë.

- Të lutem, më thirr Era.

- Era,- përsërit ajo me gjysmë zëri.
- Të kërkoj një nder. Më ndihmo.
- C'farë mund të bëj per ju?
- M'i thuaj të gjitha sa di për mua.

Vera e pa e tmerruar e ishte çuditërisht ngjitës tmerri i saj, mornica i përshkuan trupin.

- Të gjitha, të gjitha?

C'gjë të tmerrshme kish bërë, që kjo grua reagonte ashtu?

- Nëse nuk mund të mi tregosh të gjitha, të paktën... ato që mund të mi thuash.

Nxorri foton nga xhepi i pantallonave e ja tregoi.

- Ditëlindja e fundit e Dejvit.- psherëtiu e lehtësuar Vera.
- Dhe ky burrë këtu prapa?
- Eshtë babai yt. As ai nuk të kujtohet?
- Si ka mundësi që ishte në ditëlindjen e Dejvit?
- Sepse e lutën shumë të gjithë që të vinte, veçanërisht Dejvi me zoti

Mirin.

I hipi gjaku në kokë. Si kish mundësi ta gënjenin kështu? Kush ishte Dejvi? Nuk ishte as biri i saj. Po Miri, që kur kish filluar të ngjallte të vdekurit, mos ishte bërë vallë Jezu Krishti ? C'po ndodhte xhanëm. I erdhi t'ja përplaste turinjve filxhanin e kafesë kësaj gënjeshtareje të ndyrë, por e përmbajti veten. Nuk duhej të sillej ashtu nëse donte t'i fitonte besimin, ishte i vetmi person nga i cili shpresonte të nxirrte diçka. Vendosi ngadalë e me kujdes filxhanin mbi tavolinë e pa e parë në sy, i tha të ngjitej me të në katin e sipërm e ta ndihmonte të sistemonte dhomat . Vera e ndoqi pas e heshtur.

- & -

Kur mbaruan punë, u ul mbi divan e shkroi në një bllok gjithë ç'kish mësuar atë ditë. Emrat e fëmijëve, datëlindjet e tyre, shkollat, klasat që bënë, preferencat në të ngrënë. Vendosi në të foton dhe kartolinën duke bërë edhe shënimet përkatëse. Dalëngadalë ngriti kokë mendimi të mbante ditar e të shkruante për të gjitha sa i kishin ndodhur ditët e fundit, duke filluar nga çasti që kish hipur në makinë për të kërkuar të shoqin. Ndoshta të shkruarit do t'ja sistemonte mendimet

e do ta ndihmonte të dilte më shpejt nga ajo situatë. Nuk kish kuptuar shumë nga kontrolli që i kish bërë shtëpisë, AS nga Vera, sado që ish munduar ta gërmonte. Sa më shumë që e pyeste, aq më absurde e të pakuptimta ishin përgjigjet e saj. Zhurma e frenimit të rrotave të një makine i tërhoqi vëmëndjen dhe e shkëputi nga të shkruarit. Në më pak se dy minuta, Sara me Dejvin ju sulën dhe e mbytën me puthje e britma gëzimi. Futi bllokun poshtë një jastëku të divanit e u çua të merrej me ta. Nëse donin të loznin me të, edhe ajo do të qëndronte në lojë. Shtroi tryezën, e megjithëse nuk kishte uri, u ul të hante me ta. Ku i kishin gjetur xhanëm? Ishin aq të këndshëm dhe asaj i dukej sikur i ngjanin, madje kishin diçka edhe nga Miri. Kishin mbaruar së ngrëni, kur Andi u duk në derë. Nuk e përshëndeti e këtë herë nuk i foli as ajo. U ngrit dhe vajti lart në dhomën e gjumit që kish edhe një banjë me një vaskë të madhe. E mbushi e u zhyt në të. Uji i ngrohtë i dhuroi ndjesinë e qetësisë e plogështisë njëherësh. Fundja nuk ish edhe aq keq. Andi me Elonën ishin aty dhe ishin mirë me shëndet. Kjo i mjaftonte tani për tani. Edhe Miri ish aty, nuk e kish braktisur për atë tjetrën. Po ku zhdukej tërë ditën? Fundja aq i bënte edhe për të. Zoti bekoftë vaskën dhe ujin e ngrohtë. Gatipo dremiste kur dera u hap e Miri u shfaq në të, e sapo e pa u zpraps menjëherë.

-Miri!- e thirri ajo.

Dëgjoi hapat e tij që zbrisnin nëpër shkallë. Ik, tha me vete ajo, ik, po mos të të gënjejë mendja, nuk ke ku të më ikësh pa më paguar këtë që po më bën. Doli nga vaska dhe kërkoi në raftin e madh sa faqja e murit, diçka për të veshur. Fustanet ishin vërtet prej cohe të mirë, por asnjë nuk i pëlqeu. Nuk ishin të shijes së saj. Hapi raftin që zaptonte faqen tjetër të murit e ishin vendosur rrobat që duheshin të ishin të Mirit. Më në fund vendosi e mori një tutë në ngjyrë blu. E veshi. I rrinte e madhe. Përveshi mëngët e xhaketës, rrotulloi disa herë brezin e pantallonave dhe e mbajti veshur. Të paktën me këto ndjehej më rehat. Zbriti poshtë ku Sara me Dejvin po shikonin një film të animuar në televizor. E fiku televizorin pa jua vënë veshin ankimeve të tyre.

- Dalim e luajmë jashtë!- u tha ajo duke mbajtur një top në dorë. Prapa shtëpisë kish parë një fushë të vogël dhe një kosh basketbolli të fiksuar lart në mur. Fëmijët brofën të gëzuar e rendën pas saj. Bobo, i ndiqte pas duke luajtur bishtin e duke lehur.

- Do të luajmë me pikë. Kush del i pari do të flejë me Bobon, – kish vënë re se e kishin shumë për zemër. Ata ju sulën topit dhe ajo kaloi një pasdite të këndëshme me ta.

- & -

Nata ra shpejt dhe ajo ndjeu morsën e vetmisë ta mbërthente sërish. Të gjithë kishin shkuar të flinin në dhomat e tyre dhe qetësia sundonte shtëpinë. Edhe

Miri kish hipur lart, por asaj nuk i bëhej të hynte në atë dhomë e të flinte menjë burrë që nuk i hidhte sytë. U pendua për çmimin e lojës, Bobo tashmë po flinte në dhomën e Dejit, ndërsa ajo ishte vetëm. As qeni nuk mund t'i bënte shoqëri. Nuk mund të shihte as televizor, i cingriste nervat. Se nga i kishin sajuar tërë ato programeme emra të trilluar që as i kish dëgjuar ndonjëherë. Nxorri bllokun dhe filloi të shkruante. Arriti në një pikë ku nuk dinte ç'të shkruante më, mendimet i kish të turbullta.. Doli jashtë, ajri i freskët i profumuar nga lulet i mbushi mushkëritë. Qielli i bukur i fundpranverës e përshëndeti duke përshkëndritur yjet. Ishte aq bukur! Shqyrtoi me kujdes qiellin, duke lutur Zotin, me shpresë se mos i jepte ndonjë shenjë, por çfarë? C'priste të priste? Zotin nuk e kish parë asnjë, e megjithatë ajo i dërgoi disalutje. Ai duhej të ishte diku aty lart, por a kishte kohë të merrej tani me të? Po babai i saj ku ishte, në ç'anë të qiellit kish bërë fole shpirti i tij? Baba! Duhej të shkonte në varreza, të ndizte një qiri për shpirtin e tij e t'i çonte lule. Kish më shumë se dhjetë vjet që nuk kish shkuar në to. E vrau ndërgjegja e u ndie keq. kish lënë veten ta merrte përpara rrjedha e jetës atje, në dhe të huaj e nuk ish bërë mbarë të vinte këtu, qoftë edhe për ti bërë një vizitë në... Në mos nesër, një nga këto ditëdo të shkoj, ndau mendjen ajo. Bëri një lutje për prehjen e shpirtit të tij dhe sytë ju mbushën me lotë malli, tek kujtimi i dashur ju ul mbi valët e shpirtit e ja trazoi. Ajo po që ishte e keqe, një e keqe që nuk ndreqej më. Vdekja. Të tjerat rregullohengjithsesi dhe ajo nuk duhej të qahej. Burri dhe bijtë e saj ishin shëndoshë e mirë si molla. Të tjerat do të sqarohen e rregullohen. Hyri brenda e u shtri mbi divan. Nesër, me shpresë të Zotit, nesër... Nuk vonoi shumë dhe e zuri gjumi.

- & -

Dita në vazhdim, kaloi në të njëjtën mënyrë, dhe ajo ju nënshtrua fatit. Siç dukej kish një skenar të cilit duhej t'u nënshtroheshin. Nëse nuk ndodhte diçka jashtë rrjedhës së përditëshme, nuk mund të bënte gjë tjetër. E nëse i kërkohej të bënte vetëm këtë, ajo mund ta bënte më së miri. Ndërkohë pyeste Verën për zakonet e reja të fëmijëve e u mundua t'u përshtatej atyre. Paradite u morën me punët e shtëpisë dhe gatimin e drekës. Gatoi sipas mënyrës së vet, gjë që e çuditi Verën sepse nuk i njihnte ato receta, dhe u ulën për të ngrënë së bashku. Edhe se nuk ja mbushte syrin në pamje, shpejt u bind se Vera dinte ta luante për mrekulli rolin e saj. Shtirej sikur po bindej se ajo e kish humbur krejtësisht kujtesën, dhe dukej aq e sigurtë kur i rrinte pranë dhe e ndihmonte për ta rifituar...Ajo që e habiti shumë Erën ishte kur i tha se Andi nuk studjonte inxhinieri por mjekësi, se nuk ishte në vit të parë por në të tretin. Kjo, i spjegoi Vera, sepse kish hyrë një vit më i vogël në shkollë dhe shkolla e mesme ishte katër vjet dhe jo pesë. Arbena ndiqte vitin e parë

për informatikë. Të dy kishin më pak se dy vjet diferencë në moshë. Elona ishte maturante, Sara në klasë të shtatë ndërsa Dejvi në klasë të katërt. Parë kështu, ishte familje e bukur. I kërkoi Verës të zgjaste orarin e punës, por ajo i tha se nuk kishte mundësi. Pasditeve rrinte me fëmijët e saj në shtëpi se nuk kishte kush ja mbante.

- Merri me vehte. Punët i bëj vetë. Dua vetëm pak shoqëri.

Vera nuk dinte ç'ti thoshte.

- Do të ti paguaj ato orë. - zëri i Erës ishte lutës.

Vera u përtyp. Si mund të vinte e të rrinte këtu me fëmijët? C'do të thoshte i shoqi po ta merrte vesh se do të rrinte gjithë ditën me..? Po zoti Miri dhe fëmijët e Erës? Nga ana tjetër kish nevojë për para, e kjo do t'i mbyllte ndonjë vrimë në shtëpi.

- Nëse yt shoq nuk ka kundërshtim, mund ta provoj,- tha ajo me gjysmë zëri.

- E rregulloj unë këtë punë.- mori frymë e lehtësuar Era.

Sara me Dejvin u kthyen nga shkolla e ajo u muar me ta. Nguli këmbë të hanin gjithë ç'ishte në pjatë, pasi djali nuk kishte oreks dhe asaj ju duk i zbehtë. E kontrollloi se mos ishte i nxehtë e u qetësua kur pa se balli i tij ishte i freskët. Nuk e la të dilte në oborr të luante me Bobon, por e mori dhe shkuan në dhomën e tij.

- Duhet të pushosh pak, Dejv. Eja të të lexoj diçka.

- Do të rrish këtu me mua?

Nuk ju përgjigj. Mori një libër me përralla mbi etazherin që ishte varur në mur, nuk e njihnte autorin por kjo nuk i prishte punë. Djali filloi të qeshte, Bobo kërcëu mbi shtratin e tij.

- Janë përralla për të vegjël, mami.

Qeshi dhe ajo.

- Bëmë vend të shtrihem pranë teje, ti, burrë i madh. Dhe ngulite mirë në mendje, sado i madh të jesh, për mua je vetëm një fëmijë i vogël!

U shtri pranë tij dhe filloi të lexonte duke i përkëdhelur flokët me njërën dorë. Pas pak djalin e zuri gjumi dhe ajo mbylli librin. Kundroi atë fytyrë të vogël e të ëmbël. Kushedi si e ka hallin, mendoi. A i ka prindërit? Nuk duhej t'a linte vehten të afeksionohej shumë me ta, nuk ishte gjë e mirë. Një ditë do të iknin në shtëpitë e tyre dhe ajo do të ndjehej keq. Po sikur të mos kishin prindër e të ishin jetimë? E pushtoi një ndjenjë keqardhjeje. Atëherë, do të jetë biri im, do ta adoptoj dhe nuk do ta lë më të ikë e ta përdorin kështu. U ngrit me kujdes për të mos e zgjuar, e duke bluar këtë mendim doli nga dhoma. Tek zbriste shkallët, e befasoi mendimi, se thellë në shpirt e dëshëronte një gjë të tillë. Thirri Sarën e i tha të shkonte e t'i thosh të jatit se kish vendosur ti zgjaste orarin e punës Verës. Fundja, më mirë kështu. Nëse ai nuk donte t'i fliste, po mbyllej në studio ato pak orë që rrinte në shtëpi pas dreke, dhe ajo nuk do të përulej. Nuk ishte faji i saj që punët kishin marrë këtë drejtim. Le të përdornin korrierë.

Sara u kthye dhe i tha se babai nuk kishte kundërshtim. Në dhomën e ndenjes nuk kishte njeri dhe ajo u ul e hapi bllokun . Të shkruante dy rreshta deri sa të vinte Vera. Ndërkohë Sara duhet të bëjë mësimet, pastaj shohim e bëjmë.

- & -

Era ishte bërë qull në djersë e dihashte. Dhe unë, mendoi dua të matem me këta? Dësh ta linte lojën, por britmat e entuziazmi i tyre e bëri të ndërronte mendje. I pasoi topin Verës dhe e kapi gazi kur pa se asaj i shpëtoi nga dora. Tashmë ishin gjashtë, luanin edhe dy djemtë e Verës. Të tretin e kish në karrocë, e kishin vendosur aty në cep dhe ai ndiqte me sy lojën tek thithte biberonin. Ish pak më shumë se një vjeç, e sipas Erës, ishte një mrekulli e vërtetë. Një makinë e kuqe ndaloi para shtëpisë. Një vajzë tepër simpatike doli prej saj e u drejtua nga shtëpia. Era ndaloi lojën dhe e shikoi me shpresë se do t'i thosh diçka, por vajza i kaloi pranë pa ja hedhur sytë e pa e fshehur bezdinë që i shkaktoi shikimi i saj. Dësh ta ndiqte e ta pyeste se kush ishte e ç'donte aty por Vera ju afrua e i preku bërryllin.

- Eshtë Zana, e fejuara e Andit.- i pëshpëriti në vesh.

Këtë e mori vesh, po pse nuk i foli, kjo nuk durohej.

- Nuk flisni me njëra tjetrën, jeni zënë keq para disa muajsh, - dëgjoi t'i pëshpëriste përsëri.

Kur në derë u dha Andi që e priti krahëhapur dhe e përqafoi vajzën, e ndau mendjen të mos mendonte për këtë tani e ju kthye lojës. Kur nisi të binte muzgu , lanë lojën dhe ajo nxorri ca ëmbëlsira që i kish përgatitur vetë e lëngje frutash e u ulën mbi bar. Filluan të tregonin anekdota fëmijësh dhe ajo u tregoi një të vjetër nga koha e fëmijërisë së saj që i bëri të qeshnin të gjithë. Papritur, Elona u dha në derë të shtëpisë.

- Dejvi, gjyshi në telefon!

Djali brofi e u largua pothuaj me vrap. Gjyshi? Kush gjysh të jetë? Ndoshta babai i Mirit. E mendua një hop e i shkoi pas. Duhet të merrte vesh kush e kërkonte e përse. Urrente të spiunonte, por nuk kish rrugë tjetër. Hyri brenda e dëgjoi Dejvin të shfajësohej se e kish zënë gjumi e pastaj ishte harruar pas lojës. Diçka e thënë nga ana tjetër e telefonit bëri sytë e djalit të vogël të mbushen me lot.

- Më fal gjysh, nuk do të përsëritet më! - u përgjigj ai me një fill zëri. Erës ju dhimbs, kush i binte në qafë këtij vogëlushi, përse duhej ta trajtonin kështu? A nuk ishte mjaft që e detyronin të shtirej të luante këtë pjesë, që ç'ishte drejta e luante aq mirë sa... I rrëmbeu receptorin nga dora.

- Mami, mos! - briti djali.

- Kush jeni që i bini në qafë këtij djali? - gati sa nuk ulëriu.

Heshtje. Asgjë nuk pipëtiu nga ana tjetër.

- Në keni perëndi, më thoni kush jeni ose nuk keni për ta dëgjuar më! - vazhdoi ajo me zemërim.

- Jam unë! - ish një zë burri, i fortë e autoritar.

- Unë?! Cdo të thotë unë. Ka ndonjë që quhet unë?

- Jam yt atë, dreqi e mori. Dhe nuk dua të flas me ty. Më kalo Dejvin.

- As mos të të shkojë nëpër mend! Gënjeshhtar i ndyrë! - përplasi receptorin me inat.

- Mami! Përse e mbylle? - briti djali.

Mira u kthye dhe e pa me habi. Ai gati sa nuk po ja plaste të qarit. I ktheu krahët e doli. Vera kish hipur fëmijët në makinë dhe po e priste.

- Më trego pak këtë historinë e gjyshit! - i tha tek dridhej e tëra nga inati.

- Cfarë të tregoj?

U mendua një hop. T'i thosh se babai i saj nuk ishte më prej gati njëzetë vjetësh, dhe se dikush tallej në telefon apo...

- Ku mund ta gjej?

- Në këtë orë? Duhet të jetë ende në zyrë.

- Ku e ka zyrën? Më ç'o atje!

Vera e pa e menduar.

- Nuk më duket ide e mirë.

- Puna ime. Ti më ç'o, pastaj shohim nëse është ide e mirë apo jo.

- Andej e kam rrugën. Hip në makinë.

- & -

Do të shohë se ç'do ti punoj, thosh me vete, ndërsa makina rrëshqiste në rrugë të cilat ajo as që i vinte re. Do t'ja çerr maskën atij maskarai dhe gjithkujt tjetër që luan e tallet me kujtimin e babait tim e me ndjenjat e mia. Mjaft, nuk duroj më! Ziente e tëra nga inati kur makina u ndal përpara një ndërtese prej më shumë se dhjetë katesh.

- Nuk e di se në ç'kat e ka zyrën, mund të pyesësh aty brenda. Të pres këtu. - i tha Vera tek tërhoqi frenin e dorës së makinës.

Zbriti dhe qëndroi para ndërtesës. Lart, në krye, një tabelë e madhe me drita të ndezura që shndrinin, shkruante "KRUJA". Ishte emri i një qyteti, por ishte dhe mbiemri i saj i vajzërisë. Cilin nga të dyja përfaqësonte? Befas inati ju fashit dhe

një ndjesi frike e ndrojtjeje e pushtoi. Kati i parë ishte i tëri xham dhe ajo pa njerëz që lëviznin brenda. Muzgu që tashmë po i linte vendin errësirës, ja shtonte pasigurinë. Kush ishte aty brenda? Ju afrua portës së madhe prej xhami. Disa burra ishin duke dalëdhe... ajo mbajti frymën. Në mes tyre, një burrë me flokë jo krejtësisht të thinjura. U bë mënjanë e priti. Burri me flokë të thinjura i kaloi aq pranë sa gati e ceku me sup, pa e vënë re. Ja nguli sytë asaj fytyre e hipnotizuar, nuk mund të nxirrte asnjëtingull zëri. E shoqëroi me shikim tek u largua e ju afrua një makine, ku shoferi i mbante derën hapur. Befas, një burrë tjetër doli nga ndërtesa dhe thirri:

- Zoti Agron!

Burri me flokë të thinjura u kthye, e ajo u mundua të kapte shikimin e tij, i cili i rrëshqiti sipër pa u ndalur në të. Toka ju rrotullua dhe ndjeu se po binte duke humbur sensin e kohës. Dikush e thirri në emër dhe e shkundi fort. Hapi sytë dhe pa fytyrën e merakosur të Verës. Ktheu sytë aty ku më parë ishte makina dhe... rruga ishte e shkretë e pa lëvizje. O zot, më kanë bërë sytë. Gjithë faji i asaj telefonate.

- Të lutem, çomë në shtëpi!- u lut me një fill zëri.

- & -

Këmbët mezi e mbanin kur zbriti nga makina. Ishte vonë e Dejvi me Sarën, kishin rënë për të fjetur. Vetëm Andi ishte në sallë e ndenjes duke parë televizorin, por kur hyri ajo e shoi dhe u largua në heshtje. U lëshua mbi divan. Cfarë dite, mendoj, për të luajtur mendsh! Mori bllokun e nuk dinte nga t'ja fillonte. Pamja e atij burri i kish zgjuar mallin e kujtimin e babait, të cilin e kish dashur aq shumë dhe e kish humbur. Për ty baba, foli ajo me vete, e filloi të shkruante për atë kohë të largët, atë moshë të njomë, ato vite të bukura kur ai kish qenë shoku i saj, më i miri, më i dashuri dhe më i çmuari. C'nuk do të jepte ta shihte edhe një herë, një herë të vetme e të fliste me të. Ai burri i ngjante shumë, aq sa... Vërtet, ndoshta do të shkonte sërish, ta shihte që të shuante pak mallin . Ju kujtua se pas vdekjes së babait, kishte parë një burrë në qytet që i ngjante shumë. E kish ndjekur e kish mësuar se ku e kish shtëpinë. Shpesh, kur malli i digjte shpirtin, zinte pritë në cepin e rrugës ku banonte ai, e priste kur dilte nga shtëpia dhe e ndiqte një copë herë e i dukej sikur çmallej. Por edhe ai ka vite që ka vdekur, kështu që nuk mund të jetë ai. Po kush mund të jetë? Do të shkoj prapë, tha ajo me vete, do të shkoj, ta shikoj e... të shuaj pak mallin...

- & -

- Do të shkojmë në varreza, - e priti Verën të nesërmen në mëngjes, në rrugë, përpara shtëpisë

- Kur ?

- Tani – Era hapi derën e hipi në makinë.

- Do të shkosh kështu?- i tha Vera duke i treguar tutën që tashmë kish tri ditë që e mbante veshur. Nuk ishte bërë mbarë të kërkonte gjë tjetër, pastaj as nuk i pëlqenin ato rroba që ishin në raft. Ishin shumë të kushtueshme e të bukura, por nuk e shihte veten me to.

- E pastaj? Nuk ka asgjë të keqe.

Vera tundi kokën, ndezi motorrin dhe nisi makinën. Dita ishte e bukur e plot me diell. Në xhep kish dy qirinj që i kish gjetur në një sirtar të kuzhinës, ndërsa në dorë dy buqeta lulesh që i kish përgatitur nga vazot e oborrit. Arritën në varreza. Vurire se kishin ndryshuar shumë. Ishin të sistemuara mirë dhe të pastra. Herën e fundit që kish qenë kish zënë kokën me duar. Një skandal i vërtetë, varret kishin mbirë edhe në rruginat që shërbenin për të kaluar nga një parcelë në tjetrën, e shishet e plastikës e lecka të pista të përdorura për të pastruar varret, ishin të hedhura andej këndeje e të ngatërroheshin nëpër këmbë. Shto dhe lulet e vyshkura që hidheshin përtokë, të cilat zëvendësoheshin me lule të freskëta, të zgjonin një ndjenjë të thellë trishtimi. Hodhi sytë përreth dhe mori frymë thellë. Ky po, që ishte një vend që u bënte nder kujtimit të të vdekurve. Instiktivisht, këmbët e çuan në rruginën që merrte nga e majta ku ishte varri i të atit. Edhe se kishin kaluar vite, e dinte përmendësh se ku tihidhte hapat. Por varrin nuk e gjeti. Qëndroi aty e po e kërkonte me sy, me mendimin se ishte ngatërruar. Do ta gjente, ai e thërriste gjithmonë, me atë buzëqeshje të bukur e atë shikim të ngrohtë nga fotografia. Ishte e bukur ajo fotografi, dhe ajo e kish shumë për zemër, aq sa e mbante varur në murin e dhomës së saj të gjumit. Hasi shikimet e shumë fotografive, por nuk gjeti atë që kërkonte. Nisi të djersitej, ku ishte vallë, kush e kish luajtur prej andej? Mos loznin edhe me eshtrat e të vdekurve? Babai i shkretë, njeriu më i mirë që kish njohur, nuk kishte më as edhe varr. Sytë ju mbushën me lotë dhe e vrau ndërgjegja. Ishte faji i saj që nuk kishte ardhur më shpesh të kujdesej për të. Dhjetë vjet dhe ai ishte zhdukur. Ku të ishte vallë?

- Vera! Ku është varri i babait tim?

- Cfarë?! - ja bëri Vera duke zgurdulluar sytë.

- Lëri këto të lutem! Mjaft luajtëm bashkë. Të përgjërohëm, thuamë çka ndodhur me varrin e babait, dhe të betohem se nuk do t'i them askujt se më ke treguar. Nuk do të të hap telashe.

Vera u alarmua. Si ishte katandisur deri në këtë pikë? Që të kish humbur kujtesën, hajde de, edhe mund ta besonte, por që të kish alucinacione të tilla... Duhej të ishte e sëmurë dhe duhej çuar tek psikiatri. Ajo nuk duhej ta ndiqte prapa këtë të

çmendur. Ta merrte me të mirë e ta kthente në shtëpi. Duhej të fliste me zotin Miri. Le të kujdeseshin ata për të, nuk ishte detyrë e saj.

- Eshtë gjallë... babai yt është gjallë! - gati sa nuk briti ajo.

Era e kuptoi se ishte e kotë të këmbëngulte. Mori rruginën që çonte në parcelat më lart. Atje ishin gjyshi me gjyshen. Të shkonte e t'u ndizte një qiri atyre më parë, pastaj do ti ndante hesapet me Verën. Me zemër të dredhur hyri në parcelën tjetër të varreve. A do të ishin aty, apo dhe ato i kishin luajtur? Ja ku është gjyshi që më vështron serioz, po ajo e dinte se pas atij shikimi fshihej një zemër e butë dhe e dashur. Rendi drejt tij e përqafoi mermerin e lëmuar e të ftohtë. Po gjyshja? Kish qenë ngjitur me të. Ngriu më këmbë, në vend të varrit të gjyshes, një copëz e vogël toke mbjellur me trëndafilë të kuq. Ju prenë gjunjët.

- Ku është gjyshja ime, Vera? - fjalët i dolën me mundim.

- Eshtë në azil, - ja ktheu Vera, e cila dridhej nga tensioni e frika.

U kthye nga ajo dhe e pa drejt e në sy, ndërsa dridhej e tëra nga mllefi.

- Mos don të më thuash se edhe ajo është gjallë? Ke guximin të më thuash edhe këtë? Gënjeshtare e pafytyrë! - ju afrua duke mbledhur grushtet. Do ta bënte copë copë, do ta mbyste. Do ti fuste duart në fyt e për atë zot, do ta mbyste. Vera u zpraps e frikësuar, u pengua e ra mbi një varr. U vra nga përplasja e rënkoj ndërsa ndjeu e tmerruar duart e Erës që i shtërnguan fytyrën.

- Të lutem, mos më bëj keq! - ju lut.

Era mblodhi veten. C'i thosh mendja kështu, mos ishte faji i kësaj gruaje të varfër? Thjesht kish frikë t'i tregonte. Po i kish lënë edhe një shteg. I zgjati dorën dhe e ndihmoi të ngrihej.

- Më çu tek gjyshja! - e urdhëroi duke e parë drejt e në sy se mos kapte ndonjë shenjë hezitimi. Në të kundërt, gruaja mori frymë e lehtësuar e duke shkundur pluhurin dhe fijet e barit që i ishin ngjitur nëpër trup, nisi të ecte drejt daljes së varrezave me hap të shpejtë. E shokuar, Era e ndoqi pas. Hipën në makinë dhe u nisën pa folur e pa guxuar ta shikonin në sy njëra tjetrën. Një dhimbje koke kish filluar ta torturonte, i dukej sikur truri i ishte mpirë e bërë akull. Zuri kokën me duar e mbylli sytë. Po çmendej. Mos ishte në ëndërr? Diku, makina ndaloi.

- Arritëm.- dëgjoi zërin e Verës. Hapi sytë. Qëndronin përpara një ndërtese të këndëshme në ngjyrë të verdhë me tre kate, rrethuar me një mur të lartë. Pisha e plepa të gjelbër ngrinin krye mbi murin.

-Të pres këtu! - i tha Vera.

- & -

Ju afrua portës në mëdyshje dhe e trullosur. C'farë e priste pas asaj? Të hynte atje brenda apo të kthehej? Si mund të mendonte se do të gjente gjyshen? Veç

në e kishin ballsamosur e vënë në një arkivol qelqi si borëbardhën. Të hynte e të merrte vesh se deri ku... Shtypi butonin e ziles së bukur në formë zambaku. Në pritje që dera të hapej, lexoi tabelën e bronxit ku ishte shkruar “ AZIL SHPRESA ” . C’hipokrizi, kish punuar në azile pleqsh dhe e dinte se veç shpresë nuk mund të gjeje aty. Portën ja hapi një vajzë e re me pantallona e bluzë kazake në ngjyrë të gjelbër të bukur.

- Me çfarë mund t’ju ndihmoj?

- Kërkoj zonjën Kruja!.

- Më ndiqni ju lutem! - tha vajza duke buzëqeshur e duke parë me bisht të syrit tutën që kish veshur Era.

Hynë në ndërtesë e pasi kaluan një pjesë të korridorit, vajza hapi një derë që dilte në një kopësht të madh. E ndiqte duke zier nga inati, ky maskarallëk kalonte çdo parashikim. Të shohim, tha me vete, le të tallen edhe pak me mua, po do ta shohin. Fundjapërse janë avokatët, do të ma paguajnë shtrenjtë, do t’i kalb në burg këto putana e nuk do të më vijë aspak keq, do t’i ...

- Ja tek e keni, - vajza i tregoi me dorë një grua të moshuar, ulur mbi një karrocë, e cila dremiste nën hijen e një pishe. Nxitoi hapin, tani do t’ja rregullonte qejfin edhe asaj plake, që në vend që të rrinte e të shijonte pleqërinë në këtë vend të bukur, kish qejf të tallej me të. Ju afrua dhe ja kapi kokën fort me të dy duart dhe ja ngriti lart, e ndërgegjegjeshme se kjo i shkaktonte dhimbje asaj plake të gjorë, po aq i bënte. Do t’ja thyente kockat... Hasi shikimin e zemëruar të gruas së moshuar dhe duart ju lëshuan poshtë.

- Gjyshe?! - arriti të bëlbëzonte.

Befas, fytyra e shtrembëruar nga dhimbja u çel e sytë e zinj shkëlqyen si dy thëngjij të ndezur, ishin po ata sy, kujtimin e të cilëve e kish ruajtur thellë zemrës.

- Era, shpirt i gjyshes! Cfarë surprize! - zëri i dashur i trazoi shpirtin e ajo u lëshua në gjunjë dhe e përqafoi. Ishte era e gjyshes së saj që ajo e thithi me tërë forcën e mushkërive. Një shkulum dënesash ju ngrit nga shpirti e futi kokën në prehrin e saj e qau. Ndjeu dorën e dashur që i përkëdheli flokët. Mos ishte ëndërr, mos ish iluzion? Zot i madh, bëje të jetë e vërtetë!

- Do të kesh kombinuar diçka të madhe këtë rradhë . Mjaft, mos qaj, ti e di se nuk i duroj dot lotët e tua, shpirt i gjyshes. Do t’i rregullojmë bashkë. Hë de, fshiji tani e lermë të t’i shikoj sytë e bukur!

Plaka ja mori kokën ndër duar e i puthi sytë e përlotur. Kjo sikur ja thërmoi zemrën Erës. E la veten në duart e saj e shijoi çdo ledhë e përkëdheli si në ato kohë të largëta kur ishte fëmijë. Futi sërish kokën në prehrin e saj e pëshpëriti.

- Të kam xhan gjyshe!

- Edhe unë, shpirt i gjyshes. Por tani më thuaj, ç’hall ke?

C'hall? C'ti thoshte? Se kish shkuar në varreza për ti çuar lule dhe nuk e kish gjetur as varrin e saj dhe as atë të babait? Babai? Një fill shprese e marrë ngriti krye në shpirtin e saj të trazuar. Nëse nuk ishte në varreza... Brofi më këmbë.

- Do të kthehem prapë!

- Mire bijë, veç mos u vono shumë këtë rradhë. Nuk më ka mbetur shumë kohë.

- Do të vij sot!

Plaka vuri buzën në gaz. Hapi krahët dhe e përqafoi përsëri.

- Edhe po nuk erdhe, s'ka gjë. Të faleminderit për sot, ma bëre ditën më të bukur.

U shkëput nga krahët e saj e u largua me nxitim. Verën e gjeti aty ku e kishte lënë.

- Vera shpejt! Më çu tek babai!

Vera shkeli gazin. Tani po që gjërat po merrnin kuptim.

- & -

Rendi drejt portës së xhamtë e hyri brenda. Pas një sporteli, një burrë i ri në moshë, po fliste në telefon.

- Zyra e zotit Kruja? - pyeti Era me zërin që i dridhej nga padurimi.

- Kati i dhjetë, dera përballë në fund të korridorit. Keni takim zonjë? - Burri largoi receptorin nga veshi duke e parë me dyshim nga koka tek këmbët. Era nuk i ktheu përgjigje por rendi drejt dyerve të ashensorëve që i kish vënë re sapo kish hyrë. Për fat, njëri ndodhej në kat dhe dera ju hap shpejt sapo shtypi butonin, pasi burri i sportelit ishte ngritur dhe i ishte vënë pas. Dera e ashensorit rrëshqiti e u mbyll para fytyrës së tij dhe ajo dëgjoi të sharat që lëshonte në adresë të saj. Aq i bënte. Me padurim ndiqte numrat e kateve, 6,7,8,9, dhe ja ku arriti. Ashensori ndaloi dhe mezi priti të hapej. Doli pothuaj me vrap. Ja ku ishte, ishte shkruar në tabelën e derës " Ing. Kruja". Mbajti frymën, trokiti por nuk priti përgjigje. Uli dorezën e hapi derën me forcë. Dëgjoi të thirrura pas krahësh, por nuk ua vuri veshin. Në mes të dhomës, pas një tryeze të madhe, ulur në një kolltuk, një burrë me flokë gjysëm të thinjura ngriti kokën dhe e pa në sy. Zemra desh i çau krahërorin.

- Baba!- klithi e rendi drejt tij e ju hodh në qafë duke e përqaftuar me aq furi, sa desh e rrëzoi nga kolltuku. Ishte ai, aromën e tij nuk mund ta ngatërronte me asnjë tjetër. Sa i ishte lutur Zotit për një çast si ky? U dëgjuan trokitje dhe zërat burrash që kërkonin falje. Burri me flokë gjysëm të thinjura, e

kapi nga supet dhe e shtyu ngadalë duke u munduar të çlirohej prej saj. Më në fund u lirua e u bëri shenjë të tjerëve të largoheshin. Ata ikën dhe mbyllën derën.

- Mund të më thuash, përse kjo vizitë e papritur sot? - e pyeti ai dhe ajo kuptoi nga toni i zërit se ishte i zemëruar. Le të ishte i zemëruar, rëndësi kishte që ishte ai.

- Baba!- ajo desh t'i hidhej sërish në qafë por ai e shmangu duke u ngritur dhe shkoi e qëndroi përpara dritares duke i kthyer krahët. Zoti, më në fund, i kish plotësuar dëshirën më të madhe që kishte, ndërsa ai... e shmangte. U lëshua në një kolltuk që ishte aty pranë.

- Përse je zemëruar me mua baba? - pyeti ajo.

- Nuk e shoh të arësyeshme të të përgjigjem.

Shikonte shpinën e këtij burri, e përgjyruar. Ishte absurde, kjo situatë ishte absurde. Ai burrë, nuk duhej të ishte aty, duhej të ishte në varreza. Por ishte aty, njëzet vjet më i madh në moshë, por moshë nuk e kishte rënduar aspak. Vetëm flokët i kishte të thinjura. Gjyshja e kish ndjerë më shumë peshën e viteve. Rrinin në heshtje. Ai nuk donte ta dëgjonte, ndërsa ajo kish aq shumë për ti thënë. Për Andin, Elonën e bukur, dy bijtë e saj. Për jetën ...

- Sa do? - zëri ishte i ftohtë e autoritar.

- Cfarë?

- Para, apo jo?

- Para?!- briti Mira.

- Mos më thuaj se nuk ke ardhur për para!

E mbuluan djersë të ftohta. Përse e lëndonte kështu? Më mirë të mos e kish parë se sa i duhej të gëlltiste këtë poshtërim. U çua dhe ju afrua derës.

- Lamtumirë baba!- foli me lotë në sy.

Ai ktheu kokën drejt saj. Një rreze shprese ndriçoi skutat e shpirtit të saj të plagosur.

- Prit një sekondë! - ai ju afrua tryezës dhe nxorri nga sirtari një bllok. E hapi duke mbajtur një penë në dorë.

- Fol, sa do! Vetëm me një kusht. Bëji një telefonatë nënës tënde.

Nënës?! Nëna ka dhjetë vjet që është martuar me një tjetër e është atje larg... Ai firmosi dhe e shkëputi fletën nga blloku. Ju afrua me të në dorë, e Era me zor e mbajti veten që të mos i hidhesh në qafë sërish.

- Shifrën shkruaje vetë,- ai i zgjati fletën.

Pa një çast copën e letrës, sa para duhej t'i kërkonte që t'ja lante këtë poshtërim? A lahej me para?

I ktheu krahët e u largua duke e lënë me çekun në dorë. Dëgjoi që e thirri nga pas, por nuk e ktheu kokën. Nuk donte ta shikonte, nuk mund të ishte babai i saj, ndryshe nuk do ta kish trajtuar ashtu. Gëlltiti lotët. Ashensorët ishin të zënë, mori shkallët. Këmbët nuk e mbanin. Pasi zbriti dy kate u fsheh në një qoshe e shpërtheu

në dënasa derisa lotët i shteruan e nuk kish fuqi të qante më. Pas kësaj u ngrit e u zvarrit poshtë. Jashtë dielli shkëlqente e ajo shqoi Verën që e priste në makinë. Befas, ajogrua ju duk e afërt. Rendi drejt saj dhe e përqafoi fort. E befasuar, Vera nuk dinte ç'të bënte. Ngriti dorën dhe i përkëdheli flokët.

- Shshët! - i pëshpëriti në vesh tek e ndjente të dridhej, - shshët, çdo gjë do të rregullohet.

Dhe për çudi, kjo e qetësoi Erën. I hodhi një vështrim mirënjohës, e u rehatua në sediljen e makinës.

- Të falemnderit! - i tha.

Tjetra vuri buzën në gaz e ndezi makinën. Ish vonë, kish kaluar ora dy e drekës e fëmijët duhet të ishin kthyer në shtëpi.

- & -

Sara dhe Dejvi ju hodhën sapo zbriti nga makina dhe ajo perceptoi ankth në sytë e tyre. Një perde lëvizti në dritaren e sipërme, ishte Elona që e përgjonte.

- Keni ngrënë?- pyeti të vegjëlit.

- Bëmë ca panine mami, - tha Sara.

- Kemi rregulluar dhe dhomat tona, - tha Dejvi. Erës i ra në sy përsëri ajo ngjyrë e zbehtë e fytyrës dhe rrathët e errët poshtë syve të tij. Duhet ta çoj tek doktori, mendoi ajo, nuk më pëlqen kjo ngjyrë. I përkëdheli flokët dhe e puthi lehtë në faqe, gjë që i bëri të shndrisnin sytë e tij.

- Do të vijë ajo me fëmijët sot? - pyeti djali duke bërë me shenjë nga Vera.

- Ajo, quhet Vera, dhe unë dua ta thërrisni teze Vera!

Fëmijët u panë në sy një çast, por i premtuan se do ta thërrisnin si të donte ajo. Hynë në shtëpi dhe gjëja e parë që bëri, vuri Dejvin në shtrat e i lexoi librin me përralla derisa e zuri gjumi. Por nuk u ngrit nga shtrati. Fiksoi tavanin duke u menduar. Nuk po kuptonte asgjë. Mendimet, si një lëmsh leshi i ngatërruar keqas e ajo nuk mundej të gjente fillin. E duhej të ishte diku aty, ajo duhej ta gjente. Ku ta kërkonte? Në atë natë të gjatë pa gjumë tek kërkonte Mirin, e një turn i lodhshëm e priste nëmëngjes në atë azilin e pleqve? Apo tek ajo ura ku për pak ishte hedhur? Për pak? Me sa mbante mend, ishte hedhur. Por nuk kish rënë, nuk ishte vlarë, ajo era e fortë e kish rrëmbyer dhe e kish ulur ngadalë poshtë. Poshtë apo lart? Nuk

mbante mend asgjë, kish humbur ndjenjat. Dinte vetëm se ishte gdhirë në plazh. Kjo ishte ajo që kujtonte ajo se kish ndodhur. Kujtonte. Po sikur të mos kish ndodhur kështu? Po sikur të kish rënë e të kish vdekur? Atëhere ku ndodhej, në ferr apo parajsë? Ashtu siç e kish trajtuar i ati, Miri, Andi dhe Elona, nuk kish dyshim, ndodhej në ferr. Po ata të vegjëlit kush ishin? Engjëj të mirë që ja kishin vënë aty për t'i lehtësuar dhimbjet e ferrit? Po gjyshja? Të ish dhe ajo engjëll? Një grua aq e mirë si ajo, me siguri që engjëlldo të ishte shndërruar pas vdekjes. Dejvi lëvizi në gjumë e u kthye në krahun tjetër. I ledhatoi ngadalë shpinën e supet, e vuri buzën në gaz tek e imagjinoi me një palë flatra të vogla. Ishte një fëmijë i brishtë e normal. Vazhdoi ta ledhatonte lehtase ndjente ngrohtësinë që i transmetonte në gishta trupi i tij. I falte një ndjesi të embël që i mbushte zemrën, sikur të ish fëmija i saj. A mund të ishte i saj? Ah, jo! Vuri sërish buzën në gaz. Edhe se kjo botë ku jam zhytur është nga më absurdet, ku tëvdekurit nuk janë të vdekur, një nënë e mban mend fëmijën që lind. Eshtë një eksperiencë e dhimbëshme fizikisht, por më e mrekullueshme se çdo gjë tjetër. Siç është në të kundërt aborti që ta lë shpirtin bosh, tek sheh atë masë sa një kokërrzë qershie, tëpërgjakur e të hedhur në fund të një legeni të ndyrë. Të plagos shpirtin sa herë që mendon, se ajo copëz atje, do të ishte fëmijë i gjakut tënd, nëse do t'i kishe dhënë mundësinë për të jetuar. Psherëtiu. Kish bërë tri aborte, dhe më e keqja, nuk kishin qenë spontane. Kish qenë zgjedhja e saj. E saj dhe e Mirit. Kishin kaluar vite e sa herë i kujtonte, mendonte se, nëse kish bërë mëkat në jetën e saj, kish qenë pikërisht ai. Ish munduar të ish nënë e mirë, grua e mirë, një qënje njerëzore me shpirt të dhembshur e nuk i kish bërë keq askujt, e megjithatë... do të përfundonte në ferr.... nëse kishte një të tillë. E kish merituar. Ja, ku është Dejvi, ç'fëmijë i mrekullueshëm. Pak a shumë këtë moshë do të kish fëmija i saj që kish abortuar të fundit. Pak para se të nisej në dhe të huaj. I ledhatoi ballin e zemra ju mbush me dhëmbisuri. Do të kish qenë djalë apo vajzë? Po dy të tjerët? Mendimet e errëta e të ngatërruara që rrinin pezull si re të zeza, u përshkuan nga një vetëtimë rrufeje. Brofi më këmbë e vrapoi poshtë shkallëve. Mori bllokun ku kish shkruar datëlindjet e fëmijëve. Nuk përkonin. Mbylli bllokun dhe e vuri sërish poshtë jastëkut. Prit, tha me vete, nuk i ke bërë mirë llogaritë, ke qenë shtatzënë prej tre muajsh, nuk janë nëntë muaj që duhet ti shtosh datës së abortit, janë gjashtë. U ul ngadalë mbi divan që të mos binte. Arbena, Sara, Dejvi kishin lindur në të njëjtën kohë që duhej të lindnin fëmijët e saj. Koinçidencë? Koinçidencë që Arbena i ngjante më shumë asaj se sa Elona? Ndjeu zemrën t'i mungonte e nuk mbushej dot me frymë. Doli në oborr e mbushi mushkëritë me ajër e aromë lulësh. Por nuk u ndie më mirë. Fundja, kështu ndihej sa herë që mendonte fëmijët që kish humbur me dashje. Te kthesa u dha makina e Verës dhe ajo rendi drejt saj.

- Mami, nuk do të luajmë sot? - dëgjoi zërin e trishtuar të Sarës që e ndoqi pas. Mbajti këmbët dhe i buzëqeshi.

-Sot nuk do të luajmë, por kam një surprizë tjetër të bukur. Besomë!- dhe i shkeli syrin.

- & -

Gati ishte errësuar kur makina frenoi para shtëpisë. Nuk kish menduar se do të vonohej kaq shumë, por e kishin vonuar formularët që kish plotësuar dhe gjithë ato këshilla që ishin munduar ti jipnin. Në fillim kish kundërshtuar të humbte kohë me to, u kish thënë se kish punuar në një azil pleqsh, por kjo i kishte bërë për të qeshur e kishin insistuar akoma më shumë. Më në fund kish arritur t'ua shkëpuste nga thonjtë të moshuarën, që jo vetëm paguante mirë, por i biri herë pas here i dhuronte azilit shuma parash të konsiderueshme. I ish dashur të premtonte se dhurimet nuk do të mungonin. Megjithatë nuk kishin dashur t'ja linin. Vetëm fakti se ishte mbesa, e nuk kish ligj që ta pengonte të merrte gjyshen e saj në shtëpi, i kish bërë të dorëzoheshin. E si mund ta linte aty? E kish humbur për më se njëzetepesë vjet, tani që e kishte rigjetur, nuk donte të humbiste as edhe një ditë nga ato që i kishin mbetur. Sara me Dejvin rendën drejt makinës ende pa ndaluar. Era zbriti dhe hapi derën tjetër.

- Ju prezantoj gjyshen time!

- C'don gjyshja këtu?- pyeti Sara e habitur.-A nuk duhej të ishte në azil?

- Tani është këtu. Jepini fëmijë, më ndihmoni!

Nxorri nga bagazhi i makinës një karrocë të vogël, e me ndihmën e Verës e vendosi gjyshen mbi të. Fëmijëve ju dha valixhet e plaçkave. Gjyshja i shikonte e mrekuilluar.

- Nuk i ke parë asnjëherë?- i pëshpëriti në vesh Era.

Ajo tundi kokën pa folur. Në cepat e syve kishin filluar të shndrinin dy pikla të vogla loti që e tronditën Erën. Dhe ajo nuk i kish duruar asnjëherë lotët e gjyshes.

- Fëmijë! Lërinini të gjitha aty ku janë. Në fillim, urojini mirëseardhjen gjyshes!

Ata u afruan ngadalë e të ndrojtur. Nuk e njihnin atë grua të vjetër me fytyrë mbushur me rrudha, e shumë mirë do t'jua kishin dhënë këmbëve. Por mami nuk ishte i atij mendimi dhe t'ja prishnin asaj ishte gjëja e fundit që do të donin të bënin. U afruandhe e lanë që t'u përkëdhelte fytyrat e t'i puthte. Mirës i erdhi për të qeshur kur pa se me ç'heroizëm qëndronin. Do të ndryshojnë, mendoi, do të fillojnë ta duan aq shumë... sa unë do të bëhem xheloze. Kujtoi nënën e saj që zemërohej sa herë që vinte rese kish më shumë konfidencë mes saj dhe gjyshes se sa midis tyre. Ah, po nëna, duhej t'i telefononte. Por jo sot, nesër. Shtyu karrocën drejt shtëpisë. Ishin vetëm tri shkallë. Sot do të bënte si të bënte, nesër do të gjente

ndonjë sistem. Hapi derën, dhe pasi i kaloi një krah poshtë këmbëve dhe tjetrin poshtë shpatullave të gjyshes, e ngriti peshë. Ndjeu dhimbjen e vjetër që kish fituar nga puna në azil dhe mbyti një rënkim. E vendosi me kujdes mbi divan. Miri me Andin u dhanë në derë dhe po e shigjetonin me shikime. Ndjeu zemrën t'i dridhej. Mos nuk e donin aty, mos do ta detyronin ta kthente mbrapsht? Ra zilja e telefonit, por asnjë nuk e kapte e asaj i cingriti nervat. E mori vetë.

- C'budallallëk ke bërë? Me ç'të drejtë merr nënën time nga azili?- zëri i babait ishte i zemëruar .

- Eshtë gjyshja ime! - u përgjigj duke u munduar të dukej e qetë dhe e sigurtë, ndërsa këmbët kishin filluar t'i dridheshin.

- Nuk ke shkuar për ta parë katër vjet, e sot tu tek ta marrësh. Në ke perëndi, lëre të qetë. Mos e nxirr tek ajo inatin që ke me mua.

- Inatin? Baba, unë nuk kam inat me ty.

Vuri re Mirin e të gjithë fëmijët që ja kishin ngulur sytë dhe kjo ja shtoi akoma më shumë zemërimin e nuk ishte në gjëndje të fliste. Paso i një hop heshtje nga ana tjetër e pastaj:

- Nga e more vesh se t'i ka lënë të gjitha sa ka në testament? - zëri i të atit ishte më i shtruar.

- C'farë?- briti Era.

- Lëri ato se nuk ma hedh mua. Thuamë të vërtetën, të ka treguar Selimi?

- Selimi?

- Mos bëj sikur nuk kupton. Nëse i ndodh gjë nënës atje tek ti, të betohem, do të ma paguash shtrenjtë!

C'farë testamenti? C'mund të kish gjyshja për ti lënë asaj? Kish qenë një grua e varfër që mezi e shtynte deri në fund të pesëmbëdhjetëditëshit. Ktheu kokën e habitur nga ajo, por hasi një vështrim të qetë e inkurajues.

- Kërkomë ç'të duash, vetëm ktheje ku e more. Për atë perëndi, lëre t'i ngryse e qetë ditët që i kanë ngelur.

Ju mblodh një lëmsh në grykë. C'donte të thoshte me ato fjalë, si kish mundësi që e njihnte aq pak?

- Më vjen keq baba, por nuk mundem! - foli duke gëlltitur lotët.- Nuk e kthej më atje. Si ti zë goja ato fjalë, jam fëmija yt.

- Je një mallkim, jo fëmijë! - briti ai nga ana tjetër e fillit. - Po ta përsëris edhe një herë, nënën time do ta kthesh nga e more! Që sot!

Largo i e trembur receptorin nga veshi dhe e vështroi një hop. Miri ju afrua e i foli pranë veshit.

- Bëj si të thotë babai!

- Kurrë!- ja ktheu ajo e ngriti receptorin.

- Gjyshja do të rrijë këtu me mua! Do të iki veç në don ajo. Të tjerët, - ajo u kthye nga Miri, - të ikin po të duan që sot.

- Më kalo Teutën se dua të flas me të.

- Jo, nëse më flet kështu. Më parë, duhet të më thuash “Të lutem”. Eshtë rregull i edukatës, baba, ti ma ke mësuar - i foli prerë.

Pasoi heshtje që asaj ju duk pafund dhe e mundonte, por e kish vendosur të priste. Mjaft e kish lënduar, tani ishte rradha e saj.

- Të lutem! Më kalo Teutën! - zëri ishte i ulët dhe ajo pati dëshirën ta bënte ta përsëriste lutjen me zë të lartë, por e fashiti shpejt. I zgjati receptorin gjyshes pa e parë në sy. U largua disa hapa e qëndroi pranë dritares duke i kthyer krahët për të fshehur ankthin. Nëse ajo donte të kthehej... ose ai e bindte... nuk i mbetej tjetër veç t’u nënshtrohej vullnetit të tyre. Do Zoti, rri këtu me mua... Kam aq shumë nevojë për të... Një copë herë nuk dëgjoji gjë, gjyshja heshtëte, dëgjonte e tundte kokën. Pastaj tingulli i zërit të saj dhe zemra gati nuk i ndaloi.

- Qe dëshira ime bir. Kisha filluar të zë ndryshk në atë vend. Natën e mirë! - dëgjoji kërcitjen e lehtë të receptorit që u mbyll. Era u kthye nga ajo. Gjyshja i buzëqeshi, ndërsa të tjerët ja kishin ngulur sytë të habitur.

- C’keni që më rrini aty si hunj! - tha ajo.- Hajdeni se kemi punë për të bërë. Lironi dhomën këtu ngjitur, gjyshja do të flejë aty.

Arbena levizi e para e shkoi në dhomën ngjitur.

- Ku ti çojmë plaçkat? – pyeti Elona .

Arbena lëvizi e para e shkoi në dhomën ngjitur.

- Për mua mund ti nxirrni edhe në oborr. Lini një shtrat, një raft, një komodinë dhe një karrike.

- & -

I hapi aq shumë punë vetes ditët në vazhdim, sa nuk kish kohë të mendonte për problemet e saja dhe në darkë binte në gjumë si e vdekur. Sistemoi Teutën në dhomën ngjitur me sallën e ndenjes, ku në fakt nuk rrinte njeri dhe siç dukej e përdornin për dhomë miqsh. Por dukej se miq nuk kishin shkelur prej kohësh në atë shtëpi pasi dhomën e kish mbuluar pluhuri. Në fund të korridorit, ishte një dhomë tjetër që e përdornin për të tharë rroba. Vuri tela në oborrin e pasëm të shtëpisë dhe liroi dhomën. Futi në të një dhomë të vjeter gjumi që e gjeti të zmontuar në bodrum, megjithë kundërshtimet e Arbenës që këmbënguli të blinte një të re. Nuk e dinte buxhetin e familjes, edhe se shihte se paratë nuk mungonin në atë shtëpi, nuk donte të shpenzonte. Zbrazti disi sallën që Teuta të kishte hapësire

për të lëvizur me karrocë. Shkepi koliben e Bobos, ai nuk rrinte më në të, me disa nga dërrasat e saj mbuloi tri shkallët e verandës, kështu karroca mund të zbriste poshtë në oborr pa vështirësi. Ndjente mbi vete sytë e zgjuar të Teutës që e ndiqnin ngado e merrte zemër. Gëzimi i saj, i çiltër si gëzim fëmije, që e shprehte herë pas here me pasthirrma të vogla, ja shpërblenin lodhjen. Po ashtu edhe Vera, nuk u kursye dhe e ndihmoi me gjithë shpirt. Sara e Dejvi u mësuan shpejt me gjyshe Tutën si e thërrisnin ata, e u bënë miq. Një fitë e lehtë dhe e këndëshme xhelozie i përshkonte zemrën, tek i shihte tek i flisnin në vesh, por shpejt e kalonte duke qeshur me vete. E kish ditur se do të ndodhte kështu, nuk kish ç'të bënte. Prania e saj kish qenë një bekim nga Zoti për të gjithë. Tani uleshin e darkonin së bashku e fëmijët e rritur, filluan ti zgjatnin qëndrimet e tyre aty. Gjyshe Teutës i pëlqenin filmat e rrinte e shikonte deri vonë. Shpesh Andi, Elona e nganjëherë Arbena, rrinin e ndiqnin filmin me to. Era bënte sikur shikonte, në fakt nuk e kish fare mendjen tek televizori, të tjera mendime bluante në tru. Dejvin e zinte gjumi në divan, pështetur pas saj, dhe ajo e ngrinte peshë dhe e çonte lart. I dukej sikur bëhej gjithnjë e më i lehtë. Kur dreqin do të bëhej mbarë ta çonte tek doktori? Dy herë në javë Sara me Dejvin, shkonin pasdite tek gjyshi e rrinin për darkë tek ai. Ajo nuk thoshte as edhe një fjalë, por shihte se entuziazmi i fëmijëve për të ikur nga shtëpia pakësohej. Aq sa një ditë dëgjoi Sarën tek i ankohej të vëllait.

- Ufa, duhet të shkojmë tek gjyshi.

Bëri sikur nuk e dëgjoi. Edhe se ishte e inatosur me të atin, nuk ishte kjo ajo që donte. Ende nuk i kish telefonuar nënës. Fundja përse duhej ta bënte? Le t'i telefononte ajo më parë. Pastaj, ç'kuptim kish kur ishte me një burrë tjetër? Por vallë... a ishte..? Nëse babai ish gjallë...

- Sara, e ke numrin e nënës sime se e kam humbur? - provoi ajo.

Sara i dha numrin dhe ajo e futi në xhepin e përparësës. Sapo u gjet vetëm, me dorë të dridhur formoi numrin. Dëgjoi zilen që binte nga ana tjetër, e pastaj një zë të dashur...

- Familja Kruja.

- Alo mama! - foli ajo me zë të ngjirur nga emocioni. Mamaja ishte me babanë e saj.

- Mira bijë! Ti je?

- Po mama.

- Si i ke fëmijët?

- Mirë mama, po babai si është?

- Nuk është mirë. E ka shqetësuar zemra e nuk bën gjumë të mirë. Përse ja bëre këtë?

- Cfarë i kam bërë?

- Eshtë në merak për të ëmën.

- Përse nuk vjen ta shohë?

Pasoi një hop heshtje.

- Ti e di mirë, nuk vjen për shkakun tënd.

Këtë herë qe Era që heshti. Nga nervat shtërngoi me forcë receptorin sa e bëri të kërciste. Desh të bërtiste, të ulërinte, por shtërngoi nofullat derisa i dhëmbën. Megjithatë, zëri i saj ish i qetë kur foli.

- Të caktojë një orar e të vijë. Nuk do të jem në shtëpi. - mbylli telefonin. Kur u kthye, desh u përplas me karrocën e Teutës, nuk e kish ndjerë kur kishte hyrë. U ndie fajtores dhe u skuq. Si nuk i kish shkuar ndër mend se duke e marrë prej azilit, i kish hequr mundësinë të shikonte të birin?

- Ku do të shkosh kur të vijë yt atë? - Teuta e zhbironte me sy.

- Diku do të shkoj. Do të marr Verën e do të shkoj të bëj pazar, - tha ajo duke qeshur.

- Ashtu? Edhe unë kam qejf të dal e të bëj pazar, - ja ktheu gjyshja.

E pa një çast e menduar. Si mund ta merrte me vete ashtu siç ishte e gozhduar mbi atë karrocë të mallëkuar? Fundja... përse jo?

- Bravo Teuta, kështu më pëlqen. Thërrasim një furgon taksi, marrim Verën dhe ikim.

Teuta përplasi duart nga gëzimi.

- & -

Kishin dalë në rrugë e prisnin furgonin, kur një makinë ndaloi pranë tyre. Një grua në moshë të mesme, me hap të sigurtë e lëvizje të prera u afrua.

- Zonja Kruja, jam infermiere Donika. Yt bir më ka dërguar t'ju shërbej. - ju drejtua ajo gruas së moshuar në karrocë. Të tria panë njëra tjetrën në sy. Teuta bëri sikur nuk kuptoi ose se nuk dëgjoi, ndaj gruaja e huaj përsëriti frazën nga fillimi. E kotë. Plaka prapë nuk kish dëgjuar gjë. Era ndjeu bërrylin e Verës që e shpoi në ije dhe desh e kapi gazi. Infermierja ju drejtua atyre të dyjave, ta ndihmonin për t'i spjeguar "pacientes" së saj, se tash e tutje ajo ishte në shërbim të saj dhe se ishte nder për të të kujdesej për nënën e zotit Kruja. Ishte rradha e Erës të mos kuptonte, kështu që infermieres ju desh ta fillonte përsëri nga fillimi e Vera filloi të kollitej. Më në fund, u duk sikur Era diçka po e kuptonte.

- Aha ! Pra jeni infermiere.

- Po zonjë.

- C'don këtu infermierja? - ju drejtua Verës. - Kemi njeri të sëmurë në shtëpi?

- Me sa di unë, jo. - Vera mblodhi supet.

- Më falni, po zoti Kruja ...

- Jo, më falni juve, keni ngatërruar adresë. Zoti Kruja nuk banon këtu.

- Por ai ...

- Ne, që jetojmë këtu, nuk kemi nevojë për ju, - ja preu shkurt Mira. - Gjyshja, kur të mos ndihet mirë, do ta zgjedhë vetë infermieren e saj. Ajo është shumë, shumë e prerë në këtë pikë. Apo jo gjyshe? Thuaji pak se si e ke imagjinuar ti infermieren tënde.

Gruaja kish filluar të shfaqte shenja nervozizmi dhe një tik i lehtë i lëvizte qepallën e majtë.

- C'i flet asaj, ajo është shurdhe.

- Kush, unë? - u hodh Teuta.

- Po unë të folja dhe ti ...

- Unë të dëgjova, ti nuk më kuptove. Shko e thuaj tim biri, se nuk marr në shërbim një infermiere që nuk dallon kur "pacienti" nuk dëgjon apo bën sikur nuk dëgjon. Dhe bëji shumë të fala nga ana ime. Ditën e mirë!

Infermiere Donika mbeti një çast më këmbë. Pastaj me atë hapin e saj, si hap ushtari mori nga makina. Ato shpërthyen në të qeshura. Furgoni u duk tek kthesa e rrugës dhe e harruan. Nuk kishin zënë vend, kur tek dera e furgonit u shfaq koka e Donikës me kaçurrela të llakosura.

- Një psikiatër, ja ç'ju duhet juve!- dhe ngriti kokën lart duke nxjerrë mjekrrën përpara. Gazi shpërtheu, Era tek mbante brinjët me dorë shikonte Teutën që fshinte lotët. Zot, u lut me vete ajo, mos e merr shpejt, lërma ta gëzoj edhe ca kohë. Ndjeu dorën e gjyshes mbi të sajën dhe u panë në sy. Sa shumë flisnin ato sy...

- & -

Kur gjërat dukeshin sikur po rregulloheshin në shtëpi, Era u gjet para pikëpyetjeve të tjera, të cilave nuk dinte t'u jepte përgjigje. Qytetin i saj, siç kish dëshirë ta quante ajo, sa më shumë e shihte aq më pak i ngjante atij që ruante në kujtesë. Ishte më i bukur, më i pastër e më... i pasur. Amfiteatri, që kohët e fundit e mbante mend të katandisur në një gropë të shëmtuar, ishte restauruar e pranë tij ishin ngritur muzeume të pasura me vepra të antikitetit, të cilët tërhiqnin vizitorë nga të gjithë vendet e botës. Le të mos flitej për lokalet e hotelet luksoze. Ajo që e habiti më shumë, ishte jeta politike, asnjë emër nga ata që mbante mend, dhe habia më e madhe, Kosova ishte bashkuar me Shqipërinë, tashmë dhe harta kish ndryshuar konturet e saj. Kish kërkuar shoqet e saja të dikurshme e ishte zhgënjyer, kish parë ftohtësi në sytë e tyre dhe atë nxitim për ta evituar, asnjëra nuk i përgjigjej telefonatave të saj, dhe ajo kish hequr dorë. Ju

kthye përsëri bllokut të saj në orët e vona të natës, pasi fëmijët e Teutën i zinte gjumi. Një mbrëmje kish parë një film ku një aktor i ngjante ish presidentit të Amerikës. I gjante aq shumë sa... padashur kish vënë buzën në gaz. Kish pyetur se si e quanin atë aktor dhe përgjigja:

- Bill Clinton,- qe përgjigja e thjeshtë e Sarës.*
- Ish presidenti!?*
- Burri i ish presidentes, Hillary Clinton.*

- Jo Sara, e shoqja kandidoi dy mandate pas tij e nuk...

E para ja plasi gazit Elona, e cila ishte ulur në divanin tjetër. Arbena e pasoi me kukurizma.

- Përse qeshni? - ish nxehur ajo.*
- Jepi mami se i paske të forta sonte,- qeshte Dejvi.*
- Atëhere, më thoni kush është presidenti i Amerikës sot? - ngulmoi ajo.Fëmijët kthyen kokën menjëherë nga ajo.*
- As kaq gjë nuk e din mami? - sytë e Sarës ishin të preokupuar.*
- Do të na lini të ndjekim filmin, apo do të flasim? - ndërhyri Miri,- Al Gori, - shtoi duke ju drejtuar Erës, e cila nuk kuptoi se çfarë e shqetësoi më shumë, fakti që Al Gori isht president, apo fakti që Miri kish marre mundimin ti drejtonte një fjalë .Tani e tutje do të ish më e kujdesëshme të mos binte në gracka të tilla e të qeshnin me të. Le të thonin ç'të donin, Xhorxh Bush ishte presidenti i tanishëm i Amerikës dhe Bill Klinton kish qenë para tij. Hillary... bota që njihnte ajo, nukkish qenë asnjëherë gati t'i jepte kaq pushtet një gruaje...*

- & -

Kishin kaluar rreth dy muaj e dukej sikur punët kishin filluar të shkonin mirë. Krijoi një ide se si ishin ndërtuar gjërat në atë ambjent, i cili pak nga pak po i humbiste konturet e lojës që kish imagjinuar ajo.Vendosi ti nënshtrohej kësaj jete, e përse jo? Përse të mos ishte ky realiteti? C'mund të ketë realiteti më shumë se kaq? Gjëra që i prekte përditë, punë që i bënte përditë...Por sa më shumë dukej se zenin vend, e brente dyshimi se vendi i saj nuk ishte aty. Mankthe që i zinin frymën në gjumë, tek i shkonte pas Mirit që ecte përqaftuar me një grua tjetër, e bënë të zgjohej në mes të natës qull në djersë. Herë herë Andi, me një buzëqeshje të bukur, i hapte derën e shtëpisë dhe zgjatej për ta puthur në faqe, zgjatej dhe ajo, por nëçastin që buzët e tij duhej të çiknin faqen e saj, ai avullohej ngadalë dhe ajo fikonte me tmerr sytë e tij që zhdukeshin të fundit e perceptonte frikë e mall. Elona e dobësuar e me sy të merakosur që e ndiqte nëpër shtëpi... C'ishin këto ëndrra,

ç'kuptim kishin? Përse e torturonin kështu? Në mëngjes ja tregonte Teutës dhe shprehte shqetësimin se mos ndoshta ju kanosej ndonjë rrezik bijve të saj. Teuta i merrte me të qeshur dhe e qetësonte, tashmë edhe ajo ishte e bindur se Era kish humbur kujtesën.

- Nuk të vjen keq për këtë?- e pyeti një ditë.

Teuta i kish përkëdhelur flokët duke tundur kokën. Jo, nuk i vinte keq.

- Përse? Nuk mbaj mend asgjë nga këto dhjetë vjet, nuk mbaja mend as emrat e fëmijëve të mi. Gjyshe, ky është mallkim, - kish shpërthyer në dënesa ajo.

- Ngadalë, bijë, ngadalë. Do të të kujtohen të gjitha. E do të kuptosh.

- Cfarë?

- Se është bekim. Po lëre tani këtë muhabet. - e kish mbyllur ajo. Era e dinte mirë, se kur ajo nuk donte të fliste për diçka, ishte më e shurdhër e memece se muri.

- & -

Nën ndikimin e ëndrrave, ishte gjithnjë në ankth për Andin e Elonën. Kur afrohej ora që duhej të ktheheshin në shtëpi, dilte në oborr duke bërë sikur kujdesej për lulet e sytë i mbante vazhdimisht tek kthesa e rrugës. Kur shihte makinat e tyre, merrte frymë e lehtësuar e futej brenda. Sytë e zgjuar të Teutes e ndiqnin dhe ajo e dinte se e kish kuptuar. Nuk kaloi shumë dhe parandjenja e keqe u vërtetua, por nuk bëhej fjalë as për Andin e as për Elonën. Dejvi. Një mëngjes, nuk mund tëngrihej nga shtrati, digjej nga ethet. Miri i alarmuar thirri ndihmën e shpejtë. Mjeku me infermierët nuk e zgjatën por e ngarkuan në barelë. Megjithëse ngulmuan që ajo të rrinte në shtëpi, kërceu në ambulancë e i ndenji djalit tek koka gjithë rrugës derinë spital. Sapo mbërritën, e morën dhe e futën me nxitim në reanimacion ku e lidhën me aparate që Erës i futën frikë. Nuk e linin të hynte brenda e kjo e bënte të hante veten me dhëmbë pas derës së dhomës ku dergjej Dejvi që e thërriste përçart. Pas pak aty ja behu i ati.

Ajo ju afrua por ai e injoroi e shkoi drejt doktorit që u afrua.

- Me vjen keq zoti Kruja. Nuk kemi ende një organ kompatibël.

- Cfarë?- briti Mira duke e kapur për mënge.

Por ai ja largoi dorën pa fshehur ndjenjën e bezdisë, e ju drejtua babait të saj.

- Kohët e fundit dializat nuk janë bërë rregullisht. Pasojat janë të rënda.

- E di,- u përgjigj kokëulur i ati. - Sa shanse ka?

Shanse! Ajo shikoi me rradhë doktorin, të atin, Mirin e zbehtë që nuk mund ishte në gjendje të fliste dhe kuptoi se gjendja ishte serioze. Kjo ishte e re për të, të tjerët e

kishin ditur, me siguri që e kishin ditur. Me ç'të drejtë ja kishin mbajtur fshehur, ja kishin hedhur në krahë atë fëmijë, e kishin detyruar ta donte me gjithë shpirt atë që nuk ishte as mishi e gjaku i saj, e po ja shqisnin në këtë mënyrë? Kish menduar se do t'ja merrnin një ditë, e kish imagjinuar në mënyra të ndryshme, prindër që ekërkonin, shërbimi social që mbulonte jetimët por... që duhej të vdiste aty në sy të saj... Sytë ju errën nga tmerrri dhe një ciklon ju ngrit në tru ku përplaseshin mijëra mendime, mijëra fjalë në katër gjuhë që dinte... por fjala kontroll nuk ekzistonte. Kapi jakën e këmishës së doktorit dhe i ulëriu në fytyrë.

- Mjerë ti, po i ndodhi gjë...

Dy palë krahë të fuqishëm e tërhoqën dhe e përplasën në një karrike anës së korridorit . U ndje e lodhur, e mjerë, një qenje e dobët dhe e pavlerë, një hiç. Doktorin u largua. I ati me Mirin u ulën të heshtur në karriket pranë, por ajo nuk ekzistonte për ta. Ndoqi me sy drejtimin që mori doktorin dhe fiksoi derën ku hyri. Priti pak çaste e pastaj u ngrit. Nuk e ndaluan të largohej, një mendim më pak për ta. Përshkoi dy herë korridorin, herën e tretë, pa trokitur hapi derën që kish fiksuar e hyri brenda duke mbyllur pas vetes. Ishte paradhoma e një salle operacioni, e kuptoi se pa doktorin veshur me përparëse të gjelbër e një maskë garze i varej në qafe tek fërkonte duart e sapunuara deri tek bërrylet.

- Dil jashtë! - e urdhëroi ai i zemëruar sapo e pikasi.

- Cfarë po i ndodh tim biri? Të lutem doktor, më thuaj, kam humbur kujtesën,- shtoi ajo tek mendohej të mbante me zor lotët që i ishin mbledhur lësh në grykë. Shikimi mosbesues i doktorit i bëri keq e lotët shpërthyen.

- Ka nevojë për një veshkë, në mënyrë urgjente., – u përgjigj ai më zë të butë. Lotët e kishin prekur.- Nuk gjejmë dhurues që të jetë kompatibël. Yt bir ka të njëjtin grup gjaku me ju, është shumë i rrallë, nëse e mban mend.

Ajo nuk e mbante mend këtë. Dinte se...

- Gjak i grupit A.

- Eshtë nëngrupi që e përcakton.

- Ja dhuroj unë! Vetëm shpëtoje...

Doktorin uli kokën e nuk e pa në sy kur i foli.

- Më vjen keq zonjë, veshkat tuaja janë dëmtuar shumë nga abuzimi i drogës dhe alkolit, kështu rezultuan analizat e para një viti. Kurat që ndoqe për gjashtë muaj, nuk sollën rezultat.

- Nuk është e vërtetë, ndjehem mirë.

Doktorin pa orën dhe i bëri shenjë të dilte jashtë.

- Përsërisim analizat! - toni i zërit ishte i vendosur. - Nuk do të pendoheni - shtoi duke bashkuar duart në shenjë lutjeje.

- Nuk kemi kohë të humbasim me analiza. Mund të jenë orët e fundit të djalit tuaj.

Mira filloi të qajë në heshtje e dëshpëruar. Fundja, dhe po ti bënin analizat, çfarë do të zgjidhte? Më shumë, kish mundësi që të mos kishin as të njëjtin nëngrup, nuk ish gjak i gjakut... Ju afrua derës. Ishte e kotë.

- Një minutë! - e ndaloi zëri i doktorit. - Nëse i trampiantojmë një veshkë tënden, mund ta shtyjë disa muaj, e ndërkohë... ndoshta gjejmë një dhurues. Veç, e ndjej për detyrë të të them se për ju, pasojat do të jenë shumë, shumë të rënda. Mendohuni mirë. Nëse vendosni për të dhuruar organin tuaj, duhet të firmosni një deklaratë ku e merrni vetë përgjegjësinë.

Lëshoi dorezën e derës. Përgjegjësinë thotë!? Shikonte në drejtim të tij, por sytë i kish fiksuar diku pas supit të tij, të përhumur.

- Lëre fare, - tha ai duke i kthyer krahët, - zëre se nuk thashë gjë.

- Ku e keni deklaratën? - foli ajo me zë të sigurtë sa e habiti edhe atë vetë. Le ta provonin, ç'do të humbte ajo? Një veshkë? E pastaj, ajo i kish top të dyja. I takonte Dejvit të humbte a të fitonte, nëse fati... nëse Zoti donte... të ishin kompatibël... U afrua tek tryeza e vogël në cep të dhomës ku doktori i zgjati një fletë pasi e plotësoi me nxitim. Firmosi pa ju dridhur dora, ajo që u drodh si një gjethe e brishtë vjeshte brenda shpirtit të saj, ishte një fill i vogël shprese.

- Kaloni në sallën tjetër, nuk duhet të humbasim kohë! - Doktorit e shoqëroi tek një derë tjetër dhe i zgjati dorën.

- Paçi fat zonjë!

- Paçi fat dhe ju, doktor! - i shtërngoi dorën, e mendimi se nuk e dinte se cili prej të dyve kish më shumë nevojë për fat, e bëri të vinte buzën në gaz.

- & -

E sulmuan një ekip i tërë doktorësh, infermierësh e laborantësh. Dikush i merrte gjak, dikush i dëgjonte zemrën me stetoskop, i bënë grafi të veshkave, të mushkërive e çfarë nuk i bënë. Ishte trullorur nga numri i aparateve që e kontrollonin e ku e fusnin pa e lënë të merrte frymë. Pastaj, ku e shpinte mushka atë dhe gjithë ata të tjerët? A nuk e shihnin qartë se nuk ishte ajo nëna natyrale e atij djali që në analizat e para? Mos vallë nuk kishte asnjë të vërtetë në gjithë këtë që po ndodhte e... sëmundja e Dejvit ish veç një shkas për ta futur atë nën bisturi? C'plan i kishin kurdisur? Mos ishin... mos e përdornin si kavje... ose më keq akoma, i merrnin e i shisnin organet... Doktorit i saj, kështu e quante tashmë, ju afrua e pasi hoqi maskën duke shqyrtuar fletët e rezultateve të analizave, i buzëqeshi si me pahir. Nuk i shpëtoi ajo shprehje habije e turbullimi që vulos fytyrat kur ndodhen përpara gjërave të pabesueshme. Ja ku jemi mendoj, tani do të

më thotë se si ka mundësi që të mos jem kompatibël me tim bir, ndërkohë që isha para një viti. Dhimbja, si një thikë e mprehtë i çau krahërorin. Dejvi! Nuk guxonte ta shikonte doktorin në sy.

- Komplimente! Duket se... ç'do gjë është perfekte dhe unë mezi po e besoj. Do të përgatisim sallë për trapjantim. Mendoj se për nesër mund të jemi gati... e...

Ajo nuk po e ndiqte më. Stuhi ndjenjash e mendimesh të kundërta i trazuan shpirtin. Perfekte!!! C'gënjeshtër! Të ikte e ta linte me gisht në gojë këtë mashtrues. Po Dejvi... Po sikur të kish qoftë edhe një fije mundësi... Fytyra e tij e zbehtë, mbuluar djersë e dhëmbje...

- Jam gati dhe unë doktor!

- & -

Një fill i dobët drite depërtonte nga perdet e bardha të dritares e luante me dritë hijet e dhomës. Ku jam, pyeti veten ajo, në parajsë apo në ferr, kur e sulmuan dhimbjet në përpjekjen e parë për të lëvizur. I dukej sikur një tren i kish kaluar përsipër. Në kënd të dhomës, poshtë dritares, shqoi një kokë me flokë të thinjur. Babai i saj dremiste aty. C'bën ai këtu? Prania e tij, e gëzoi dhe e trishtoi njëherësh. Dejvi... nuk kishte shpëtuar. Një rënkim ju ngrit nga brenda por ajonuk pati fuqi ta nxirrte jashtë, e ai ju kthye mbrapsht duke ja rënduar më shumë zemrën. Ndjeu derën e dhomës të hapej ngadalë. Mbylli sytë. Nuk donte të shihte njeri atë çast, as babanë e saj. Të çohet e të ikte. Hapa të kujdesshëm ju afruan shtratit, por nuk i hapi sytë.

- Si është Dejvi?- në zërin e të atit kish ankth. Ajo mbajti frymën.

- Nuk është përmendur ende, por thonë se çdo gjë shkon mirë. Shko pusho Agron, do të rri unë këtu. - ishte zëri i Mirit.

Pasoi një psherëtime lehtësimi dhe ajo mezi e mbajti veten. Një palë këpucë kërcitën lehtë e ajo me sytë gjysmë të mbyllur dalloj një hije që u përkul mbi të. Dy buzë të ngrohta ju pështetën mbi ballë një çast, pastaj u larguan e dera u mbyll. Dëgjoi zhurmën e një sendi që spostohej e hapi sytë me kujdes. Kish më shumë dritë. Pa Mirin që tërhoqi karrigen pranë shtratit. Mbylli sytë në kohë, kur ai u përkul dhe e puthi lehtë në buzët e thara. Ndjesia që i shkaktoi, e bëri të kuptonte se dashuria për këtë burrë, jetonte ende brenda saj. Si një bimë e etur që përtërihet kur i japim ujë... Vetëm një puthje... Kish mjaftuar vetëm një, kish ende shpresë. Ndjeu faqen e Mirit të pështetëj mbi dorën e saj që dergjej mbi çarçaf. Donte t'i fliste, ti thonte se e kish falur se... Po kish frikë mos e prishte këtë çast të

magjishëm. Një gërhimë e lehtë i dha të kuptonte se ai kish zënë të dremiste. Duhej të ishte i lodhur. Sa gjumë kish edhe ajo... Pak nga pak, një muzg i këndshëm ëndrrash, ngjyer lehtë me perëndim dielli në një plazh, i zbriti mbi kapakët e syve. Andi me Elonën u shfaqën aty, i buzëqeshnin të merakosur e të gezuar njëherësh. Rendi drejt tyre t'i përqafonte e befas u kujtua se kjo i bënte të zhdukeshin, kështu që ndaloi. Ata filluan t'i afroheshin ndërsa ajo nisi të zbrapset, këmbë zbathur mbi rërën ende të vakët. Nuk duhej ta preknin, donte t'i shihte sa më gjatë që të ishte e mundur...

Pas disa ditësh, i zgjidhën tubat dhe e çuan për të parë disa minuta Dejvin. Nuk e lanë të hynte brenda, e pa nëpërmjet xhamit të dritares së dhomes së renimacionit. Një tub dilte nga nën klavikula, të tjerë ishin futur në trupin e tij të brishtë. Zemra i fërgëlloi. Ai trup i vogël aty, ai fëmijë që luftonte mes jetës e vdekjes, është im bir... nuk kam më dyshim, mendoj ajo.

- & -

Pas një muaji, dukej sikur e kish marrë veten. Po ashtu edhe Dejvi. Në shtëpi nuk kishte ndryshuar gjë, me përjashtim se tani aty ishte edhe një infermiere e punësuar. Krejt e kundërta e Donikës, një vajzë e re flokëverdhë, sykaltër, gazmore e plot humor. E kish zgjedhur vetë Teuta mes infermiereve të azilit. Ja dhe një tjetër me të cilën duhej ta ndante zemrën e gjyshes. Po s'kish ç'të bënte. Kish qenë e pashmangshme dhe e domosdoshme kohën që ajo ishte e shtruar në spital e më pas, kur ishte e dobët dhe e pafuqishme për t'i shërbyer Teutës. Shpejt, vuri re se edhe Vera kish filluar të ushqente ndjenja të ngjashme kundrejt asaj vajze, sidomos kur fuste hundët në kuzhinë. Dukej qartë se e bënte me dëshirë, por ec e thuajti Verës që e dëbonte pa pikë delikatose, pa e vrarë mendjen se mund ta lëndonte.

- & -

Vazhdonte të flinte në dhomën e vogël në katin e poshtëm. Miri e kish lutur të kthehej në dhomën e tyre, por nuk kish pranuar. Megjithëse kish filluar ta dëshëronte të shoqin e shpesh kalonte netë të tëra pa gjumë, nuk mundte. Kish shumë pikëpyetje që e torturonin vazhdimisht. Babai vinte edhe kur ishte ajo në shtëpi e mendohej të hidhte ndonjë urë komunikimi, por ajo ngriti barrirë, nuk mund ta linte veten të binte në atë grackë e ta lëndonin sërish. Nuk do ta duronte. Ndërsa nëna vinte gati ç'do pasdite e shtrohej në muhabet me Teutën përpara filxhanit të kafesë. Andi kish filluar t'i buzëqeshte nga pak, ndërsa Arbena me

Elonën nganjëherë më të rrallë, i dhuronin ndonjë të puthur. Sa për Sarën dhe Dejvin, ishin gëzimi që imbushte ditët. Nuk i bëhej të dilte nga shtëpia dhe refuzonte ftesat e Mirit, të cilat ishin bërë të shpeshta kohët e fundit, për të ngrënë darkë jashtë. I trembej mendimit të mbetej vetëm për vetëm me të dhe e shmangte shpesh edhe në shtëpi. Krahu i tij, që shpesh i pështetej mbi supe, tek rrinin ulur mbrëmjeve e ndiqnin ndonjë film në televizor, e lumturonte dhe e tmerronte njëkohësisht. Sa më afër i rrinte, po aq i rritej dëshira për të, por po aq bindej se nuk ishte Miri i saj. Ishin sytë, duart, aroma e lëkurës së tij, por ishte ai zë i brendshëm që ngrihej e i pëshpëriste “mos”. E nëse nuk ishte ai, aq më keq për të, sepse ndjehej e thithur si nga një magnet prej tij. Po bie përsëri në dashuri, mendoj. Nuk është ndjenja e vjetër, është diçka e re kjo që më pushton e më torturon. Netët pa gjumë, kur ëndrrat e zgjonin, i kthehej ditarit. Nuk ishte më një bllok, tashmë po mbushte të dytin. I mbyllte me çelës në komodinë. Po t’ja lexonte njeri, do të mendonte se ishte e çmendur e do ta humbiste respektin që kish fituar me aq mundim...

- & -

Doli nga dhoma me legenin dhe ibrikun me ujë të ngrohtë, pasi i kish bërë bidenë e mëngjesit Teutës. Ishte dita e pushimit të Silvës, ndërsa Vera nuk kish ardhur ende. Desh u përplas me të atin në korridor, i cili shihte i habitur ato sende në duart e saj.

- Unë sikur paguaj një infermiere,-e shigjetoj ai me sy. Erës ju ngrit inati i vjetër.

- Duhet t’ja shpërblej në një farë mënyre testamentin, apo jo baba? Vetëm se nuk e di ende se ç’ka në të. Do ta pyes ndonjë ditë.

Agroni uli sytë e nuk foli por hyri në dhomën e së ëmës. Mira dëgjoi zërat që u ngritën, edhe se nuk e kish zakon të përgjonte ju afërsisht e ngrehu veshët.

- Duhet ta besosh bir. Nuk është më ajo që ka qenë. Ka ndryshuar aq shumë, sa nganjëherë duket person tjetër.

- Pikërisht, kështu më duket edhe mua. Një tjetër, një e huaj.

- Do ta preferojë si më parë? - dëgjoi zërin qortues të Teutës.

- Në asnjë mënyrë. Por e kisha humbur shpresën se do të ndryshonte një ditë. Kam frikë ta besoj se ka ndodhur me të vërtetë. Kam frikë! - ngriti zërin ai.

Era u largua prej andej. Dyshimet vërshuan. Edhe ata nuk ishin të bindur se ajo i përkiste atij vendi, e shihnin si të huaj. Ku ishte vendi i saj? Bobo i doli përpara duke luajtur bishtin e duke e shikuar me sy kërkues. Kish harruar t'i jepte për të ngrënë, i kish dalë nga mendja tek përgatiste e përcillte fëmijët për në shkollë. Vera, sa e nevojshme je në këtë shtëpi. I zbrazti një kuti ushqimi për qentë në tasin e tij, dhe e shikoi me kënaqësi tek hante. Sa i dashur që ish. Dhe i ishte ngjitur aq shumë. E ndjente natën tek vinte në shtratin e saj. Ngjitej lart me Dejvin e më pas vinte tek ajo. I kish falur më shumë dashuri se shumë të tjerë në këtë familje. Dhe është veç një kafshë, mendoj duke e ledhatuar lehtë në kurriz. Bobo e la ta përkëdhelte edhe se në atë moment, me siguri i jepte bezdi. Kjo e bëri të buzëqeshte, i kapi kokën me të dy duart, ja ngriti lart duke e vërejtur në sytë e tij të habitur tek mbllaçiste dhe e puthi në hundën e lagësht. Agroni, kish qëndruar pranë derës e po e shikonte. Ibuzëqeshi e ndrojtur, kushedi ç'kish menduar kur e kishte parë ashtu, ec e dëgjoje tani. Për çudinë e saj, i buzëqeshi, e asaj i kujtoi babain e vjetër. Një ndjesi malli e mallëngjimi bëri rrugë në shpirtin e saj.

- Ditën e mirë!- tha ai e hapi derën për të dalë.

- Ditën e mirë e mirëardhsh baba ! - foli ajo

Ai u kthye dhe e pa edhe një herë duke buzëqeshur e pastaj doli duke e lënë aty më këmbë, me shpirtin mbushur me shpresë. Do ta gjente babanë e saj të dikurshëm. Do ta gjej, dua babanë tim! Po sikur ta ftoj për darkë? Ndihej Teutën të vishej dhe e vuri mbi karrocë. Le t'i bënte shoqëri tek merrej me punë, kish shumë mendime që e torturonin kur ishte vetëm. I tha se kish ndërmend të ftonte babanë për darkë, sytë e Teutës shkëlqyen. Shumë mirë, i tha ajo, eja të bëjmë menunë. Mori laps e letër e u ul pranë saj. Por ju desh të ngrihej, dikush i ra ziles së derës. Një burrë i ri e i pashëm i buzëqeshi.

- Më falni, njihemi gjë? - ajo buzëqeshje nuk i pëlqeu.

Buzëqeshja u zhduk papritur, ai e shtyu brenda dhe hyri pas saj. Era e shikoi e habitur.

- Ashtu!? Nuk më njeh?- ju skërmit ai.

- Jo!-i tha prerë ajo.

Ai e shikoi me mosbesim dhe hodhi sytë përreth.

- Kush është ajo plaka?- tregoi me gisht Teutën.

- Është gjyshja ime, dhe mos i thuaj plakë!- u revoltua Era.

Burri ja shkrepiti gazit, ishte gaz i keq, ndërsa sytë i shkëlqenin me ligësi.

- C'bën këtu, është gardjania jote.

- Dil jashtë!- e urdhëroi ajo duke i treguar derën.

Befas, ai ngriti dorën dhe e goditi në fytyrë. Goditja ishte aq e fortë, sa ajo humbi ekuilibrin e u rrëzua.

- Putanë!- e pështyu ai.- Dua paratë e mia!

Era e shikonte e tmerruar. Kush ishte ky, që e quante ashtu?

- Sa para kërkon prej saj? Ti jap unë! - dëgjoi Teutën.

- E di ajo. Dua dhe interesat!

- Sa? Bjeri shkurt! Ti jap tani e dil nga kjo shtëpi!

Cfarë, të dilte, pas asaj që i kish bërë? Dhe me para në dorë? Era nuk u besonte veshëve, nuk i kish borxh kujt. Nuk dinte se çfarë e zemëronte më shumë, ai burrë i huaj që kish hyrë ashtu në shtëpi, e kish goditur, sharë e kërkonte para apo... Teuta. Nuk ishte Teuta që njihte kjo që po fliste... U çua me mundim e kafshoi buzën që të mos rënkonte nga dhimbja e plagës së operacionit.

- Ja jap unë. Një minutë sa të shkoj t'i marr! - I tha me ton të vendosur atij që kish shtrirë një buzëqeshje triumfuese mbi fytyrë.

- Dua dyfishin!

Ajo e shikoi në sy pa ju dridhur qerpiku. Dyfishin do të kesh bir bushtre, mendoi. Ta jap unë, dyfishin. Këmbët e çuan në sallonin e madh ku e kishin futur ditën e parë. Në qoshe, pas derës, ndodhej një raft me dyer xhami, ku ishin vendosur në vitrinë armë gjahu. Ishte dhe një karabinë e vjetër aty, atë dinte ta përdorte. Kish mësuar kur kishte bërë stërvitje ushtarake në shkollë. Rafti ishte i mbyllur me çelës. Ku ishte çelësi? Nuk e dinte dhe nuk kishte kohë të kërkonte. Mendimi se gjyshja e saj ndodhej vetem me atë burrë të rrezikshëm... Rrëmbeu një karrike dhe desh ta përplaste pas xhamit të kanatit të raftit, por ndërroi mendim. Shumë zhurmë, do të tërhiqte vëmëndjen atij e do të vinte të shikonte se ç'po ndodhte. Mbi tryezë ishte një vazo mermeri. Tërhoqi një nga tapetet e dhomës dhe e vuri ngjitur me këmbët e raftit. Mori mbulesën e qëndisur të tryezës e mbështolli vazën me të. Goditi fort. Krisma e xhamit që u thye, copat e tij që binin mbi tapet e... një copë ra mbi dysheme me tingull çjerrës...

- C'po kurdis aty? - zëri i tij, i erdhi i frikshëm e kërcënues.

- U vrave bijë?- e pasoi zëri i merakosur të Teutës.

- M'u thye një vazo! - thirri Mira duke mbajtur veshët ngrehur se mos dëgjonte hapat e tij. Mori pushkën dhe e shikoi me kujdes. Nuk ishte gabuar, ishte si karabinat e zborit. Në fund të raftit ishte një kuti me fishekë. Tërhoqi ngadalë e me kujdes shulin, futi fishekët në fole, duke shtyrë ngadalë shulin që të mos kërciste.

- Nuk do të rri gjithë ditën këtu! Luaji vithet putanë!

Mos u bëj merak, se i luaj unë, mendoi tek doli nga salloni në korridor e pështeti pushkën në sup. Mendoi e tmerruar se nuk kish gjë në terezi, mezi mbushej me frymë e dridhej e tëra. Nuk mund të gjuaj në këtë gjëndje, mund të qëlloj Teutën. Megjithatë nuk ndaloi.

- Ej, qetësohu, ç'bën ashtu!?- zëri i tij e kish humbur sigurinë e ai dukej i frikësuar.

- Dil jashtë! - e urdhëroi e alarmuar Teuta.

- Rri aty!- ulëriu Era e bëri edhe një hap përpara. Ai shikoi një çast të dyja i hutuar. Befas nxorri një thikë dhe ja vuri Teutës në fyt duke kaluar pas karrocës së saj.

- Hidhe pushkën, ose do ta therr si gic!- bërtiti ai.

E kuptoi, në tmerrin që i akulloi trupin dhe mendjen, se ai ishte i zoti ta bënte. Por nuk e lëshoi pushkën, veç uli paksa tytën. Shikimi i saj hasi sytë e Teutës diçka vetëtiu në to. Priti një , dy, tre. Teuta shtërngoi duart mbi rrotat e karrocës dhe eshtyu me forcë prapa. Goditja e gjeti burrin në befasi, i cili nga goditja e karrocës u zhvendos në të djathtë të saj. Ish vetëm një moment, por Erës i mjaftoi. Shënoi dhe tërhoqi këmbëzën. Plumbi e kish kapur në kofshë dhe ai ra ndenjor mbi dysheme duke sharë e duke mallëkuar. Ju afrua dhe i qëlloi mbi këmbën tjetër. Tashmë gjaku i ishte ndezur e i kish lënë rrugë zemërimit. Pa përfillur thikën që ai mbante ende në dorë ju afrua edhe më.

- Deshe vithet e mia, ja ku i ke, - ajo ja pështeti tytën e pushkës mbi zinxhirin e pantallonave. Befas, Teuta ja rrëmbeu armën nga dora.

- Më quajti putanë! - protestoi Mira duke e parë me zemërim.

- Thikën! Hidhe thikën!- Teuta injoroi Erën. Armën e mbante të drejtuar kundër tij.

Burri e hodhi thikën në dysheme. Era e mori dhe ju prenë gjunjët kur pa gjak në të. Vetëm atëherë shqoi një vijë të hollë gjaku që zbriste në lëkurën e fishkur të qafës së Teutës.

- Gjyshe! - klithi, - Je plagosur ?

- Eshtë vetëm një gërvishtje. Mbaje tani pushkën se duhet të thërras policinë. Telash të bukur kemi kombinuar sot! - nuk e fshehu qortimin ajo. Pa gjyshen tek kapi receptorin e telefonit. Një gjest i thjeshtë që e kish parë me mijëra herë e solli në realitet. Policia! U pendua për atë që kish bërë. Më mirë ti kishte dhënë ato para... ta kishte larguar pa zhurmë... C'kish kombinuar ashtu, ç'i kish thënë mëndja? Përfytyroi shtëpinë të mbushur me policë e hetues e kushedi se kur do të shkuleshin. E ajo që kish dashur të bënte një darkë e të ftonte... Dëgjoji të lehurat e Bobos dhe gërvishtjet në derë, e kish harruar jashtë. E futi brenda dhe ai ju hodh sipër burrit të huaj, i cili ra mbrapsht me shpatulla të mbërthyer mbi dysheme. Bobo, i vuri këmbët e përparme mbi gjoks e ju skërmit në fytyrë. Kjo i kallu datën atij dhe hapi sytë i tmerruar. E kush nuk do të tmerrohej nga dhëmbët e mprehtë të Bobos? Gjynah që nuk qëlloi të ishte brenda, mendoj Era, nuk do të kish ndodhur e gjithë kjo. U dëgjuan sirenat e makinës së policisë dhe autoambulancës që qëndruan para shtëpisë. Vendosi me ngadalë armën mbi divan e shkoi të hapte derën. Le të bëhej ç'të bëhej. Le ta arrestonin. Në këtë pikë, aq i bënte edhe asaj. Ishte e zemëruar me veten edhe me Teutën. Ta kish vrarë atë ndyrësirë që kish vënë dorë mbi të dhe gjyshen.

- & -

Pothuaj në një kohë me policinë dhe autoambulancën, mbërriti dhe Miri dhe Agroni. Kjo ja rëndoi me shumë ndërgjegjen Erës. Mund të përballonte këdo, vetëm ata jo. Ndjeu shikimin e tyre pyetës e zhbirues dhe gjithë guximi ju fashit e u zvogëlua dhe si një kafshë e plagosur u fsheh në skutat e shpirtit të saj. C'tu thoshte, se gati kish vrarë një njeri sepse e kish ofenduar, se këtë njeri nuk e njihite fare, e... do ta besonin? E dreqosa keq, mendoi me vete. Por vëmëndja e tyre në fillim u përqëndrua tek i plagosuri të cilit mjeku i urgjencës po i ekzaminonte plagët. Ai rënkonte. Kur mjeku mbaroi ekzaminimin, një polic ju afrua dhe i tha se ishte i arrestuar dhe ishte e drejta e tij të mos fliste pa praninë e avokatit. Shikimii tij hasi atë të Erës.

- Putanë, do të ma paguash shtrenjtë! - i briti ai.

- Mbyll gojën! - ju afrua Miri.

Polici që siç duket kishte gradën më të lartë pasi të gjithë i bindeshin, tërhoqi mënjane Mirin që dridhej nga zemërimi.

- E njeh këtë person? - ju drejtua Erës.

- Jo,- ja preu shkurt ajo.

- Duhej të të kisha vrarë atë natë, putanë e fëlliqur!

E zemëruar ajo bëri përpara drejt barelës që po e zhvendosnin. Një polic desh ta ndalonte por shefi i bëri shenjë që linte.

- Për ç'natë e ke fjalën? – pyeti ajo. Në këtë pikë duhej të sqarohej.

I panjohuri e pa një hop i habitur. Si kish mundësi të kish harruar... dhe kish qenë një dajak ai...

- Herën tjetër nuk do ta harrosh, të betohem! Tablotë e Pikasos do të jenë vetëm kopje të këqia...

- C'më ke bërë atë natë?

Babai ju afrua dhe e tërhoqi nga krahu.

- Mos fol më, - i tha, - kam thirrur avokatin.- Por ajo as që donte t'ja dinte.

- C'më ke bërë atë natë?- i klithi .

- Ate që meritoje, ta kam bërë përshesh fytyrën...

Infermierët lëvizën barelë e Mira i ndoqi pas.

- Kur ka ndodhur kjo? C'datë ish?

Ngërdheshja shëmtoi tiparet e tij.

- Bushtër, duhej ta kishe shënuar në kalendar njëzetentë majin, – ishin fjalët e fundit të tij tek e nxirrnin nga dera. Kjo datë nuk i tha asgjë. Ashtu siç ishte e trullosur, bëri rrugë mes grumbullit të policëve ju afrua gjyshes që po e mjekonin.

- Duhej ta kishe lënë në azil! - qortimi ishte therrës në zërin e të atit.

- Nuk kishte faj ajo, - Teuta e kishte marrë veten dhe nga timbri i zërit të saj kuptoi se kish marrë anën e saj. Shefi u afrua me një bllok në dorë.

- Tani më thoni si ndodhi!

Mira e shikoi me kujdes, këtë njeri e njihte, diku e kish parë. Teuta filloi të fliste e të tregonte që nga momenti që kish rënë zilja e derës, se si e kish goditur e përplasur Erën përtoke, se kish kërkuar para dhe... se si ishte çuditur vetë ajo kur kishte parë mbesën të shfaqej me armë në dorë, thikën tek i mbeshtetej në rrylin e fytit dhe i kish marrë frymën... Dhe po të mos ishte për time mbesë... Teuta ngriti dorën për ti bërë shenjë policit të mos ndërhynte me pyetje pa mbaruar ajo. E ligjërata e saj ishte e gjatë. Pasi përfundoi përshkrimin e ngjarjes me hollësi, filloi të bënte aludime se ishin mangësitë e punës së policisë që kriminelë të tillë sulmojnë e rrahin gra të pambrojtura. Këtë e tregon më së miri kjo që ndodhi sot këtu, ju drejtua ajo shefit, dhe errësoi shikimin duke vazhduar ta shihte drejt e në kokërdhokë të syrit. Polici që nuk mundi t'i rezistonte këtij shikimi, ju kthye Erës.

- Eshtë rradha juaj!

- I tha të gjitha Teuta.

- Kur e keni njohur atë person?

- Nuk e njoh! - tha ajo prerë.

- Mendohuni mirë zonjë, ai është...

- Mjaft!- ndërhyri Miri,- nuk lejoj që ta pyesni gruan time pa praninë e avokatit. Tani duhet të mbërrijë.

Polici pa orën, e ky gjest, mënyra se si mënjanoi kokën... Si nuk ish kujtuar? E kish parë në rajonin e policisë, ditën e... e kishin shpënë atje sepse kish akuzuar dikë se i kish vjedhur shtëpinë... Ky ishte polici që kish folur me mjekun. Sa kish qenë data atë ditë? Rrudhi ballin duke u munduar të kujtohej. Ajo... kish vënë këmbë në këtë shtëpi, e shoqëruar nga policët e tij, me datë tridhjetë Maj. Po sikur të ngatërrohej?

- Miri, - i pëshpëriti të shoqit, - kur jam kthyer në shtëpi?

- Më tridhjetë Maj, - u përgjigj ai me zë të ulët pa e parë në sy.

- Përkon me atë që tha ai, mbrëmjen e njëzetën të majit mund të kesh qenë me të.- ndërhyri polici.

- Prit avokatin, Era, ta hajë dreqi! - shfryu i ati.

U menda një hop e ngriti bluzën. Si një hije, një njollë vinte e i errësonte ijen e zgjatej sa i mbulonte edhe shenjën e operacionit kur i kishin hequr veshkën. Shqoi keqardhje në sytë e Mirit.

- Vallë mendoni se nuk do ta kem këtë shenjë nesër?- ju drejtua policit.

- Nuk e di ku do të dalësh, - ja kthye ftohtë ai.

- Nuk e di se ku dua të dal?- ju gërmush ajo.- Me datë 30 maj më keni çuar në rajon dhe më keni detyruar t'i nënshtrohem vizitës së mjekut. Nuk kisha shenja të tilla. Ai burrë, tha se më kish rrahur paq. Më keni bërë dhe analiza të

gjakut dhe urinës. Nuk i pashë rezultatet, por dëgjova mjekun që tha se nuk isha e droguar. Duhet të keni një raport të shkruar në komisariat, apo gabohem. Apo e keni zhdukur?

Polici heshti një moment, në mendjen e tij ky rast ishte i qartë e i qeruar, ai ishte trafikant e shpërndarës droge dhe kjo grua përdoruese e saj. Por nëse kish të drejtë...

- C'pret?- zëri i Agronit ishte autoritar edhe se tradhëtonte padurim. - Telefono në komisariat, se për atë Zot, nëse ime bijë ka të drejtë...

Polici nuk e la të vazhdonte. Brenda tij u ngrit ajo bezdia e vjetër që i shkaktonin njerëzit që me para mund të blenin gjithshka, avokatë, gjyqtarë, dëshmitarë...Do të kish qejf ta shtinte brenda atë grua, qoftë edhe për pak. Nxorri celularin e formoi numrin duke u larguar prej tyre. Era rrinte si mbi gjëmba. Po sikur ta kishin zhdukur a humbur atë procesverbal, po a kish mundësi? E pse jo, pak gjëra të çuditëshme i kishin ndodhur kohët e fundit e ajo nuk u jepte dot spjegim? Të heshtur, ja kishin ngulur sytë shpinës së policit që kishte dalë në oborr e vazhdonte të fliste në telefon. Më në fund, mbylli telefonin e hyri brenda. Ajo vështroi me bisht të syrit të atin, Mirin e Teutën dhe ankthi që shqoi në fytyrat e tyre e bëri të ndjehej keq. As ata nuki kishin besuar.

- Keni të drejtë zonjë përse i përket datës. Më konfirmuan se është ashtu siç thoni ju. Por kjo nuk vërteton se nuk e keni njohur më parë këtë person. Do të bëjmë hetimet.

Një psherëtimë lehtësimi doli nga krahërori e Mirit. Në derë u shfaq një burrë me kostum gri që mbante një çantë në dorë. Ky duhet të jetë avokati, mendoi Era tek admironte hapin elegant e njëkohësisht të sigurtë të tij. Nëse do të jetë i pajisur edhe me një tru të tillë, ja hodha. Bezdia që ju shkrua qartë në fytyrë policit kur e pa, dhe përshëndetja e kthyer pothuaj me pahir, ja forcuan këtë mendim. Nuk shkojnë kurrë dakort, përleshën aq shumë në zanatet e tyre, sa shpesh kriminelët e krimet dalin në plan të dytë, vendin e parë e zë gara se cili prej tyre është më i zoti...

- & -

Gjyqi qe një ngjarje e shëmtuar por nuk zgjati shumë. Kish dëshmitarë që e kishin parë Erën të takohej me atë burrë, por avokati që ish me të vërtetë shumë i zoti, domosdo i paguar mirë nga i ati, ju përmbajt raportit të

policisë së datës tridhjetë maj, e se nga nxorri ca dëshmitarë të tjerë që zhvlerësuan dëshmitë e të parëve dhe... e nxorri pa lagur. E keqja ishte diçka tjetër, gazetave u kishte rënë në sqep një rast që bënte bujë, ishte e bija e një njeriu të pasur. Shkruan se një ish e droguar kish tentuar të vriste atë që i furnizonte drogën, një gazetë tjetër se kish qëlluar nën efektin e drogës, dhe një tjetër thoshte se një e droguar kish qëlluar të dashurin e saj drogaxhi gjatë një zënke. Sipas tyre, në të gjitha rastet, ajo do ta kish paguar shtrenjtë nëse nuk do të ishte e bija e një pasaniku potent. Situata në shtëpi ishte e nderë, gazetatat sa vinin, zhdukeshin që në pikë të mëngjesit dhe televizori fikej në orarin e lajmeve. Babai i rralloi vizitat dhe Era e ndjeu se po kalonte në depresion. Të mos ishte për Teutën, dy të vegjëlit dhe të shoqin, nuk e dinte se si do të kishte përfunduar. Një muaj pas gjyqit, kur gazetatat kishin filluar ta harronin atë histori, Agroni erdhi dhe i tha se kish ardhur koha të shkonte etë bënte një vizitë tek psikanalisti i saj. Ajo hapi sytë, nuk kishte psikanalist, nuk kish bërë kurrë ndonjëherë një vizitë të tillë. Dësh të kundërshtonte, por pavarësisht nga toni i prerë, kish më shumë lutje në sytë e tij. Pranoi vetëm me një të tundur koke. Pasi foli një copë herë në telefon, Agroni mundi t'i caktonte një vizitë po atë ditë pasdite. Erdhi dhe e mori së bashku me Mirin në orën e caktuar. Rrugës, për në studjon e doktorit, e sulmuan sërish një mijë pyetje që nuk u gjente përgjigje, aq sa dhe rruga, ndërtesa dhe dera e studjos së doktorit ju dukën sikur kishin marrë formën e pikëpyetjes. Ngurroi një sekondë para se të hynte, pastaj e la veten në dorë të fatit. Ndoshta përgjigjet ishin aty...

- & -

Doli nga ajo derë edhe më e turbulluar nga sa kish hyrë. Sipas mjekut dhe kartelës që mbante sipër emrin e saj e që ishte aq e fryrë sa asaj ju duk si enciklopedi, e mbushur në dhjetë vitet e fundit, ajo kish qenë kohët e fundit një grua e paqëndrueshme mendërisht. Mbushur plot me pasiguri dhe ankthe, të cilat ishin shtuar me përdorimin e drogës dhe alkolit. Përsa i përkiste humbjes së kujtesës, ai u mundua ta justifikonte me djegjen e qelizave të trurit nga efekti i drogës. Nukdinte të spjegonte se si ishte e mundur që e kish lënë përdorimin e drogës, pasi kohët e fundit kish qenë një rast i pashpresë e gjendja shëndetësore e saj ishte keqësuar shumë. Por ajo ishte mirë fizikisht, edhe veshkat që një vit më parë pothuaj i kish të shkatërruara e nuk mund t'ja trampiantonin të birit... tani ndjehej mirë edhe se kishte vetëm një ndërsa Dejvi i vogël, e merrte veten përditë. Këtu ai hapi duart si të thonte se nuk mund ta spjegonte, por duhet ta pranonin si një mrekulli. Pyeti se ç'mund të bënte për të rifituar kujtesën, duke shmangur

shikimin e Mirit dhe të Agronit, shihej qartë se kjo ishte gjëja e fundit që do të donin ata. Atëherë, përse e kishin sjellë aty? C'kuptim kish e gjithë kjo, kur atë e torturonin kujtime, ëndrra e pyetje që nuk u jepte dot spjegim? E meqë kish ardhur këtu... kish të drejtë të kërkonte përgjigjet. Ishte e drejta e saj. Përse kishin ndodhur gjithë këto? E zbrazti thesin dhe nuk ju bë vonë se i shoqi dhe i ati ishin aty. I tha se mbante mënd të kish bërë vetëm dy lindje. I foli për abortet. Se i dukej sikur ai burrë që kish në krah, edhe se i ngjante shumë të shoqit, nuk ishte burri i saj. Se shpesh i dukej sikur nuk ishte vendi i saj ai aty... Se babai i kish vdekur njëzet vjet më parë... se kish qenë e varfër e ish larguar para dhjetë vjetësh në dhe të huaj me burrin dhe dy fëmijët e saj, Andin dhe Elonën... I shihte në ëndërr e kishin nevojë për të... se... se.... kjo jetë që po bënte nuk ishte e saj... I la me gojë hapur, përfshirë edhe doktorin. Ai e dëgjoi me durim e mendoi gjatë. I tha se nuk kishte asgjë të keqe në gjithë këtë, madje kjo i spjegonte të gjitha, deri në shërimin fizik të saj. Kishte zhvilluar një personalitet të dyfishtë dhe organizmi i ishte nënshtruar. Do të habiteshë po të të thoja se më ka qëlluar një rast, i kish thënë ai, një paciente me personalitet të shumëfishtë. Gruaja vuante nga diabeti, por një nga personalitet që kish zhvilluar nuk kishte diabet. Ato ditë që ajo mendonte se ishte ai person, analizat e diabetit i dilnin negative. Në rastin tënd, i tha asaj, do të ketë qenë subkoshienca nën veprimin e brerjes së ndërgjigjes dhe sëmundja e Dejvit që të kanë shpënë në zhvillimin e personaliteti tjetër. Era mbajti frymën. C'veprime kish bërë ajo, ç'gjë të tmerrshme, që e kish detyruar të krijonte një tjetër personalitet dhe një tjetër jetë imagjinare? Dhe kjo sipas tij kish qenë shpëtim për të? Pasi pa orën, mjeku i premtoi se do ta ndihmonte në rekuperimin e kujtesës dhe e këshilloi të fillonte të punonte. Cfarëdo lloj pune, mjaft që të jetë jashtë mureve të shtëpise. I caktoi ditën dhe orën e vizitës që duhej të bënte çdo javë. Posi jo, mendoi Mira, në më pafsh më në derë... por tek hasi sytë lutës të Mirit, pranoi. Rrugës për në shtëpi, ajo pikëpyetje u kthye në pikëçuditëse. Vallë, ka mundësi të kem një fantazi kaq të sëmurë për të trilluar histori të tilla e t'i besonte me gjithë shpirt? Agroni me Mirin ishin relativisht të qetë, kishin besuar doktorin. Nëse e besojnë ata, pse të mos e besoj edhe unë? A nuk kish parë tërë atëdosje kartelë, mbushur aq sa i kish shtirë frikën? E fundja, pse të mos besonte edhe ajo? Ah sikur! Mbylli sytë. Përpara ju shfaq një udhëkryq. Njëra rrugë e çonte larg, me Mirin, Andin dhe Elonën... tjetra mbaronte aty pranë me... gjithë sa dëshëronte megjithë shpirt... por nuk i besonte. Të shohim se ç'do të nxjerrin seancat e tjera, tha me vete ajo.

Kish kaluar gati një vit. Dyshimet e pikëpyetjet pak nga pak u zbehën. Kish pesë fëmijë të mirë e të bukur që ja kishin zili të gjithë, e megjithëse pika e saj e dobët ishte Andi me Elonën, pikërisht me ta u lodh derisa restauroinjë raport për të qënë, duke lënë pas dore Arbenën. Ose kështu ju fiksua kur u ndodh para një realiteti tjetër të hidhur. Një mëngjes, Arbena hyri në dhomën e saj duke ju lutur:

- Mama, të lutem më jep hua një dozë!

- C' dozë? - pyeti Mira .

- Mos bëj sikur nuk kupton. Ti e merr, veç se e fsheh kaq mirë tani ...

Erës ju kujtua se shpesh i kish gjetur sirtaret e raftet rrëmujë e nuk i kish dhënë rëndësi duke kujtuar se Sara me Dejvin luanin aty. I ish dukur se edhe paratë disa herë i ishin prekur, por pastaj mendonte se ishte ajo nuk mbante mend kur i kish prishur.

- Nuk fsheh asgjë. Nuk drogohem... më, - tha ajo duke u habitur me veten se si padashur kish pranuar pikërisht atë gjë që nuk e kish bërë kurrë.

Vajza doli nga dhoma duke përplasur derën e duke e lënë aty gojëhapur. E ndoqi duke i vrapuar pas.

- Arbena!

Vajza bëri sikur nuk e dëgjoi dhe mori drejt makinës së saj. Po vendoste rripin e sigurimit kur e arriti.

- Duhet të flasim!- i tha prerë, - Zbrit nga makina dhe eja me mua në shtëpi.

- Do të më bësh moral!? Je njeriu i fundit në botë që mund të më bësh. Harrove që më ofroje ti ndonjë dozë...

Erës ju morën mendtë.

- Nuk është e vërtetë! - i briti.

- Kështu të intereson ty. C'lojë po bën mama? Ke arritur ta bësh babain sërish për vete dhe të çmendet pas teje. Ua ke hedhur të gjithëve. Ke filluar t'i marrësh mendjen edhe tyt eti. Por mua nuk ma hedh, je veç një hipokrite e ...

Era ngriti dorën dhe i dha një shuplakë fytyrës sa i hëngri dora e në moment u pendua.

- Më fal – ju lut.

Arbena shkeli gazin e u nis, ndërsa ajo mbeti në mes të rrugës e zuri kokën me duar. Vajza e saj... Në cepin e trurit ju ngrit mendimi se nuk ishte vajza e saj dhe ajo u tremb. Jo, nuk kish kohë të merrej me këtë mendim që nuk ishte tjetër veç një strofkull ku ajo fshihej sa herë përballëj me realitetin e mëparshëm. Nuk do të fshihej më, Arbena kish nevojë për ndihmë.

Hyri në shtëpi e gjeti Teutën të ulur mbi karrocë në mes të sallës.

- Cëk, cëk, cëk, ka diçka që nuk shkon, - ja bëri ajo.

- Asgje nuk shkon Teuta! - e kish bërë zakon ta thërriste në emër kur punët nuk shkonin mirë.

- Cëk, cëk, cëk, - ja bëri përsëri Teuta.

Ju afrua telefonit. Në mëdyshje, ndenji një copë herë me receptorin në dorë, pastaj formoi numrin me shpejtësi, kish frikë se ndërronte mendje. Mbajti frymën tek dëgjonte zilen të binte nga ana tjetër derisa zëri që priste u përgjigj.

- Miri, eja në shtëpi! Shpejt! Lër çdo punë që ke në dorë dhe eja!

Siç duket Miri kish diçka që nuk e linte dot, filloi të përtypej ndërsa ajo e humbi durimin.

- Pash atë Zot! Për dhjetë minuta të dua në shtëpi! - ulëriu dhe e mbylli.

Pas një çerek ore, makina e Mirit u duk në krye të rrugës. Nuk ishte vetëm, Agroni ishte me të. Me shumë se me zemërim, kjo e mbushi Erën me ndroje. Ja ku janë të dy tani, para saj e prisnin që të fliste. C'tu thosh, se ajo e kish ditur me kohë që vajza drogohej dhe më e keqja...

- Era ç'ka ndodhur? - pyeti i preokupuar Miri që vuri re zbehtësinë e saj. - Nuk ndjehesh mirë?

- Mirë është, - foli në vend .

- Arbena...- foli ajo duke ulur sytë përdhe për të fshehur turpin që ndjente.

- Cfarë i ka ndodhur, fol ta marrë e mira! - Miri ngriti zërin. Në një rast tjetër ajo do të bëhej kokëfortë e nuk do t'i përgjigjej.

- Më kërkoi një dozë sot në mëngjes. Arbena drogohet.- i tha duke e parë drejt e në sy e i erdhi keq kur pa tmerrin që bëri fole menjëherë aty.

- Je e sigurtë!- mërmëriti ai.

- Më tha se... më parë i jepja unë ndonjë...- Era shpërtheu në dënesë.

Miri u pa sy me sy me Agronin.

- Deri këtu ke arritur!?

Një çast u dëgjuan vetëm dënesat e saj. Të tjerët rrinin të ngrirë. E para e mori veten Teuta, e cila i bëri shenjë Verës dhe Silvës të largoheshin. Pastaj ju kthye burrave.

- Mos u merrni tani të gjeni kush e ka fajin, e lagu, s'e lagu. Mendoni se ç'duhet bërë për vajzën para se të na iki nga duart.

- Sa kohë ka që merr drogë?

Era mblodhi supet. Pastaj u tregoi për rrëmujën në sirtare dhe paratë që i mungonin në portofol. Pak çaste më parë nuk ishte e sigurtë, por me minutat që kalonin, dyshimi ju kthye në bindje.

- Nuk e dimë se në ç'stad është, - Agroni nxorri celularin.- Po marr takim me një mjek specialist ose me psikanalistin tënd.

- Jo!- tha prerë Era.- Duhet shtruar në një klinikë reabilitimi, dhe sa më shpejt aq më mirë. Nëse mua nuk më ka bërë efekt ajo mënyrë, nuk do t'i bëjë as asaj.

Agroni futi celularin në xhep.

- Më duket mendim i mirë, veç nëse Miri nuk ka kundërshtim.

U kthyen nga Miri dhe ajo vuri re se duart e tij dridheshin.

- Ti mendon se është më mirë kështu?- ju kthye ai Erës.- Vajza ime të shtrohet në një klinikë reabilitimi për t'u ç'intoksikuar nga droga e ne të rrimë këtu duarkryq? Kur për më tepër kemi edhe ne një pjesë të fajit... Ti...

- Mjaft!- briti Era.- C'kujton ti se e don më shumë vajzën? Se mua nuk më dhëmb shpirti kur e mendoj të mbyllur atje? Nuk do të rri duarkryq, do të shkoj me të!- i ktheu krahët e hyri në dhomën e saj. Duhej të bënte gati plaçkat.

- & -

Qëndrimi i Arbenës në klinikën e intoksikimit nga droga zgjati disa muaj. Era, që në fillim u mundua të ndahej mes shtëpisë dhe së bijës, me gjithë keqardhjen e dhembshurinë për të tjerët, e ndau mendjen t'i kushtohej së bijës. Mori një dhomë me qira në klinikë dhe qëndroi aty ditë e natë e përjetoj me të ferrin e vështirësitë e dizintoksikimit. Mendimi se kish një pjesë të konsiderueshme të fajit për gjendjen në të cilën ndodhej vajza, i shkaktonte dhimbje të pamasë. Por nuk ishte vetëm, e gjithë familja e mbështeti, vinin i shihnin çdo ditë, u jepnin zemër, ajo nuk ishte vetëm. Ndërsa e bija ...ajo qënje e dashur që Mira rrinte dhe e vështronte në çastet pas krizave, të zbehtë, të lodhur, e që ndjehej krejt vetëm dhe e pambrojtur... I bëri një betim vehtes, nuk do t'a braktiste kurrë as atë dhe as të tjerët. Në djall dyshimet e mendimet e saj, mjaft ishte treguar egoiste e kishte menduar vetëm për vete. Kish ardhur koha të mendonte seriozisht për familjen e saj.

- & -

Agroni kish ditë që nuk përqëndrohej në punë. Mbesa e tij, shpejt do të dilte nga klinika, e bashkë me të do të kthehej në shtëpi edhe Era. Një ndjenjë e vjetër dhëmbshurie kish nisur të ngrinte krye. “Gjaku nuk gënjen”, i shkuan nëpër mend fjalët e së ëmës që ja thonte sa herë që ai ishte nxehur e inatosur me të bijën. Jo pak, dhjetë vjet, e bija kish kombinuar vetëm telashe, e kish turpëruar e poshtëruar në atë mënyrë sa ai nuk kish dashur ta shihte më me sy. Fat, që i kish qëlluar një burrë, që e kish dashur shumë dhe e kish falur, edhe se ai kish këmbëngulur të kundërtën. Ndryshe, kushedi se si do ta kish hallin. Një burrë tjetër edhe mund ta kish vrarë. E kish tradhëtuar me shokun më të ngushtë, i kish vjedhur, e kish braktisur disa herë. Ishte marrë me punë të dyshimta për të siguruar paratë e drogës. Ndërsa Miri, e kish pritur e nuk e kish përzënë kurrë. Ju kujtua ajo kohë kur gazetën fillonte ta lexonte në faqen e kronikës së zezë, me ankthin që i merrte frymën se mos aty shihte emrin e së bijës, të vrarë e të sakatuar nga dora e krimin në të cilin ishte zhytur. Agroni mori frymë thellë. Shyqyr zotit kish kaluar ajo kohë. Madje i dukej e largët. Era kish ndryshuar, nuk kish asgjë të përbashkët me atë të dikurshmen. Sikur nuk ishte e njëjta...

- & -

E lumtur!? E përse jo? Kishte një shtëpi të bukur, një familje të mrekullueshme, paratë nuk i mungonin. Prindërit e saj gëzonin shëndet të mirë dhe gjyshja dukej sikur ishte rinuar e bërë edhe më gazmore. Psikanalisti vazhdonte të merrte paratë për seancat javore, por fundja i kish me hak. Kish gjetur përgjigjet që kërkonte. Kish qenë një grua e pasur që nuk i mungonte asgjë, e kish rrëshqitur. E kish filluar me alkolin, e kish pasuar me drogën. Me pas ndonjë tradhëti e vogël dhe pakuptimtë që e kish bërë të zhytej më tej në llum. Pastaj kish filluar të ikte nga shtëpia. Babai ish zemëruar e nuk donte t'ja dinte më për të, i shoqi ishte dhënë më shumë pas punës. Goditja e fundit, Dejvi kish patur nevojë për atë veshkë dhe ajo edërmuar nga alkoli dhe droga nuk ishte në gjendje t'i përgjigjej. Kjo e kish shkundur, e kish bërë të mendonte se sa gabim kish vepruar por ishte shumë vonë. Nuk i hynte kujt në punë pendimi i saj. Ai ëngjëll i vogël do të vdiste pasi nëna e tij nuk mund ta ndihmonte. Ishte zhytur edhe më thellë në llumin ku kish zbritur me shpresë se do të vdiste shpejt, më shpejt se i biri. Pastaj... nuk e dinte se si kish

ndodhur, në mendjen e saj ishte krijuar një personalitet tjetër në një realitet tjetër, krejtësisht të kundërt me të sajën. Një realitet që nuk do ta linte të binte në ato gabime. Kish gjetur përgjigjet e saja. Nuk kish rëndësi ç'kish bërë në të shkuarën, rëndësi kish që ajo ishte përsëri me fëmijët e saj dhe ishte nënë e mirë. Miri? Ende jo, po me kohë do të rregullohej edhe me të.

- Mendoj se duhet të fillosh të punosh. Gjej një punë.

Tërë genia e Mirës kish marrë formën e pikëpyetjes para doktorit.

- Cfarë lloj pune?

- Fol me babanë tënd,- ju përgjigj shkurt doktori dhe asaj i erdhi inat që ai përmendte vetëm atë, sikur të mos kish burrë. Fundja, nuk ka faj, është ai që e paguan, mendoj ajo.

Kërkesën e bëri një mbrëmje që ishin mbledhur të gjithë për darkë. Diku thellë, dëshironte kundërshtonin e ta bindnin të hiqte dorë. Në fakt, një stuhi e akullt pështolli tryezën, e ajo lexoi ankth e mosbesim në sytë e të gjithëve, e kjo e lëndoi. Nëse nuku pëlqente, t'i thonin se kishin dëshirë ta kishin në shtëpi, se kishin nevojë për të aty, por jo ta shihnin në atë mënyrë. Dëgjohej vetëm kërcitja e pirunjve dhe e thikave tek preknin pjatat.

- Baba, dua të filloj punë, çfarëdo!- ju drejtua prerë atij.

- C'punë mund të bësh? Universitetin e ke lënë përgjysëm, më mirë fillo e studjo...

- Sekretare në seksionin tim!- Miri lëshoi pirunin në pjatë. -Lira merr lejen e lindjes. Nesër tërheq kërkesën që i kam bërë zyrës së punës për zëvendësuese.

- Vajza ime sekretare!- shfryu Agroni.

- Do të jetë sekretarja ime.- ja preu Miri.

- Nëse do kështu...- rrudhi supet Agroni dhe nuk e zgjati më muhabetin.

- & -

Veç pak muaj që kish filluar punë e në fakt ishte pënduar. Miri i bënte pothuaj të gjitha vetë dhe ajo e gozhduar aty në tryezën e punës me telefonin përpara, mendonte grumbullin e punëve e të problemeve në shtëpi. Të ishte për të, do t'ja ja mbathte në çast, një kafe me Teutën ishte shumë më mirë, por i vinte turp. Miri mundohej ta rrethonte me kujdes e përkujdesje. Priste me padurim orën kur Sara me Dejvin kthenin aty kur dilnin nga shkolla përpara se të shkonin në shtëpi. Atëherë merrte ashensorin e zbriste poshtë e kalonte disa minuta me ta. Sa për punën, ato pak gjëra që i linin për të bërë ua mori dorën që në fillim. Mund

t'i bënte edhe me sy mbyllur. Një ditë tek zbriste, në ashensor ishin edhe dy burra. E panë nga koka tek këmbët dhe i buzëqeshën njëri tjetrit. Kjo i dha bezdi e u mundua të mos i kthente sytë na ana e tyre, por veshët nuk i mbyllte dot. Ju drejtuan edhe qimet e kokës nga zemërimi, thonin se ishte e bija e pacipë e padronit, se kish shkuar me një stadium të tërë... se një ditë do të fillonte prapë e ndoshta... se padroni nuk e kishte të gjatë, zaret ishin hedhur dhe... Përmbajti me zor veten për të mos reaguuar nga frika se mos bënte skandal dhe Miri e linte në shtëpi. Në shtëpi do të rrinte kur të donte ajo, jo kur ta linin. Ktheu kokën dhe i pa më me vëmendje dy zotërinjtë që bënë sikur po shikonin nga ana tjetër. Ishin të veshur mirë. Ajo ishte skuqur deri në rrëzë të flokëve. Maskarenj! Ua nguli sytë me inat dhe kjo i vuri ata në siklet. "Mos na ka kuptuar", njëri prej tyre pyeti tjetrin. Tjetri filloi të qeshë," ajo... të kuptojë gjuhë të huaj, jam i bindur se as të vetën"... Ashensori kish mbërritur në katin e poshtëm e dera u hap. Të pacipët, e përshëndetën me njerëzi e dolën duke qeshur duke e lënë Mirën me sy të çakërritur. Gjuhë e huaj?! E kish turbulluar aq shumë kuptimi i atyre fjalëve në adresë të saj sa ishte hutuar e nuk kish menduar se ishte gjuhë e huaj. E ajo e njihnte atë gjuhë, dikur e kish studjuar. Dikur... Hoqi dorë ngapërpjekja se kur kish qenë kjo dikur e u mundua të riprodhonte në mendje atë dialog. Nuk i vinte në atë gjuhë, siç ndodh shpesh me gjuhët që nuk përdoren, mbeten të fjetura në kujtesë por... nuk harrohet kuptimi i tyre. Ishte... rusisht... Shpejtoi hapat dhe i arriti të dy zotërinjtë para se të dilnin nga ndërtesa.

- Më falni, çfarë gjuhe po flisnit?

Ata u panë në sy.

- Rusisht. – tha njëri prej tyre.

-Më falni edhe një herë,- tha ajo e u ktheu krahët.

- & -

U kthye në zyrë duke vlarë mendjen. I kish kuptuar apo truri i saj i sëmure po i sajonte lojëra të tjera. Duhet të jem vërtet e sëmure, rënkoi pa zë, aq sa... ndoshta mendja ime i ka shpikur të gjitha. Mori në telefon psikanalistin e saj dhe fiksoi një takim për të nesërmen, sot nuk mund ta priste. Shikoi orën në mur e llogariti orët që e ndanin nga takimi. Të paktën me të mund të fliste për këto gjëra, Mirit dhe Agronit nuk mund tua thoshte, do te alarmoheshin e do ta konsideronin të

sëmurë. C'do ti thoshte doktorit? Hapi internetin e kërkoi një fjalor të gjuhës ruse. Alfabeti nuk e befasoi, i njihte shkronjat. Edhe mjaft fjalë. Kërkoi e bëri një test në ruisht. Nuk doli keq, sigurisht jo të gjitha fjalët, por shumicën i dinte. Mbylli kompjuterin dhe u mundua të merrej me ndonjë punë vetëm e vetëm... të largonte nga mendja e saj bindjen se ajo dikur r kish studjuar atë gjuhë, që në moshë të njomë, në bankat e shkollës... në kohën e diktaturës ishte e detyrueshme... Apo dhe diktaturën...

- Kam bërë ndonjë kurs të gjuhës ruse?- pyeti sapo pa Mirin që hyri në zyrë.

- Jo, - u përgjigj shkurt ai duke ulur kokën mbi një projekt.

- Po në Rusi, kam qenë ndonjëherë?

Ai e pa i zënë ngushtë e faqet ju përskuqën lehtë.

- Me sa di unë jo, - tha ngadalë dhe në ato fjalë ajo kapi nënteksin se ai nuk e kishte idenë se nga mund të kish shkuar ajo gjatë mungesave në shtëpi. Vendosi të mos e ngiste atë muhabet me të. Kur u kthye në shtëpi i bëri shenjë Teutës dhe shkoi e priti në dhomën e saj. Teuta e qetësoi. I tha se ajo kish pasur një shoqe ruse që kish mbetur këtu pas lufte e cila kish një mbesë moshtare me Erën. “Nuk e mban mend Ljubën”, i tha ajo, “i kemi pasur shtëpiat ngjitur”. Nina mundohej t’ju mësonte të dyjave gjuhën e saj pasi Ljuba kundërshtonte. Nuk e kishte fare me qejf ndërsa ty të pëlqente. Ty të pëlqente dhe italishtja që ta mësoja unë që kam studjuar në Itali. Siç duket, i tha, po të kujtohet një gjuhë që ka mbetur e fjetur në trurin tënd, e kjo është shenjë e mirë”. Nuk e dinte ose nuk e mbante mend se gjyshja kish studjuar jashtë shtetit, dhe shprehu qartë mosbesimin e saj. Teuta nxorri nga rafti i saj një kuti të vogël të bukur në të cilën ishin një tufë letrash të lidhura me një fjongotë bardhë. “Janë letrat e një shoqes sime të kolegjit”, i tha ajo, “provo ti lexosh, ndoshta e mban mend edhe këtë gjuhë”. Era mori dhe hapi të parën. Një letër e thjeshtë, me pyetje për shëndetin, problemet, mallin dhe dëshirën për t’u parë e për të kujtuar kohët e vjetra. Letra përshkohej me thënie nga bibla dhe e besimit tek zoti dhe... në fund... Era mbeti pa frymë. Ishte nënshkruar thjesht: Gonxhe Bojaxhiu. Pa datën. Kalkuta, data korrespondonte jo më shumë se dy javë më parë.

- Nënë Tereza?! Që kur ke filluar të mbash korrespondencë me paraajsën?

Teuta qeshi kumbueshëm.

- Të gjithë e quajnë kështu shoqen time fisnike. Për mua është Gonxhe, e sa për paraajsën, Kalkuta nuk më duket e tillë.

- Që kur shenjtorët kanë filluar të zbresin nga parajsa? Ka gjashtë vjet që ka vdekur dhe është shpallur shenjtorë.

- Vdekur? Mos e ngatërron me ndonjë tjetër, para dy javësh kam marrë letrën e fundit, ose ... ka ndonjë gjë që nuk e di unë? Mos i ka ndodhur gjë këto ditë? - sytë e Teutës ishin shumë të shqetësuar.

- Rri e qetë, bëra shaka, asgjë nuk ka ndodhur, - tha Era dhe doli nga dhoma duke e lënë derën hapur.

- o -

Gjumi hodhi rrjetën e tij e mbërtheu ëndrrat e njerëzve të shtëpisë, e qetësinë e prishnin vetëm tiktaket e orëve në mure, u ngrit nga shtrati dhe shkoi në studion e Mirit ku ndodhej një raft i madh me libra. Mori një vëllim të trashë historie e pasi u rehatua në një kolltuk filloi ta shfletonte. Shfletoi me shpejtësi faqet e para e ndaloi pas luftës së dytë botërore. Këtu habia e saj rritej gjithnjë e më shumë. Kërkonte historinë e dikaturës, të shihte se si trajtohej tani ajo periudhë që kishte bërë aq shumë dëme në shpirtin e popullit. E kish jetuar atë kohë dhe historinë e saj e kish bërë edhe në shkollë, por hipokrizia se si ishte shtjelluar ajo në librat e shkollës e revoltonte akoma. Të shikoj tani pas kaq vjetësh demokraci seç'thonë. Fletë pas flete, nuk shihte gjëkund të flitej për të. As në atë mënyrë hipokrite. Sikur nuk kish patur kurrë diktaturë, sikur nuk kish patur socializëm. Sipas atij libri, kampi socialist nuk e kish futur dot në kthetra vendin, ishte bashkuar meperëndimin. Ishte ndërtuar një rend demokratik dhe falë pozicionit të favorshëm kishte gëzuar dhe përfitur nga përkrahja dhe ndihma e Amerikës. Në pak vjet, nga një vend i prapambetur gjysmëfeudal, ishte shndërruar në një vend me ekonominë më të qëndrueshme në Ballkan. Diku hasi emrin e Enver Hoxhës, nuk shkruhej shumë për të, kish arritur të bëhej kryetar i partisë komuniste, por partia e tij nuk ja kish dalë të bëhej aq e fortë sa të merrte pushtetin. Parti të tjera kishin lulëzuar. Shfletoi sërish fletët me nxitim. Kërkoj kohën e eksodit. As edhe një rresht. Kam lojtur, tha me vete, ose ka lojtur ky që ka shkruar këtë libër. Mbylli librin dhe e vuri në vend. Shkoi në dhomën e saj e u shtri në shtrat. Kush kish lojtur? Valët e detit që çaheshin nga bashi i anijes, shfaqja e bregut tjetër, ajo drithmë e lehtë pasigurie e ngurrimi kur shkel mbi dhe të huaj, ai pallat, ajo shkallë që ngjit kur kthehesh e lodhur dhe e raskapitur nga puna, ishin aq reale në mëndjen e saj atë çast. Jo më pak se një ditë më parë, kishin filluar të vishnin petkun e harresës. Vallë a donte ajo ti harronte? Arësyeja i thosh se po. Zemra përpëlitej në njëmijë drithërima. Gjithë ato sakrifica, shpresa, zhgënjime, pjesë e... jetës së saj... Imagjinare... Edhe po të ishin imagjinare, shpirti i saj e kish thurrur këtë fole për tu fshehur e mbrojtur. Ndiente se arësyeja do të fitonte në fund e ajo do ti humbte. "Mos humb kohë, i tha vetes, shkruaj para se veli i harresës dhe arësyes ti mbulojë e fshehtë përgjithmonë". U ngrit ndenjtur mbishtrat e ndezi

abazhurin mbi komodinë. Hapi sirtarin e nxorri bllokun e stilolapsin. Bëri skicën e qytetit ku mendonte se kish jetuar vitet e fundit, rrugën, pallatin, vuri emrin e rrugës, numrin e shtëpisë, adresën e punës, shkollën e Andit e të Elonës. Përshkoi buzëqeshjen e Andit që e priste kur kthehej e lodhur nga puna, karakterin e vështirë të Elonës. Se sa ishte trishtuar në fillim kur kish parë fytyrën e bukur të vajzës të mbuluar nga truku, kish menduar se do ta humbte përgjithnjë pamjen engjëlllore, se si pastaj kish ndryshuar e kish filluar të bënte një tualet të lehtë e të vishej me shije. Ju kujtua ajo natë kur kërkonte Mirin, e përjetoj dhe e shkroi të tërën nga adresa e shtëpisë së koleges së tij të punës deri tek ura. Si quhej ajo urë? Ju kujtua, ashtu siç ju kujtua se prej parmakëve të saj ishin hedhur shumë vetë. Një kolegia e saj, i kish treguar se një dite kish dashur të hidhej prej aty, e lodhur nga jeta e vështirë që bënte me të shoqin pijanec. Por e kish ndalur imazhi i syve të përplotur të vajzave të saja... “Mami mos na ler vetëm”...

- o -

Mblodhi mendjen të mos i thosh askujt se dinte rusisht pasi i shkëputi premtimin Teutës të mos e bënte fjalë me njeri. Shfletoi librat e gjuhës angleze të fëmijëve dhe pa se ishte mjaft mirë edhe me këtë gjuhë. Në botën e saj imagjinare e kish studjuar me dëshirë edhe këtë gjuhë, ashtu siç kish ndjekur e mbaruar për inxhinieri ndërtimi së bashku me Mirin. Fshehtas filloi të hapte dosjet e punës së Mirit. Projekte, preventiva që me pak mundim, mund ti dëshifronte e ti kuptonte. Madje diku ishte në gjëndje edhe të sugjeronte por gjithsesi heshti. E kush mund ti besonte këto, kur nuk arrinte ti besonte edhe vetë? Në botën e saj imagjinare... Ktheu mbrapsht gjithë shtëpinë të gjente qoftë edhe një dokument që të vërtetonte hamëndjet e saj, por kish gjetur vetëm dëftesën e shkollës së mesme, e për më tepër me nota jo të mira. Edhe një si biçim libreze notash të vitit të parë të një fakulteti mbante emrin e saj. Atëherë, si kish mundësi... Mundohej të sillej normalisht ditët që pasuan si në punë edhe në shtëpi, por përbrënda ziente. Cfarë tjetër ishte në gjëndje të bënte? Filloi të kalonte zyrë më zyrë e të mprihte veshët. Nga bisedat e ndryshme që dëgjoi, nuk e pati të vështirë të hynte në brendësi të problemeve të firmës, askush nuk ruhej prej saj. Nuk e mendonin të aftë. Një ditë hyri në zyrën ku bëhej seleksionimi i personelit dhe gjeti një grup italianësh që kërkonin punë. Mbeti e hutuar, italianë që kërkonin punë aty? Me zor dhe me keqardhje shtypi instinktin që t'ju fliste nëgjuhën e tyre. Tri gjuhë të huaja?! E kur i kish mësuar? A thua bota e saj imagjinare ishte magjike e kish aq fuqi mbi të sa e transformonte në atë realen? A mjaftonte që të dëshironte diçka atje, dhe ti

realizohej këtu? A nuk kish ndodhur kështu? Kish dashur një burrë besnik, dhe ja tek e kishte. Kish dëshëruar më shumë se dy fëmijë, dhe ja tek kishte pesë. Kish dashur të shihte babain dhe ai ishte ngjallur, gjyshja gjithashtu. Kish dashur të ishte e shkolluar dhe inteligjente dhe ja tek ishte aty me tri gjuhë të huaja dhe mund të ulej e të bënte edhe projekte objektesh madje edhe të ndiqte zbatimin e tyre. I dukej sikur jetonte një ëndërr të ethëshme dhe të bukur. Në shtëpi vinin shpesh shokët e Andit, Arbenës e Elonës dhe ajo dëgjonte biseda të temave ngamë të ndryshme. Ishte bërë e tëra veshë. Nuk merrte pjesë në to, sillej aty rrotull merrej me diçka, pa i shqetesuar, e nuk linte t'i shpëtonte as edhe një fjalë. Truri i saj ishte si sfunjër që thithte. Mësoi se Andi së bashku me një profesorin e tij, punonte në laboratorin e fakultetit të mjekësisë mbi një projekt mjaft ambicioz. Ideja kishte lindur që kur ishte sëmurur Dejvi e nuk gjehej një organ kompatibël për të. Puna ecte ngadalë e sigurisht shpenzimet ishin të mëdhaja, por ata kishin besim se një ditë do t'ja arrinin. Gjithashtu mësoi se Agroni, herë pas here i kalonte çeqe me shuma të konsiderueshme fakultetit të Andit që të mos i pengonin në kërkimet e tyre. Arbena në të kundërt, nuk donte t'ja dinte për shkencë, ish dhënë pas modës e studjonte teknologjinë e veshjeve. Gjynah që Mirës nuk i pëlqente moda e këtushme...

- o -

Qëndroi një çast mbi trotuar duke ndjekur me sy makinën që largohej e bashkë me të Sara dhe Dejvi. Pa orën dhe psherëtiu, ishte dy e drekës, ndërsa ajo duhej të rrinte deri në pesë. C'dreqin i kish hipur në kokë? Të punonte! Do ta shtyj edhe këtë muaj, mendoi, pastaj mjaft. Kishin më shumë nevojë në shtëpi për të se sa këtu në punë. Nuk e llogariste njeri, e konsideronin të pavlefshme. Hyri brenda e nxitoi të kapte ashensorin, hyri momentin e fundit para se të mbyllej dera e tij. Dyburrat që gjendeshin në të u zhvendosën në fund . Njëri ishte Borisi, një inxhinier rus që kish pak muaj që kish filluar punë aty. Kish dëgjuar nga Miri se ishte shumë i zoti në punë, i edukuar e mjaft simpatik dhe me referenca aq të mira sa Agroni e kish afruar dhe e kish futur në këshillin teknik të firmës, vend ky që shumë të tjere e lakmonin. Nuk i vinte keq, Borisi i pëlqente, i pëlqente dhe ajo menyrë të foluri me theksin e rusishtes, i kujtonte Ninën, gjyshen e shoqes së saj të fëmijërisë. Veç kësaj, ishte ndër të paktët që tregonte respekt e dashamirësi kundrejt saj, hera herës i bënte ndonjë kompliment, e ajo e lodhur nga shpërfillja e

shumicës së personelit, i ishte mirënjohëse. Ja ktheu përshëndetjen me buzëqeshje. Përshëndeti dhe burrin tjetër, ngjyra çelur e flokëve dhe e syve të tij tradhëtonin origjinën sllave. U ktheu krahët duke pritur që ashensori të mbërrinte në katin e saj. Të dy filluan të flisnin me njëri tjetrin në gjuhën e tyre. Dukej më shumë një pëshpërimë. Mprehu veshët, jo aq për ti përgjuar se sa për të parë se sa do të ishte në gjendje të kuptonte.

Dreqin, kisha harruar se është edhe kjo këtu, - dëgjoi Borisin dhe për pak e tradhëtoi veten.

Përse? - pyeti tjetri – paraqet rrezik? Nga ç'kam dëgjuar, e ka trurin pupël.

Ka gjithnjë pas vetes dy zagarë që ja ka vënë plaku për ta ruajtur. Zbrit një kat më poshtë. Shihemi në pesë e gjysëm. Bëj...

Dy zagarë!? Babai i saj, nuk i besonte ende dhe i kish vënë roje pas... E humbi fillin e bisedës së tyre, kapi vetëm copëza të një dialogu të shkurtër... diçka se plaku me dhëndrrin nuk ktheheshin... se duhej... se...

- Je i sigurtë për sot?

- Nuk do të kem rast më të mirë.

Ashensori ndaloi dhe dera u hap, burri i kaloi pranë e doli pa e përshëndetur.

- Je veshur shumë bukur sot, - dëgjoi Borisin t'i fliste. Ktheu kokën nga ai dhe u mundua të sajonte një buzëqeshje.

Faleminderit,- arriti të mos e japë veten ndërsa ziente nga inati që e kish kapur me veten që ish mashtruar nga sinqeriteti i atyre syve të kaltër. Se mos vetëm ajo...

- o -

Ecte poshtë e përpjetë nëpër zyrë, e nuk dinte se për ç'farë të mendonte më parë. Babai i saj paguante dy vetë për ta ruajtur? Sa për të qeshur, punë e bukur dhe kjo. Ajo që bënte ajo aty nuk vlente as dy grosh, ndërsa ai paguante tri rroga. E kushedi se sa i zhvatnin. Po kush ishin? Duhej të ishin shumë të zot që ajo nuk i kish pikasur. Solli në mendje fytyrat e personave që e rrethonin në punë e nga të padysuar u kthyen të gjithë në të dyshuar. Jo, kështu nuk mund të nxirrte gjë në dritë. Ju afrua telefonit. Miri duhej t'i jepte shpjegim. Formoi numrin e priti të dëgjonte zërin e tij.

- Alo, Miri, a mund të vish këtu? Kam diçka për të të thënë, - u mundua të tregohej e qetë.

- Nuk pret deri në darkë?

- Në darkë?! Nuk do të kthehesh në zyrë sot?- diçka tjetër u ndez në trurin e saj.

- Jo.

- Po babai?

- Jo, është me mua. Shihemi e flasim në shtëpi se nuk kam kohë. Mirupafshim.- ai mbylli telefonin.Pra ata të dy ishin të mirëiformuar. Përse u interesonte atyre? Projekti! As vetë nuk e kuptoi se si i erdhi kjo ide, por erdhi e zuri vend nëtrurin e saj dhe e bëri të rrënqethej. Nuk kish se ç'të kërkonin tjetër veç atë projekt që ajo e kish mallëkuar sa e sa herë me mendje. Fabrikë armësh të sofistikuara, aq kish marrë vesh ajo, po ata si e kishin marrë vesh? Boris, Boris, mëmëriti, e kujt ja mirrte mendja? Rojet ishin dyfishuar që kur kish nisur projekti, por sa para bënte? Borisi kish mundur t'i prishte mendjen të gjithëve dhe ishte afruar mjaft. Luftë dhe armë... si atje... Jo tamam, atje kish terrorizëm i cili kish sjellë luftën kundër Irakut, këtu ishte Irani që kërcënohej. Nuk e kishin thënë ende troç, por ajo e kish nuhatur në propagandën që bëhej, në testimin e publikut, në ndërgjegjësimin e tij që lufta mund të ishte e pashmangëshme. Botë e shpifur. Njerëzimi kish kurrar më shumë sëmundje se në botën e saj imagjinare, sida si tuberkulozi nuk përbënte më rrezik, nuk vdisnin më miliona prej saj, edhe alzheimeri ishte i shërueshëm. Kanceri, kush thotë se nuk shërohet, kish mjaftuar vetëm një vaksinë për ta bërë të padëmshëm. Por interesat e superfuqive gjeneronin luftë, si një gangrenë që hidhte rrënjë e gërryente shpirtin e popujve. Amerika e kish dashur atë fabrikë armësh aty. Dhe asnjëri nuk bënte pyetjen se përse. Të gjithë i frikësoheshin pyetjes po aq sa edhe përgjigjes. Se pikërisht aty i duhej për më vonë, pasi të mbaronte me lindjen e mesme... Po Borisi në ç'anë ish? Kujt i shërbente? Sigurisht vendit të tij. Apo... për t'ja shitur ofertat më të mirë? C'vras mendjen dhe unë me këto, ora po i afrohet treshit. Do ta besonte vallë babai po t'i telefononte e t'ja thonte? Zemërimi ngriti krye përsëri. Pale, po edhe më ruan, bën mirë të ruajë veten. Hyri në zyrën e Agronit nëpërmjet derës komunikuese. Tryeza e punes ishte e pastër, asnjë shkresë mbi të. Kontrollloi sirtaret, asgjë me rëndësi. Në sirtarin e fundit, një kornizë e kthyer përmbys. E mori dhe e vështroi. Ishte Agroni me të në krahë, kur ishte jo më shumë se pesë vjeç. Mendimi se i ati e mbante aty atë fotografi, e zbuti disi inatin e saj dhe e vendosi përsëri me kujdes në sirtar. Sytë i shkuan tek korniza mbi tryezë. Babai me nënën. Grua e bukur nëna ime, mendoi, dhe dashuri e madhe ajo e babait për të. Era vuri buzën në gaz. Nëna e saj e mirë e kish dashur gjithnjë e kurrë nuk ishte bërë xhelozë se në zemrën e së bijës kish patur gjithnjë më pak vend se i shoqi. C'mund t'i ndodhë babait po t'i vidhnin atë projekt? Sigurisht asgjë e mirë, veç turp e telashe do t'i sillte, mund ta akuzonin se ai vetë e kishte shitur. Përse nuk i vë ata zagarë të ruajnë zyrën tënde? Ju afrua telefonit. Nisi të formonte numrin e Mirit, atij mund t'ja thoshte por u kujtua se këto lloj bisedash nuk mund të bëheshin në telefon ndaj uli receptorin. Më mirë të mendohej e të sajonte diçka që ti bënte të ktheheshin aty. Ndenji një çast në mëdyshje, e mori zyrën e Borisit. U përgjigj sekretarja e cila i tha se kish dalë dhe kthehej pas një ore. Pra kthehej para orës pesë. Po pastaj, në ora pesë duhej të dilnin të gjithë, përveç atyre që kishin autorizim special. Kujtoi raportin e mirë që

kishte me Agronin dhe u bind se një autorizim i tillë, ishte gjëja më e lehtë për tu siguruar nga Borisi. Po tjetri? Ishte hera e parë që e shihte, si do të hynte në pesë e gjysëm? Kishin korrumpuar rojet? Sa vetë ishin? Ndjeu zemrën ti ngushtohej në krahëror. Përfundoi mendimin që ti thërriste Agronin dhe Mirin aty, mund të ishte me rrezik për ta. Po ku i ka dokumentat xhanëm? Idiote, i tha vetes, në kasafortë, ku tjetër? Kasaforta ishte e vendosur në mur, ta hiqte prej andej as që bëhej fjalë. Kombinacioni... E njihete vërtet mirë babanë e saj sa të gjente kombinacionin? Atë imagjinarin, po këtë që i vinte roje prapa? Mori telefonin e i kërkoi centralinistes ta lidhte me repartin e marangozëve.

- Dua Sherifin,- i tha me ton të prerë,- brenda dhjetë minutash në zyrën time.

Sherifi ishte i shoqi i Verës e nuk mund të dyshonte në besnikërinë e tij, ishte djalë punëtor dhe inteligjent. Hodhi sytë edhe një herë rrotull. Në mur, në një kornizë të thjeshtë ishte varur diploma e Agronit. Ishte një datë në të. Mund të... ishte shumë e ekspozuar. Atëhere, datëlindje... martesë...jo, data që po të kërkohen gjehen. Sytë i shkuan mbi fotografinë mbi tryezë. Nëna... dashuri e madhe ajo e babait për të, nuk ja kish hedhur sytë asnjë gruajë tjetër që kur kish njohur atë... Fejesa... ç'koinçdencë, para pak ditësh Teuta e kish në gojë... ditën, datën, ç'kish veshur nusja e ardhëshme e djalit... Shkoi drejt kasafortës dhe kombinoi numrin. Nuk u çudit kur dëgjoi kërcitjen a bravës që hapej. Ishin një tufë dosjesh aty, por nuk gjeti atë që kërkonte, ajo në ngjyrë të blertë ushtarake, ja kish parë shpesh Agronit në duar. Kohë e humbur, turfulloi nga inati tek dëgjoi të trokisnin në derë e shpejtoi të mbyllte kasafortën. Ishte Sherifi me çantën e veglave ndër duar.

- Sa kohë të duhet për të ndërruar bravat e këtyre dy zyrave ?

- Zyrës së shefit?- Sherifi e pa me habi.

- Zyrës së babait dhe burrit tim!- i tha prerë.

- Më pak se njëzet minuta.

- Shpejto atëhere. Përveç shefit dhe burrit tim nuk duhet ta marrë vesh njeri. Fillo me zyrën e Mirit.

Sherifi hapi kutinë e veglave. Era kaloi në zyrën e Agronit. Diçka i rrëshqiste, babai nuk e kish zakon të merrte punë në shtëpi, as Miri. Filloi të ecte ngadalë duke shikuar me kujdes pllakat e dyshemesë. Asgjë e veçantë, as edhe një e çarë e vogël. Ju kthye mureve. Pranë diplomës së babait, disa fotografi kantjeresh. Në faqen tjetër të murit, përballë dritares, Vangog. Lulet e diellit. I pëlqenin edhe asaj. U afrua dhe e kundroi tabllonë nga afër. Nuk ishte originale por ishte kopje e mirë. Dëgjoi hapa në korridor e padashur u ngjesh me shpatulla pas murit me zemrën që i rrihte shpejt. Po sikur... Hapat u larguan.

- Zonjë, këtu mbarova,- zëri i Sherifit e bëri të brofte përsëri dhe ajo ndjeu mbi supe peshën e tabllës që ishte shkëputur nga muri.

- Erdha, një sekondë,- u përgjigj ajo duke u munduar të lëvizte me kujdes që të mos binte tabloja e ti dëmtohej korniza. Eureka, sa nuk briti. Nga muri e kish fiksuar syri i një brave tjetër. Eureka një mut, shau me vete.

- o -

I futi një shuk kartëmonedhash në dorë Sherifit dhe pasi e përcolli, ju kthye kasafortës. Cili ishte kombinacioni? Datëlindje, datëmartese, ditëvdekje... jo ditëvdekje nuk mund të ish. Një numër çfarëdo? Ora ishte katër e gjysëm. Kam vetëm gjysëm ore kohë, si t'ja bëj, mendoi ajo e alarmuar? Shikoi tabllonë që e kishte vendosur në dysheme. Atë ditë që kish ardhur për të parë babanë e...vdekur... nuk kish qenë aty. Nuk kish qenë aty!? A ishte e sigurtë? Risolli ndërmend atë takim që kishte lënduar aq shumë... Nëse nuk kish qenë aty, përse kish zgjedhur pikërisht atë vepër që ishte e bukur dhe e admirueshme edhe në botën e saj imagjinare. Kontrollloi tabllonë nga të gjitha anët me shpresë se mos gjente ndonjë shënim, një datë, një përkushtim por asgjë. Ku janë tani ata zagarë që më ka vënë pas? Me siguri në kafenenë përballë e prisnin që ajo të dilte. Pa orën e murit. Dhe njëzet minuta dhe ajo nuk kishte shpresë. Shpresë. Shpresë?! “ Të shpresoj!? Se e çmendura vjen në vehte një ditë dhe të thotë ja ku jam... Kështu më thua?” - i kish bërtitur ai Teutës tek ziheshin për shkak të saj. E çmendur, si piktori. Por talenti kish triumfuar mbi çmendurinë. Kish bërë një vdekje të shëmtuar, Erës i kaluan mornica nëpër trup. Po ajo ç'fund do të bënte? Do të priste edhe ajo ndonjë vesh? A kish qenë vallë e çmendur... deri ditën që ish kthyer... Data tridhjetë maj viti... Kasaforta u hap e dosja në jeshilen ushtarake ju duk kërcënuese. E mori, mbylli me kujdes kasafortën e vendosi tabllonë në vend. Tani gjërat i vinin më lehtë. Mori një tabak letër dhe e paketoi, i lidhi një shirit të kuq me të cilin formoi një fjongo të bukur. Dukej si një pako dhurate. Dhuratë për krishtlindje... Sa larg krahasimit që ishte. Praktikisht po vidhte babanë e saj, e nëse e kapnin me atë pako në dorë, disa vite burg i kishte me hak. Hodhi pallton kraheve e mori çantën. Shtatë minuta. Duhej të dilte në kohë për të mos ngjallur dyshime. Tashmë nuk kish vetëm një palë zagarë, kushedi se sa do t'i viheshin pas... Ju afruapasqyrës për të kontrolluar trukun, pak të kuq buzësh si gjithnjë... Kompjuteri reflektoi në pasqyrë prapa kraheve të saj. Si nuk e kish menduar më parë, mund të kishte të dhëna... Mori një disk dhe e futi në kompjuter për të kaluar të dhënat në të. Nuk imerrte vetëm një, vendosi një tjetër duke mos ja ndarë sytë orës së murit. U sigurua që kish marrë gjithë sa ishte aty pastaj dha urdhërin të fshiheshin të gjitha. Kushedi sa do të

zemërohej i ati, duhej të spjegohej për këtë. Ora kish kaluar një minut nga pesa. Futi disqet në çantë, mori pakon e doli duke mbyllur me kujdes derën. Korridori ishte i shkretë. Filloi të numëronte me ankth hapat drejt ashensorit. Me bisht të syrit vuri re se dera e zyrës së Borisit ishte fare pak e hapur. Dësh të shpejtonte hapin por ndërroi mendje. Andrenalina i shkumbëzonte në gjak, trokiti dhe shtyu derën duke e kapur Borisin në befasi pas saj. I buzëqeshi më ëmbël se zakonisht.

- Më fal, pashë derën hapur e mendova se do të zbrisni edhe ju. Rast i mirë për të këmbyer dy fjalë, si thua?

- Kam edhe pak punë,- ja ktheu ai duke u munduar të sajonte një buzëqeshje, - nëse më prisni dhjetë minuta... njëzet të jemi brenda, - ai vështroi orën e dorës,- mund ta pimë një kafe bashkë.

Ngurroi një çast me pakon që i digjte duart, ç'e kish zënë që donte të luante kështu? E çmendur, i tha vetes, ndërsa atij:

- Përse jo?- rëndoi peshën e trupit mbi një këmbë, - C'janë njëzet minuta? Buzëqeshja u zhduk nga fytyra e tij, kështu ishte i shëmtuar.

- Mos keni për të shkuar në ndonjë festë?- i tregoi ai me gisht pakon.

- Oh, gati harrova. Në pesë e gjysëm duhet të jem në një festë ditelindjeje. Më falni, e lëmë kafënë për një ditë tjetër. Mos harroni, ma keni premtuar.- ajo shpejtoi hapin drejt ashensorit. Shtypi butonin për ta thirrur e ktheu edhe një herë kokën drejt tij. Kish dalë në korridor dhe e ndiqte me sy për tu siguruar që po ikte. Brrr sa shikim i ftohtë, mendoi ajo dhe e përshëndeti për herë të fundit me dorë ndërsa dera e ashensorit u hap.

Më pesë e njëzetepesë parkoi makinën pranë kantjerit ku ishte Miri me babanë e saj. Kish ngarë si e çmendur, kish qenë me fat që nuk e kish ndaluar policia rrugore. Futi pakon poshtë sediljes në krahë të djathtë të saj e hodhi palltonmbi sedilje. U sigurua që makina ishte mbyllur e u drejtua nga kantjeri. Në atë orë punëtorët fillonin e linin punën kështu që sheshi i kantierit ziente. Shfaqja e saj në hyrje, tërhoqi vëmëndjen, por nuk i bëhej vonë për këtë. Pa përsëri orën, gati pesë e gjysëm. Ndaloi duke përplasur lehtë këmbët që të ngrohej. Fërkoj duart e u fryu t'i ngrohte me frymë. Pranvera po vonohej këtë vit. Shikonte sa nga ana e makinës dhe nga kantjeri. Një makinë u afrua dhe parkoi jo larg të sajës. Ishin dy vetë brenda. U alarmua, po sikur ta kishin ndjekur për shkak të... ? Burrat nuk zbritën nga makina. që ju duk e njohur. Duhet të jenë ata që më ka vënë pas Agroni, mendoi dhe ky mendim e bëri ti hipte inati e nuk ndjeu më ftohtë. Të

shkonte e t'u prezantohej, t'u shihte surratin... Pesë e tridhjetedy, koha që Borisi dhe ai tjetri do t'i bënin vizitë zyrës së Agronit. Llogariti sa minuta do t'u duhej të hapnin derën. Ishte penduar që kish ndërruar bravat, për ta do të ish lojë fëmijësh. Nxorri celularin dhe formoi numrin e policisë. Si dreqin, mallëkoi me vete kur njohu zërin, sa herë kam punë me ta po ky qëllon në shërbim.

- *Po lajmëroj për një dhunim zyre dhe vjedhje të dokumentave të rëndësishme. Bulevardi kryesor, nr 7 zyra e zotit Agron Kruja.*

- *C'lloj shakaje është kjo? –pyeti polici që siç duket i njohu zërin, -Zonjë ju betohem se ...*

- *Provo e mos kontrollo, të betohem se do të mallëkosh ditën që ke lerë!- briti e nxehur Era e mbylli telefonin. Hyri në kantjer. Po tani si do t'ja bënte, si do tu thosh atyre. Diku lart në një skelë shqoi Mirin. E thirri dhe ja bëri medorë, e ndau mendjen ta priste aty. Do Zoti vjen vetëm pa babanë! Me të e kam më të lehtë... U përpoq të rendiste mendimet e të zgjidhte fjalët. Ndjeu sërish ftohtë.*

- & -

Përplaste këmbët me takat që zhyteshin në dheun e butë e u frynte duarve. Punëtorët linin punën e bëheshin gati të dilnin duke i thirrur njëri tjetrit. Herë pas here hidhte sytë në drejtim të makinës me frikën se i afrohej dikush e ja hapte. Një britmë e shkurtër therrëse e pasuar nga një zhurmë e shurdhër e britma të tjera e bënë të kthente kokën në atë drejtim. Në pak sekonda u ndërgjegjësua se dikush kish rënë nga skela. Punëtorët vrapuan drejt tij nga të gjitha anët. Vrapoi e në vrap e sipër një këpucë i doli nga këmba. Hoqi dhe tjetrën e shpejtoi me zemrën që po i shpërthente në krahëror... babai... Miri... Kur u ndodh aq pranë sa dalloi se fatkeqi nuk ishte as babai dhe as shoqi por një punëtor, mbajti këmbët e u mbush me frymë. Shpejtoi sërish hapin se u alarmua kur pa se dikush ishte përkulur mbi të dhe donte ta ngrinte.

- *Jo! Mos!- briti me sa zë kish në kokë,- Mos e prek!*

Punëtori e lëshoi e drejtoi trupin duke e parë i habitur.

- *Thirr ambulancën! Shpejt!- I bërtiti ajo të parit që i ra në sy.- Hapuni!*
- *ajo hapi krahët duke i bërë rrugë vetes mes turmës së punëtorëve e u përkul mbi fatkeqin i cili i kish sytë e mbyllur e nuk merrte frymë. Ka vdekur, dëgjoi dikë pas krahëve. Zbathur, u gjunjësua e me gishta kërkoi damarin në qafën e tij. Ishte ende gjallë, pulsi i dobët vërtet, por rrihte. Desh t'i hiqte kaskën por mendoi se po të kish frakturë ne qafë do ta keqësonte. I vuri një dorë ndën zverk duke ja kthyer pak*

kokën prapa, me dorën tjetër i zuri hundën dhe u mbush me frymë, pështeti buzët e saja mbi gojën e tij duke i fryrë të gjithë ajrin që kish në mushkëri. Por krahërori i fatkeqit nuk lëvizi. Drejtoi trupin e dëshpëruar, punëtorët kishin ngushtuar rrethin përsëri.

- Hapuni! - u briti ajo dhe ata si me komandë lëvizën.

U përkul mbi trupin e palëvizur duke kryqëzuar pëllëmbët njëra mbi tjetrën atje ku duhej të ishte zemra dhe e shtypi fort. Një, dy, tre, katër, pesë... jepi vëlla lutej në zemrën e saj teksa sytë ju mbushën me lotë. U mbush sërish me frymë e ju kthye gojës së tij e duke i zënë hundën duke ja shfryu brenda. Krahërori nuk lëvizi. Mblodhi dorën grusht dhe goditi me aq forcë krahërorin e tij sa ju desh të mbyste rënkimin që i shkaktoi dhimbja e kqçit. Kryqëzoi duart mbi krahërorin e tij e duke u ngritur mbi gjunjë i mëshoi me gjithë forcën e trupit duke numëruar me zë të lartë e dëshpërim. Një... dy... tre... katër... pesë... Mbushi mushkëritë me ajër sa ju duk se po i pëlcisnin, i vuri një dorë ndën zverk e me tjetrën i zuri hundën, ja shfryu në gojë duke puthitur mirë buzët pas të tijave. Kafazi i krahërorit lëvizi pak, fare pak. I kërkoi pulsën. I dobët. Përsëriti me ankth veprimet derisa fryma po i mungonte edhe asaj.

- Cazzo! - thërriti, - non mollare! - duke rënduar peshën e saj mbi duart e vendosura mbi krahërorin e tij. Papritmas një si kollë e dobët u ngrit nga gryka e fatkeqit nga ku doli shkumë e bardhë. I ktheu kokën pak anash, mund të vllte e të mbytej në të vjellat e tij. Puls i po forcohej nga pak e ai merrte frymë. U dëgjua sirena e autoambulancës e pas pak çasteve një mjek dhe dy infermierë ishin aty. E lodhur më shumë nga ankthi dhe emocioni u ul përdhe. Hasi shikimin e syve të fatkeqit dhe i buzëqeshi për t'i dhënë zemër. Mjeku e kontrolloi se mos kishte frakturë të gjymtyrëve dhe me ndihmën e infermierëve e vendosi me kujdes mbi barelë e lëvizën drejt autoambulancës. Pas tyre u vu grupi i punëtorëve. Nuk u ngrit, pështeti kokën pas gjunjëve e ndenji një moment ashtu. Një dorë ju pështet mbi sup. Ishte mjeku e pas tij qëndronin Miri me Agronin .

- Ndjehesh mirë zonjë?- zëri ishte i butë e qetësues. Mira pohoi me kokë.

- Po ai? - ajo tregoi me gisht barrelën që po e vinin mbi autoambulancë.

- Do të bëhet mirë. I keni shpëtuar jetën.

Mjeku u largua me të shpejtë. Ngriti sytë me frikë në drejtim të Mirit dhe babait. Ai nuk duhet të ishte aty, duhej ta kishin thirrur, veçse... O Zot... prapë kam kombinuar një...

- Pash zotin Mira, ku e ke mësuar këtë?- e pyeti Miri teksa i zgjati dorën për ta ndihmuar të ngrihej.

- Më duket se kam kombinuar një profkë tjetër.- tha ajo me gjysmë zëri.

- Shkojmë në shtëpi, pastaj flasim.- Miri e tërhoqi lehtë drejt vetes.

- & -

Agroni lëvizi i pari drejt makinës së tij ku shoferi po i priste më këmbë e i mbante derën hapur.

- Do të vij me timen. Nuk mund ta lë këtu,- ajo bëri drejt makinës së saj.

- Do vij dhe unë me ty, - tha i vendosur Miri. Papritur u dëgjua zilja e celularit të Agronit, i cili e nxorri nga xhepi pa e fshehur bezdinë. U zbeh menjëherë në fytyrë. Atëhere... kish patur të drejtë ajo.

- Do të vij në çast! - foli ai dhe mbylli celularin. Pastaj ju kthye Mirit.

- Coje Erën në shtëpi, pastaj eja në zyrë. Kemi një problem.

- Do të vij me ty! - ngulmoi Mira.

- Jo!- zëri i tij ishte i prerë.

- Një minutë!- nxorri pakon nga poshtë sediles. Sa do të donte ta digjte, ta shkatërronte, ta mallëkonte atë që kish brenda. Fabrikë armësh! Armë, kjo fjalë i ndillte tmerr e neveri, po nuk kish ç'të bënte, babai i saj ishte në telash të madh. Ai e shikoi i habitur.

- Nuk kam ditëlindjen sot .

- E di,- Mira ju afrua shoferit dhe i bëri shenjë të zbriste.- E ngas unë. Ti merr timen.

Ata u panë një hop të habitur e hipën në makinë. I zgjati pakon Mirit.

- Hape, dhe më thuaj nëse është ky problemi.

Miri e hapi e Agroni çapëleu sytë.

- Stop!- e urdhëroi ai. Ajo ndaloi. - Si të ka rënë në dorë?

- E mora nga kasaforta para se ta merrnin të tjerët. Ta lija aty?

- Nga e dije se do ta vidhnin? Nga kush? Me çfarë je ngatërruar?

Erës ju përshkënditën sytë nga zemërimi.Me kë ishte ngatërruar!?

- Pagan dy vetë për këtë punë. Të ta thonë ata me kë jam ngatërruar.

Sa u pagan, dyfishin, trefishin apo pesëfishin e rrogës sime?

Agroni heshti ndërsa Miri uli kokën. Mira nisi makinën. Vazhduan rrugën pa folur deri sa arritën poshtë ndërtesës ku ndodhej zyra. Heshtjen e theu ajo.

- Do të doja të vija e ta shihja në sy atë bir bushtre, por do të iki në spital të shoh se si i ka punët ai fatkeqi. Në darkë, kur fëmijët të kenë fjetur do t'ju them gjithë sa di. Ah, se harrova, - nxorri dy palë çelësa nga çanta e dorës ejua zgjati,- Ju kam ndërruar bravat sot pasdite. Ah, edhe një gjë, kompjuterin baba, e ke tabularasa, i kam fshirë të gjitha, gjithë ç'kish brenda i ke në këto disqe. Nuk kam gjëra të tjera.

- o -

Kish kaluar me kohë mesnata, por ata rrinin aty e dëgjonin. Diku ju tha pështyma, ndaloi së foluri dhe i pa në sy me rradhë. Babai ulur në divanin përballë kapur për dore me të ëmën, Teuta mbi karrocë pranë saj, ndërsa Miri në kolltukun tjetër. E shikonin dhe nuk flisnin. Befas i erdhi për të qeshur, por nuk pati guximin ta bënte.

- Pra tri gjuhë të huaja!?- e theu heshtjen Miri. Ajo mblodhi supet.

- Di t'i flasësh?- pasoi zëri i ëmbël i nënës.

Agroni nuk foli por nuk ja ndante sytë. Kushedi se ç'bluan në mendje, tha me vete Era.

- Shkoni e flini tani se është vonë. Nesër ditë e re, nafakë e re, thoshte gjyshja ime. - e mbylli Teuta.

U ngritën të gjithë më këmbë. Era shoqëroi nënën e babanë e i ndihmoi të vishnin palltot. Jashtë bënte ftohtë.

- Të falemnderit për ç'ka bërë sot,- zëri i Agronit ishte i ngjirur.

- Ishte nder për mua baba!

Ai ktheu krahët e doli i pasuar nga nëna. Ajo qëndroi tek dera e i shikoi tek largoheshin. Diçka brenda saj i thosh t'i thërriste e t'u hidhej në krahë, ti përqafohte, t'u thosh se sa shumë i donte, por nuk e bëri. Një herë tjetër, një ditë tjetër. Ndjeu krahët e Mirit ta përqafonin dhe frymën e ngrohtë në qafë, gudulisjen e buzëve pas veshit dhe trupi ju rrënqeth. Kish ardhur koha të kthehej në shtratin e saj bashkëshortor, e ndjente. U pështet pas tij dhe ju nënshtrua ndjesisë së këndëshme që i shkaktonin duart e tij që e preknin. Kishte ardhur koha. Dëshira që të shkonte e të flinte me të ju rrit deri në dhëmbje. E përse jo, ishte burri i saj. U kthye dhe e përqafoi duke u ngjeshur pas tij. “Eja, i pëshpëriti në vesh ai, më ke munguar”. E tërhoqi ngadalë drejt shkallëve. Por këmbët nuk ju bindën, nuk mund t'i ngjiste ato shkallë, shumë emocione në një ditë të vetme. Ishte e lodhur dhe e ngarkuar me mbresa. Jo sot, edhe se dëshira ishte bërë e padurueshme. C'do të ndodhte kur të çoheshin në mëngjes e të gjenin njëri tjetrin në krah? Kush do të pendohej i pari ai, apo ajo? Tani ai ishte i lodhur e mbushur me dhëmbisuri, nuk gjykonte. Po nesër..?

- Miri, jo! - u shkëput nga krahët e tij tek fryma i merrej nga dëshira, ndërsa një pjesë e saj uronte që ai ta merrte në krahë, ta ngrinte peshë e ta fuste në shtratin e tij.

- Më fal ! - ai tërhoqi duart e shtërngoi fort parmakun e shkallëve.

- Natën e mirë! - ajo i ktheu krahët kapërthyer në ndjesi lehtësimi e zhgënjimi bashkë.

- Prit!- ai ju afrua dhe i ndenji përballë. - Unë jam këtu... nuk e di se kur do të jesh gati, por dije se të pres.

- Natën e mirë Miri. - u drejtua në dhomën e saj. Dera e dhomës së Teutës ishte hapur e shkoi ta mbyllte.

- Natën e mirë Teuta!

Teuta ishte shtrirë në shtrat. Nxorri dorën nga poshtë mbulesës dhe e kërcënoi me gisht. Era qeshi lehtë e i tregoi gjuhën. Mbylli derën e shkoi në dhomën e saj.

Natën e mirë, i tha vetes, je me të vërtet budallaqe. Budalla edhe yt shoq që të lut kaq shumë kur ka gra që janë gati të futen në shtratin e tij mjaft që tu bëjë një shenjë. Para syve i doli imazhi i stazhieres së re, së cilës dukej qartë se i pëlqente Miri, e turbullohej aq shumë, sa i merrej dhe goja kur ndodhej në prani të tij. U mundua të flinte por gjumi vonoi ende shumë. Nxorri bllokun e shkroi mbresat e ditës. Kasafortat, bravat, aksidentin... punëtorin e shkretë që nuk kish dalë ende nga rreziku egjendej në reanimacion. Sa e padrejtë është kjo botë, edhe ajo tjetra që kam në tru. Ka njerëz që i kanë të gjitha, e njerëz që rrezikojnë jetën për të siguruar bukën e gojës...

- & -

Nata kish rënë mbi qytet dhe në godinë lëviznin veç rojet e turnit që bënin xhiron e kontrollit. Agroni rrinte pa lëvizur mbi kolltukun e tij para tryezës së punës, mbi të cilën ishin fotokopjet e ditarit të së bijës. I kish lexuar me një fymë, e po mendonte t'u kthehej nga fillimi. Pa orën, ishte dhjetë pa dhjetë minuta. Duhej të lajmëronte të shoqen se do të kthehej vonë atë natë e të mos e priste zgjuar por të binte e të flinte. Interesant ky ditar, kish pritur të gjente të tjera gjëra, ndoshta kujtime të aventurave të saja, por ishte krejt tjetër. Mendja e sëmurë e së bijës kish krijuar një botë më vete. Kish të drejtë psikanalisti për personalitetin e saj, por gabohej kur thonte i dyfishtë, ishte më shumë. Të pakten ai njihetretë, një ajo që paraqitej çdo ditë tani, një kjo në ditar dhe e treta ajo që tani për tani rrinte fshehur, ajo që e kish turpëruar e torturuar vite me rradhë. A do të dilte përsëri kjo e fundit, apo ishte zhdukur një herë e përgjithmonë? Mori në dorë celularin e kërkoi numrin e psikanalistit. Ndenji një çast në mëdyshje e pastaj e la mbi tryezë. Po sikur... jo, më parë duhej të vërtetonte disa gjëra. Mori përsëri celularin, nxorri një bllok të vogël nga xhepi dhe e shfletoi. Një mik i tij, funksionar në Ministrinë e punëve të brëndëshme i detyrohej një favor. Formoi numrin e priti. Duhej ta bënte, ndryshe nuk mund të flinte atë natë. Dëgoi zërin e mikut. I tha ç'kërkonte dhe kur mund të merrte një përgjigje. Dy ditë, dëgjoi pas disa sekondash heshtje që ju dukën të gjata pambarim. Dy ditë!? Nuk mund ta bënte më shpejt? Jo, nevojiteshin të paktën dy ditë, ai do të merrej personalisht me këtë punë. Agroni u nënshtrua,

duhej të priste. Mbylli të gjitha e zbriti poshtë. Shoferi e priste por ai i bëri shenjë me dorë që të ikte. Do ta bënte më këmbë rrugën për në shtëpi. edhe se ndodhej larg. Priti sa shoferi me makinën u largua, pastaj rراسi duart thellë ne xhepat e palltos e u nis me hap të ngadaltë. C'do të thoshte e bija po ta dinte se..?

- & -

Kishin qenë dy ditë të gjata e të mundimshme. Nuk kish guxim ta shihje në sy të bijën, e cila për fat u duk shumë pak në zyrë, pjesën më të madhe të kohës e kaloi në spital. Punëtori fatkeq ishte operuar, kish patur frakturë të dy vertebrave. Kujtoi skenën kur ajo i kish dhënë ndihmën e parë dhe zemra ju përpëliti. Ku e kish mësuar? Nga filmat kish thënë ajo, por në ditat shkruante se kish bërë një kurs në Itali. Duke njohur jetën që kish bërë e bija, qëndronte e para, por efikasiteti që kish patur ndihma e saj, bënte të besueshme të dytën. Agroni kish filluar të dyshonte. Nëse i besonte ditat dhe ndryshimit të saj... sa i madh ishte ky ndryshim... ajo nuk ishte bija e tij, ishte një person krejt tjetër, pamvarësisht se fizikisht ishte e njëjta. Mallëkoi veten që kish kërkuar t'i fotokopjonin atë ditat. Le pastaj po ta merrte vesh ajo... Ajo ishte nxehur se i kishte vënë “dy zagarë” pas, se përse punëtorët e tij nuk ishin informuar me rregullat e sigurimit teknik e nuk ishin të aftë të jepnin ndihmën e parë... Kish kërkuar që operacionin ta bënte kirurgu më i mirë i qytetit dhe e kish detyruar ta paguante. Agroni nuk kishte kundërshtuar, edhe atij i dhimbsej punëtori i shkretë. Nuk kish qenë kështu bija e tij, kish qenë... Tani ishte tjetër, shihje në të veten e tij kur ishte i mbushur me ideale dhe ishte i gatshëm të ndihmonte të gjithë për gjithshka. Si ka mundësi që me kohë kam ndryshuar, pyeti papritmas veten. Nuk mund të pranonte se ishte bërë i pandjeshëm, por ishte dhënë gjithnjë e më shumë pas punës e fitimit e nuk i kishte mbetur kohë për... Nuk kishte patur kohë të merrej as me të bijën kur kish shfaqur shenjat e para të lajthitjeve. Nuk e kish kuptuar, në vend që të ulej e të bisedonte me të për të kuptuar problemet e saj, e kish gjykuar. E kish gjykuar keq dhe ashpër duke hapur një hendek midis tyre që kish ardhur duke u thelluar, e ai nuk kish lëvizur nga pozicioni i tij prej gjyqtari. Ndryshimi i saj ishte një shuplakë për ndërgjegjen e tij. Zilja e celularit e shkëputi ngamendimet. Miku i tij po vinte vetë personalisht. Zemra filloi t'i rrihte me rrëmbim. C'lajme i sillte? U sul drejt derës dhe e hapi. Pa mikun e tij tek doli nga ashensori me hap të panxituar. Jepi, tha me vete, ç'janë ato hapa prej kërmilli. E futi brenda dhe e ftoi të ulej. Tjetri ndjeu tensionin e tij e kapërceu frazat e zakonshme të mirësjelljes e hyri drejt e në temë.

- Shkova personalisht në Itali. Kam verifikuar këtë adresë, kam pyetur në gjendjen civile të këtij qyteti, kam pyetur edhe në kuesturë...

- Dhe...?- ja bëri me padurim Agroni.

- Vajza juaj apo më mirë emri i vajzës suaj nuk figuron gjëkund. Sipas kërkimeve të mia, nuk ka qenë kurrë në Itali, nëse është ky problemi që të intereson. Agroni i ktheu krahët e ju afrua dritares. Pra... Ditari... fantazi e pastër, e bukur madje. Le të fantazonte sa të donte, kjo nuk i prishte punë nëse atë e bënte më të mirë.

- Vemi hamë drekë bashkë si në kohët e vjetra. Qeras unë. - i tha mikut.

- o -

U ngrit ndenjtur mbi shtrat e larë në djersë. Errësira që sundonte ja shtoi më shumë ndjenjën e ankthit. O zot, ç'ëndërr e tmerrshme! Ishin shtrirë të dyja nënë e bijë në dy shtretër spitali e mbaheshin përdore. Fytyra e zbahtë e Elonës, sytë e saj rrethuar me rrathë të zinj, ato lot që nuk pushonin së rrjedhuri, e ajo... që nuk e qetësonte dot sepse ndjehej keq, aq keq sa i dukej sikur do të vdiste. Elona që i jepte zemër përmes lotësh. Elona nuk donte që ajo të vdiste... C'kuptim kish kjo ëndërr? Mos do ti ndodhte gjë së bijës? E shihte aq pak kohët e fundit. U çua e ngadalë e pa bërë zhurmë hyri në dhomën e së bijës. Flinte e qetë e frymëmarrjen e kish të lehtë e ritmike. Ju përmbajt instiktin për tu perkulur e për ta puthur, nuk donteta zgjonte sepse nuk do të dinte ç'ti thoshte. Doli nga dhoma në majë të gishtërinjve, por nuk i shpëtoi Teutës që e thirri kur kaloi para derës së saj. Si dreqin më ka dëgjuar, nuk ka mur që të mos depërtojnë sytë e veshët e saj, mendoj tek hapi derën e hyri në dhomën e gjyshes.

- Ke nevojë për gjë?- e pyeti ajo.

- Prapë ëndërr e keqe? - e pyeti Teuta.

Mira pohoi me kokë.

- Ah dhe ti me këto ëndrra. Duhet tu bëjmë derman.

- Lëre këtë muhabet, mos fillo me doktorët tani. Natën e mirë.

- Nuk e kam fjalën për doktorët. Do të gjej dikë tjetër.

- Natën e mirë! - e uroi Era dhe u largua. Doktorë, dikë tjetër... Teuta ka rrjedhur, tha me vete ajo e u fut në shtrat. Po gjumë nuk kishte.

- o -

Atë të djelë u zgjua herët. Verës dhe Silvës, infermieres së Teutës ua kishte lënë pushim atë ditë. Kishin të drejtë dhe ato të bënin pushim një të djelë në muaj. Filloi me Teutën, i bëri bide në shtrat, e veshi, e vuri mbi karrocë dhe e mori me vete në sallën e ndënjes. Dësh të përgatiste kafënë e mëngjesit por Teuta nuk e la. E pimë më vonë, i tha, pres një shogën time. Përgatiti mëngjesin për fëmijët por nuk i zgjoi. Le të flinin dhe pak, ishte ditë pushimi. Mori një palë gërshërë e doli në oborrin përpara shtëpisë. Kishin çelur trëndafilët e parë dhe ajo bëri një buqetë jo shumë të madhe por të këndëshme. Koha ishte e bukur e aroma e luleve ishte e mrekullueshme. Cudi, e ndjente kaq shumë sot. Ogur i mirë, mendoj ajo e qeshi me vete, sepse... sepse ju kujtua që kish dëgjuar për një shenj, që kur ishte gjallë, kish qenë murg, i ishin shfaqur në duar e në trup shenjat e plagëve të Krishtit e kundërmonte aromë lulësh. Kish bërë disa mrekulli, por kisha e ish luftuar e dënuar, kish vdekur me damkën e dënimit si mashtrues. Pastaj e kishin shpallur shenjt. Thonin se kur i luteshe e të ndihmonte, shfaqej me aroma lulësh... Thonin... ku? Në atë imagjinaren... apo... E zënë me këto mendime, e vuri re plakën e veshur me të zeza vetëm kur ishte pothuaj ngjitur me gardhin. Mbi supe kish hedhur një shall të zi që i mbërrinte deri në fund të kërcijve të hollë të këmbëve.

- Këtu banon Teuta?- pyeti ajo me zë autoritar.

Kjo duhet të jetë shoqja e Teutës, mendoj tek i hapi derën e kopshtit dhe e ndoqi pas duke admiruar hapin e fortë e të sigurtë me takat që kërcitnin mbi pllakat e gurta të rruginës. Hajde të ecur, hajde, qeshi ajo me vete.

- Na bëj nga një kafe turke, bëj edhe për vete, - i tha menjëherë Teuta sapo i pa në derë. Dësh ti thonte se ajo nuk e pinte turke, por papritmas kuptoi se Teuta e kish thirrur plakën për të parë filxhanin e jo vetëm të saj. Nuk kish ku të rrinte ky muhabet.

- Teuta!?- ju kërcënua gjyshes.

- Bëji dhe mos e zgjat!- e urdhëroi ajo.

Nxorri xhezvenë dhe përgatiti kafetë, më pas ja rregullonte qejfin Teutës. Ndau kafënë në filxhana e pasi jua serviri u ul dhe e piu shpejt. Dësh ta zhdukte filxhanin e saj, por plaka ja rrëmbeu nga duart dhe pasi e rotulloi mirë e mirë e përmbysi drejtpërdrejtë mbi mbulesën e tryezës pa çarë kokë se lëngu i kafesë u përhap në të duke krijuar një njollë të shëmtuar.

- Si qoftë halli, daltë falli, - tha ajo dhe vendosi dorën mbi fundin e filxhanit. Ndërkohë vërejti plakën me kujdes, ishte shumë më e vjetër se gjyshja e saj, fytyra i dukej sikur ishte mbuluar me rrjetë që nuk linte ti dalloheshin tiparet, aq të shumta i kishte rrudhat. Ndërsa sytë, në një të kaltër të bukur, ishin aq zhbirues, sa i krijoi ndjesinë e të qenit zhveshur e kjo e bezdisi. Mori të çohet e të merrej me diçka tjetër, por këmbët nuk ju bindën. C'fuqi kishin ata sy, mos vallë e kishin hipnotizuar? Plaka, mori në dorë filxhanin e saj dhe e rrotulloi nga të gjitha anët. Tani tregojë zotësinë tënde, tha me vete Era. Vuri re se rrudhat ju thelluan më

shumë ndërsa sytë, kur i ngriti nga filxhani dhe e fiksuan, i kish aq të errët sa ju dukën të zinj si nata.

-C'ka sheh aty? - theu heshtjen zëri i paduruar i Teutës.

Plaka vendosi filxhanin përmbys mbi tryezë pa folur.

-Sheh ndonjë gjë të keqe? –Teuta ishte e alarmuar.

- Jo, por nuk di ta lexoj këtë filxhan. Njëqint vjet që bëj këtë punë... njëqint vjet dhe...

- Hidhi dhe një sy!- ju lut Teuta.

- E kotë,- plaka tundi kokë pa ja ndarë sytë Erës.

- E kotë?- Era ngriti zërin pa dashur.- Njëqint vjet dhe nuk je e zonja të sajosh dy llafe?Të lutem, përpiqu edhe një herë, bëje për Teutën!

- Nuk mundem. Janë... dy botë aty, e unë mund të lexoj vetë gjërat e kësaj bote... të asaj tjetrës... - plaka bëri kryqin me dorën e fishkur e me gishta të shtrembëruar.

- Eshtë imagjinare, kam personalitet të dyfishtë,- qeshi Era.

- Nuk është problem imagjinate, është problem shpirti.

Era mbeti pa fjalë. Spjegim ishte ky..?

- Mos të dukem gjë gjysëmfantazmë?- e pyeti pa fshehur sarkazmën.

Plaka lëshoi një kartëvizitë mbi tryezë dhe u ngrit.

- Njëqint vjet dhe ja një enigmë, prandaj po ta lë. Nuk premtoj të zgjidh gjë, thjesht kuriozitet. Së shpejti do të të dalë një rrugë, mos e refuzo, kur të kthehesh më gjen këtu,- plaka vuri gishtin e shtrembër mbi kartëvizitën. - Ditën emirë!

Plaka u largua dhe Teuta pa me keqardhje e shqetësim Erën që kish mbetur si e ngrirë.

- Cohu bijë e na bëj një kafe tjetër. Ajo kish rrjedhur fare, dhe unë... - papritmas Teuta ja shkrepiti së qeshurit.

Era qeshi me të. Pas pak fëmijët e shtëpia u zgjua. Harruan filxhanin dhe plakën. Dita kaloi e këndëshme në rrëmujën e harenë e së djelës. Nëna me babanë nuk munguan atë ditë. Para se të iknin, babai i zgjati një zarf.

- Një mënyrë për të të falenderuar. Hape!

Mendimi se mund të ishin para ja cingriti nervat. Me duar që filluan t'i dridheshin nga inati hapi zarfin. Dy bileta avioni për në Itali dhe prenotimet e hoteleve. Romë, Firenze, Pisa ... fytyra ju çel.

- Kur mund të nisemi?

- Që nesër, - ja bëri Miri pas saj.

- Nesër!?- papritmas ju mblodh një lëmsh në grykë. Gëzimi ju përzie me frikë. Përse e tërhiqte Italia, ç'kërkonte atje? C'surprizë i përgatiste fati? Mos refuzo, zëri i plakës i kumboi në veshë dhe padashur ktheu kokën nga Teuta që nuk

pati kohë të fshihte shqetësimin që kish bërë fole në sytë e saj. Kish dalë ajo pjesëz e vogël e fallit...

- o -

Dihaste tek ngjitej. Pamja e atyre shkallëve të pjerrëta e lodhëse që dukeshin sikur nuk kishin asgjë të përbashkët me përshtypjen e mrekullueshme e marramendëse që të linte pamja e kullës nga jashtë, ishte... sikur i hiqte pluhurin një tabloje të fshehur në mendjen e saj. Ndjesia se kish qenë edhe herë tjetër këtu forcohej gjithnjë e më shume dhe në trurin e saj po humbiste betejën mes realitetit e fantazisë. Eshtë vetëm një iluzion, mërmëriste me këmbëngulje. Kur arritën në majë e dolën në ajër të pastër, ju morrën mendtë. Nuk ishte ndjesi, ishte pothuaj bindje. Këmbët filluan t'i dridheshin, efekti i lartësisë, kështu i kish ndodhur dhe herët e tjera. Mbushi mushkëritë me ajër e admiroi pamjen që shtrihej poshtë. Sheshi i mrekullive... e meritonte vërtet këtë emër. E kotë të thuash që e ke parë kullën e Pizës në kartolinë... e kotë të thuash se ke qenë dhe herë tjetër atje... dy herë të tjera, i bënte jehonë një zë i brendshëm..." është hera e parë", desh klithi ajo. Pamja që i ish shfaqur sapo kish hyrë në shesh, e kish lënë pa fjalë. Kam parë çdo gjë me interes, jam mrekulluar... A nuk mbetemi gjithnjë të mrekulluar kur shohim gjëra kaq të bukura, madje edhe kur i rishohim, tallej me të ai zë i brendshëm. Era u pështet pas parmakut duke patur frikë të fiksonte njerëzit që lëviznin poshtë në shesh, dukeshin aq të vegjël. U ndie po aq e vogël edhe vetë përballë dyshimeve që e brenin. Krahu i Mirit e përfshiu nga supet. Eshtë kaq i mirë, mendoi. Befas në mendjen e saj u zgjua një tjetër hije e dyshimtë kujtimi... hera e parë me të këtu në majë të kullës. Sa të dashuruar e të gëzuar që ishin. Hijet morën formë, ngjyrë, tinguj aq realë sa ajo desh ta pyeste në i mbante mend ato fjalë dashurie që kishin pëshpëritur...

-Eshtë kaq bukur Era! Si nuk na ka shkuar ndërmend të vinim më parë?

Zëri i tij shpoi si me thikë zemrën e trurin e saj. Ai nuk mbante mend... ose ajo... po lajthiste përsëri... ajo kish qenë këtu, dhe ai me të... ai ish sërish këtu, kaq pranë, burri që kish dashur, i vetmi në jetën e saj... e kjo kishte rëndësi. Mjaft me dyshime, mjaft... Afroi fytyrën pranë të tijës dhe e puthi në buzë. Ai e përqafoi dhe ajo ndjeu zemrën t'i rrihte me forcë. Zemra nuk e gënjente, nuk kish dikur, kish vetëm të tashme, ajo dhe ai, atje në atë lartësi që e bënte ti merreshin mendtë.

- Miri, - pëshpëriti ajo.

- Të dua! - qe përgjigja e tij dhe e ndjeu veten gruan më të lumtur të botës.

Ktheu kokën dhe i hodhi edhe një shikim të fundit e mirënjohes sheshit kur po largoheshin. Jo kot quhej sheshi i mrekullive, kish ndodhur një mrekulli edhe brenda saj, e kishte shëruar.

- Shkojmë në restorant? – propozoi Miri.

-Kam një ide më të mirë.

- Ta dëgjojmë, - qeshi ai

- Shkojmë në hotel e porosisim të na servirin në dhomë.

- & -

Ishin ditë të lumtura. Endrrat nuk e shqetësuan dhe ajo zgjohej duke ju gëzuar pranisë së Mirit në shtrat. Si dy adoleshentë të dashuruar, shëtisnin të kapur përdore e duke qeshur edhe për gjënë më të vogël. Pushimet po mbaronin dhe po afronte koha për tu kthyer në shtëpi. Numëronin me keqardhje ditët që rrëshqisnin shpejt por nga ana tjetër e kish marrë malli për fëmijët. Ditën e fundit ja përkushtuan blerjes së dhuratave. Ishin në Firenze. Kërkoj të vizitonte edhe një herë muzeune katedrales së zonjës së luleve që i kish pëlqyer shumë. U ngul edhe një herë para veprës së famshme “mëshira” e Mikelanxhelos duke e soditur e admiruar centimeter per centimetër. Pastaj hyri në sallën ku përpara Jezuit të kryqëzuar në mur, qëndronte statuja e Madalenës së Donatelos. Humbi sensin e kohës. Qindra vjet dalë nga duart e mjeshtrit e dukej sikur fliste, çdo pjesë e saj, çdo nuancë ngjyre, çdo tipar e linjë shprehte dashuri, dhëmbje, mall, trishtim... dhe dashuri e dhembje sërish e shumë trishtim... të fiksuara aty e sfidonin kohën, njerëzit, dogmat... ndjenja njerëzore që shtrihen e jetojnë në pafundësi... Njëherë që ke dashur, një herë që ke vuajtur... asgjë nuk humbet... asgjë nuk harrohet... Ndjeu trishtimin ta pushtonte e të nxirrnin kokëmendimet e saj të zymta. Italia. Vendi ku ajo fliste e lëvizte aq lirshëm sa ishte befasuar edhe vetë... sikur të kish kaluar një jetë aty. Kjo statujë... ndjesia se e kish soditur edhe shumë kohë më parë... Në mbrëmje do të niseshin, ishte vërtet e lumtur që kthehej, fëmijët e prisnin me padurim. Po a i kish marrë përgjigjet që donte nga ky udhëtim? Po sikur ëndrrat të fillonin e ta torturonin sërish? Sa do të zgjaste kjo periudhë qetësie? Nuk mund të ikte pa parë edhe një vend të fundit, atë që e kish shmangur, atë që i shfaqej në ëndrrat e saj torturuese.

- Miri, e shtyjmë edhe dy ditë nisjen? Dua të shoh edhe një qytet.

Ai nuk u përgjigj menjëherë. Ka hallin e punës, mendoj ajo, me siguri që nuk mundet...

- E përse jo?- ju përgjigj ai buzagaz.

- & -

Qyteti, edhe se nuk kish ndonjë gjë të rëndësishme për të parë, ishte shumë i këndshëm dhe Mirit i pëlqeu. Të zënë për dore brodhën rrugët e tij dhe ajo vërente me ankth fytyrat e kalimtarëve se mos haste ndonjë fytyrë të njohur. Rrugët i dukeshin të njohura. Edhe ndërtesat e shtëpitë. Padashur këmbët e çuan para një pallati që i ishte shumë familjar. Lëshoi dorën e Mirit dhe me zemrën që gati sa nuk i çante krahërorin, ju afrua tabelës së emrave që ndodhej në portën kryesore. I lexoi të gjithë me rradhë duke i shoqëruar me gisht. Jo, nuk njihnte asnjërin, nuk ishte emri i saj në të. E megjithatë ky ishte pallati... ku kish jetuar dhjetë vjet... që i shfaqej në ëndërr. Kaluan më tej. Në hyrje të pallatit përkarshi ishte vënë një lajmërim ku shkruhej se jepeshin apartamente me qera. Prej këtij shihej hyrja e pallatit që i interesonte, për më tepër kishte dhe pamje nga deti. Tha se do t'i pëlqente t'i kalonte ato dy ditë aty dhe Miri nuk e zgjati. Shtypi butonin e ziles. Pas pak ishin brenda apartamentit e nuk bënë pazar për qeranë. Era mori dy karrike dhe i vendosi në ballkon.

*- Eja Miri, ulu pranë meje. Këtë pasdite do ta kalojmë këtu .
Ai nuk u pergjigj e u ul. Tashmë ajo e dinte se çdo dëshirë e saj, ishte ligj për të.*

- & -

Përgjoi të gjithë personat që hynë e dolën në atë pallat. Megjithëse ndonjë fytyrë i dukej e njohur një moment, momentin tjetër e humbte sigurinë. Derisa e ndau mendjen se nuk njihnte asnjë. Të nesërmen mori rrugën që sipas imagjinatës së saj e çonte në azilin e pleqve ku kishte punuar. Zemra i rrahu përsëri me forcë tek shqoi nga larg murin rrethues dhe pishat fare pranë detit. Shpejtoi hapat dhe u gjend pranë portës. Ishte një manastir murgeshash dhe ajo shqoi disa prej tyre në oborr. Kjo e habiti por edhe e qetësoi. Pra nuk kishte asgjë e vërtetë. Ishte thjesht fantazi, përgjigja që kërkonte. Ndjeu hapin e Mirit që ju afrua.

- Të interesojnë murgeshat? - qeshi ai.

- Jo dhe aq, ikim!- tha ajo

Ato dy ditë kaluan si në ëndërr mes kënaqësisë së shoqërisë së Mirit që ish më i ëmbël e më i dashur se kurrë dhe etheve të kërkimit të ndonjë shenje që të vërtetonte dyshimet e saj. Asgjë. Përfundimisht asgjë që mund t'ja prishte më

qetësinë. Nuk dinte ti spjegonte vetes sepse ky qytet ishte aq familjar për të, sepse ai pallat vinte e i hynte në ëndërr. Nata ishte e ngrohtë, hëna shkëlqente në tërë magjepsjen e saj dhe yjet e përshëndesnin nga lart. Nga larg vinte zhurma e valëve të detit. I hodhi edhe një sy hyrjes së pallatit përballë e hyri në dhomën e gjumit. Të nesërmen në mëngjes do të niseshin, ishte nata e fundit. Nuk do të kthehej më kurrë këtu, nuk kish çfarë të kërkonte. Mirin e kish zënë gjumi. Kundroi fytyrën e tij dhe për herë të parë u ndërgjegjësua se nuk kish qenë një grua e mirë për të dhe e vrau ndërgjegja. Prapë nuk i kujtohej asgjë nga ç'kish bërë, por më mirë kështu. Po t'i kujtoheshin ato që kish dëgjuar për llogari të saj, nuk do të kish guxim ta shikonte në sy. Cfarëdo që të kish bërë, për një gjë ishte e sigurtë, tashmë në zemrën e saj kish vend vetëm për këtë burrë. U përkul dhe e puthi lehtë në buzë. Kjo vetëm sa ja shtoi dëshirën dhe e puthi prapë e prapë, derisa ai u zgjua dhe përfshiu në krahë.

- o -

Brofi përperjetë duke ju marrë fryma. Endrra endej ende aty, në dritën e hënës që luante me perdet e dritareve të hapura. U çua e duke u munduar të mos bënte zhurmë e zgjonte Mirin, veshi fustanin që ish i hedhur mbi dysHEME dhe doli. Andi me Elonën e prisnin tek ajo ura që ndodhej mbi lumin e vogël, pak para se të derdhej në det. Kështu i kishin thënë në ëndërr, zëri i tyre i tingëllonte ende në veshë. Si vallë nuk e kishte njohur atë urë, kish kaluar mbi të e nuk ish kujtuar se në ëndrrat e saj të vjetra, ishte hedhur pikërisht nga ajo urë. Përse ishin aq të trishtuar Andi me Elonën? Shpejtoi këmbët, ishte pranë urës, por nuk shihte njeri mbi të. C'do gjë kish nisur aty, problemet e saj kishin filluar aty. Eci e ndaloi në mes të saj, vështroi përreth. Asnjë frymë njeriu. Me mirë kështu, çdo të mendonin po të shihnin një grua fill të vetme në atë orë të vonë të natës? U pështet pas parmakut e pa poshtë. U rrenqeth kur vuri re se sa i ngjante kjo pamje ëndrës së saj. Ju duk sikur dalloi diçka aty poshtë por ishte shumë errësirë për të shquar gjë. Horizonti pak nga pak nisi të çelej, po asaj nuk i bëri përshtypje. I dukej sikur kish një jetë që qëndronte sipër asaj ure, në të njëjtin vend. Një mendim që i lindi papritur, e alarmoi. Ajo jetë e bukur, ku ajo ishte e pasur, ku burri i saj ishte besnik... mos ishte vallë... iluzion që truri i saj i lodhur kish krijuar për t'u mbrojtur nga dhëmbja torturuese e tradhëtisë... dhe e humbjes... Filloi të qeshte me të madhe. Kish parë ëndërr me sy hapur. E ç'ëndërr? Kish ringjallur gjyshen e babanë e saj që kishin vite që kishin vdekur. Kish sjellë në jetë fëmijët që kish abortuar. E kish ardhur këtu si turiste, ndërsa në realitet e priste ai turn i lodhshëm në atë azil pleqsh. Ha, ha, ha... manastir... E spjegimi i vështirë që i trembej aq shumë me burrin që e tradhëtonte... Dhimbja ju kthye therrëse e torturuese... Dhimbja ... është realitet... Qielli u përflak e ajo u ngjit mbi parmakun e urës. Kish qenë ëndërr e bukur vërtet, por ja kish bërë akoma më të padëshirueshëm kthimin në realitet. Rrezet e

përgjakën aq sa asaj ju duk sikur duart i kullonin gjak. I kish parë edhe një herë tjetër kështu. Ishte e dhimbshme, nuk donte t'i shihte më, nuk donte të shihte më asgjë. Mbylli sytë dhe u përkul përpara. Forca, tha me vete, hidhu, mos ki frikë. I dha trupit. Dy duar të fuqishme e mbërthyen për beli, e ngritën peshë dhe e ulën në tokë.

- Mira, zemër, ç'bën kështu?

- o -

Kish kaluar më shumë se një vit që kur ishin kthyer dhe ajo me Mirin nuk e kishin zënë kurrë në gojë atë që kish ndodhur atë natë. I ish mirënjohëse për këtë pasi i vinte turp nga vetëvetja kur e kujtonte dhe largonte me shpejtësi çdomendim që kish lidhje me atë fragment. Pak nga pak kishte zënë vendin e vet në familje e në punë. Nuk bënte më sekretaren, tashmë merrte pjesë në këshillin teknik të firmës. Babai e miratonte në heshtje e ajo shihte atë shkëndijëz krenarie në sytë e tij sa herë që ajo merrte pjesë në diskutim. Nisi të vendosej ai raport i vjetër respekti e besimi reciprok. Nuk ishin më vetëm atë e bijë, ishin shokë dhe kjo e bënte akoma më të çmueshme lidhjen e tyre. Ndjehej e kompletuar, pothuaj e lumtur. E lumtur... Kishfrikë ta shqiptonte atë fjalë. Sa herë që e mendonte, një ankth i ngrihej e i zinte frymën. Dhe kish të drejtë. Ishte ende aq e brishtë sa mjaftoi një ëndërr tjetër që t'i prishej qetësia dhe ekuilibri mendor e shpirtëror. Andi me uniformë ushtarake e me helmetë në kokë në një llogore. Një bombë ra e shpërtheu aty pranë. Andi i shtrirë përtokë dhe ajo që afrohet me frikë, nuk e di nëse është vrarë apo vetëm ka humbur ndjenjat. Duart e saj që zgjaten drithshëm tërë ankth drejt tij. U zgjua. Miri flinte. U çua nga shtrati e doli në oborr. Nata ishte e zezë, as hënë dhe as yje. Por profumi i luleve nuk mungonte e kjo i kujtoi atë shenjtin që kundërmonte erë lulësh. Njëkohësisht ju kujtua plaka e filxhanit. Ku e kishte futur kartëvizitën e saj? Ndoshta i kish ardhur rradha edhe kësaj pune të pakuptimtë e në të cilën nuk kishte as edhe një shpresë, ishte veç një mjet i dëshpëruar. Por a nuk ishte dhe ajo e dëshpëruar... e kur jemi të tillë... Hyri brenda e kërkoi kartëvizitën, e gjeti dhe pa çarë kokën për atë orë që nuk ishte aspak e përshtatëshme i telefonoi. Teksa dëgjonte sinjalin e ziles nga ana tjetër mendoi se ndoshta nuk do ti përgjigjej njeri, ndoshta më mirë, kështu që mund edhe të ndërronte mendje e... Për çudi, receptori u ngrit e zëri çuditërisht i njohur edhe pse e kish dëgjuar vetëm një herë e shumë kohë më parë i la takim në orë dhjetë. Dhjetë?! A e kish idenë ajo plakë e çmendur se ajo po vdiste nga ankthi? Apo e çmëndura jam unë, pyeti ajo veten. Nuk i tha gjë askujt, si një robot përsëritiveprimet e çdo dite, e në dhjetë pa një çerek doli nga ndërtesa e punës. Dhjetë fiks. Trokiti. Një shtëpi e veçuar në të dalë të qytetit, e

mykur nga koha e pleqëria. Edhe shtëpitë plaken, si të zotërit, mendoj ajo tek ndjeu shulin e derës të kërciste. Plaka nuk kish ndryshuar as edhe një fije nga dita e parë që e kish parë, rrjeta e rrudhave i buzëqeshi.

- E dija.- i tundi kokën duke i bërë udhë.

- Shpresoj se nuk ju shqetësoj.

Plaka u kthye dhe e vështroi drejt e në sy, e ajo ndjeu shpirtin e saj të zhvishej dhe i hynë të dridhura.

- Përkundrazi, kam kohë që të pres,- i tha plaka,- kam thirrur edhe dy motrat e mia.

Ktheu kokën në drejtimin e dorës së plakës, dhe gati sa nuk briti. Në dy çilte basmeje me lule ishin ulur dy plaka të tjera që ngjanin me të parën si pikat e ujit. Ato e përshëndetën me kokë duke i buzëqeshur dhe i bënë shenjë me dorë të ulej në çilten përballë tyre. Një moment desh t'ja mbathte me vrap, por këmbët nuk ju bindën, përkundrazi e çuan pranë çiltes që ishte caktuar për të dhe u ul me pahir pa jua ndarë sytë e trembur. Plaka, e cila i kish hapur derën, sa hap e mbyll sytë, i solli filxhanin me kafënë që nxirte avull, dhe ajo e piu sikur po pinte helm. Ato nuk ja ndanin sytë në heshtje, dhe asaj ju duk vetja jo vetëm lakuriq, por trupi e shpirti i digjnin sikur po i rrjepnin tri lëkurë njëra pas tjetrës.

- & -

Ja rrëmbyen filxhanin nga dora sapo mbaroi së piri kafënë, e rrotulluan dhe e përmbysën. Nuk kishte guxim të fliste, dukej sikur mbi dhomë kish rënë muzgu e tri palë sy që një çast më parë i ishin dukur të kaltër, befas ishin bërë të zinj sterrë e qëndronin ngulur mbi të. Pastaj panë në sy njëra tjetrën pa folur, e shprehja e fytyrave të tyre nuk premtonte asgjë të mirë. Rrudhat ishin thelluar duke u dhënë një pamje kërcënuese, të paktën kështu ju duk asaj. Në ç'strofull kamrënë, përse erdha këtu, si ka mundësi të jem kaq budallaqe e mendjehetë? Mallëkoi çastin që kish telefonuar, asnjëri nuk e dinte ku ndodhej, asnjë nuk mund ta ndihmonte e ta nxirrte që aty.

- Mos ki frikë, nuk të mbajmë këtu.- foli njëra nga plakat.

I shikoi me habi, nuk ishte e sigurtë nëse i kishin lexuar në mendje apo ishte thjesht një frazë qetësuese që përdornin për klientët e trembur. Tani nuk e dinte cila prej tyre i kishte hapur derën. Secila prej tyre ndezi nga një qiri të vendosur përtokë përpara çilteve dhe i bënë shenjë të bënte dhe ajo ashtu. Bënë kryqin dhe e

urdhëruan dhe atë ta bënte. Ku dreqin ka shkuar e i ka njohur Teuta këto, mendoj ajo dhe gati sa nuk buzëqeshi me këtë mendim për gjyshen e saj që nuk kishte as edhe një kriter në zgjedhjen e mikeve të saja, as shoqërore dhe as fetar. Një nënqeshje e lehtë u end fytyrave të plakave, që morën me rradhë filxhanin ndër duar dhe e shqyrtuan një copë herë. Kur e treta e vendosi përtokë, kryqëzuan shikimet pa folur. Pastaj ju kthyen asaj.

- Bëj edhe një herë kryqin!- e urdhëroi njëra.

- C'farë!?

- Lutju Zotit për ç'ka ke më të shtrenjtë në zemër, në fund bëj kryqin. Kryqi bëhet kur lutesh, apo jo?

- Më falni, nuk jam as katolike dhe as ortodokse praktikante dhe kjo punë e kryqit...

- Ashtu!? Kush tha se kryqi është i tyre? E kanë vjedhur. Ti bëj ç'të themi ne.

Mbylli sytë e mendoj për ç'kish në zemër. Të bijtë, Andi këtu dhe Andi atje, Elona këtu dhe...atje, Arbena, Sara, Dejvi... Miri, prindërit... Të dyzuar... Babai në zyrë... babai... një varr që e priste stampuar sipër buzëqeshjen e tij... Mendja ju rrotullua, realiteti dhe ajo... tjetra imagjinaria ndërthureshin me shpejtësi duke ndërruar vend me njëra tjetrën... Zot! Për kë të lutem më parë... Për të gjithë... Bëri kryqin me dorën që i dridhej.

- Shoqëroje me sytë e mendjes e të shpirtit, tri herë!

U bind e bëri ç'i thanë. Pastaj hapi sytë që i hasën në gjashtë copëza liqeni të kaltër.

- Interesante!- esklamuan njëherësh të tria.

Gjaku i hipi në kokë. Interesante! Vallë për këtë kish ardhur, për të marrë vesh se ishte interesante... psikanalisti i saj diçka dinte nga kjo punë...

- C'të pruri këtu ?- pyeti plaka e pare nga e majta.

- Mbrëmë bëra një ëndërr të keqe.

- Na e trego!- e urdhëroi.

Tregoi me hollësi ëndërrën, ndërsa ato e dëgjuan në heshtje. Kur mbaroi vuri re se sytë e tyre ishin sërish të zinj si qielli i natës së kaluar.

- Endrra nuk është e mirë, por shfaqja e saj ka diçka të mirë.

- Të mirë!? Jam e tmerruar...- briti Era.

Plaka ngriti doren lart duke i bërë shenjë të pushonte.

- Ne të dëgjuam. Unë flas vetëm një herë, mos më bëj pyetje dhe mos më ndërpre. Djali yt do të jetë në rrezik për një vendim të tijin, nëse e merr. Endrra është paralajmëruese.

- Paralajmëruese!? - nuk u përmbajt Era.

- Nuk e di çdo të thotë paralajmëruese? - zëri ishte bubullitës dhe i shtiu të dridhura.

- Qetësohu motër,- ndërhyri me zë të ëmbël një tjetër. - Ja shpjegoj unë. Fati i njeriut është i shkruar, por ka momente ku të lë të zgjedhësh, ku të jepet mundësi të ndërhysh e ta shkruash vetë një pjesë të tij, kur na vë para një udhëkryqi. Nëse fati do, të paralajmëron, të çon një shenjë, një sinjal. Fati i tët biri mund të jetë ai i ëndrrës që ke bërë, vetë ëndrra është shenjë e mirë. Nëse fati do ta kish dashur të vdekur, nuk do të kishte paralajmëruar.

- C'farë duhet të bëj? - u pergjërua Era.

- Të takon ty ta zgjidhësh këtë mister, ty të është dërguar ëndrra. Vëre me kujdes se si do të rrjedhin ngjarjet këto ditë, ç'vendime mund të marrë yt bir e ndërhy pa frikë, fati do të të ndihmojë.

- Sa ju detyrohem? - u përpoq të ngrihej por këmbët i ishin mpirë. Sytë si thëngjij të zinj e kishin fiksuar dhe asaj filloi t'i mungonte ajri në mushkëri.

- Përse nuk na flet për ëndrrat e tjera?- foli plaka e parë.

- & -

Zgurdulloi sytë e trembur. Do ta mbanin akoma aty? Përse me ëndrrat e tjera, mos i kishin parë dhe ato në filxhan? Që i lexonin në mendje e kish kuptuar që në fillim. Janë si shtriga, mendoj, dhe të këqia.

- Jemi shtriga! - e vërtetoi mendimin e saj e para.

- Të mira! - pasoi e dyta.

- Duam të të ndihmojmë për hatër të gjyshes tënde, - shtoi e treta dhe kuptoi se ishte ajo që i kish hapur derën.

- Për çfarë? Nuk kam nevojë për ndihmën tuaj!

Kundërshtimi i saj ra në vesh të shurdhër, i vunë përpara një filxhan të mbushur me një lëng të errët e aromatik dhe e urdhëruan ta pinte. Cuditërisht u bind dhe e piu me një frymë. Do të bënte ç'i kërkonin ato, mjaft që të mbaronin shpejt e ta linin të ikte. Efekti i lëngut ishte i shpejtë e marramendës. Drogë, mendoj ajo dhe i erdhi keq se babai i saj do te mbetej i zhgënjyer po ta merrte vesh.

- Do të kthjellohesh shpejt dhe nuk do ta marrë vesh, - qeshi njëra nga plakat. Cudi dhe shtrigat qeshin, mendoj ajo, tek ndjeu se forcat po e linin dhe mendimet nuk i bindeshin më.

- Na trego për jetën tënde, që nga mosha që zënë e nisin kujtimet!- zëri ishte i qetë, por autoritar.

Mbylli sytë e filloi të fliste, nuk kish nevojë të mendohej, fjalët rridhnin ashtu siç rridhnin dhe ndjesitë e provuara në kohë të shkuara. Herë fliste e qeshte, herë qante, hera herës zëri ishte monoton, britma, të qeshura, inate e zemërime, e fliste e fliste pa pushim...

- Mjafton!- foli njëra nga plakat duke përplasur shuplakat.

U përmend dhe e gjeti veten të shtrirë në çilte. U ngrit ndenjtur duke parë e hutuar kaltërsinë atyre syve që e fiksonin.

- Je mirë? - pyeti plaka e parë.

Mira pohoi me kokë.

- Do të dish arësyen e ëndrrave që të shqetësojnë apo do të vazhdosh përpara e t'i lesh prapa?- pyeti e dyta.

- Nëse i lësh prapa, do të jetosh e qetë, ne do të t'i largojmë. Nëse do të dish shkakun, nuk ka kthim prapa. Endrrat do të bëhen më të shpeshta e duhet të gjesh zgjidhjen, e cila mund të mos të pëlqejë, ashtu siç shpesh nuk na pëlqen e vërteta. Të mbetet të zgjedhësh e të na japësh një përgjigje. Jo sot, as nesër. Kur të jesh gati, ne jemi këtu.

- Ju e dini shkakun?- pyeti Era.

Plakat u panë me njëra tjetrën një hop. Pastaj njëra foli:

- Ende nuk kemi një ide të qartë. Por nëse ti bashkëpunon, do ta gjejmë.

Pa orën, kish kaluar pesën. Rrëmbeu çantën e doli me nxitim. Plakat, të tria më këmbë përpara dritares, e ndoqën me sy.

- Nuk më bën zemra t'i tregoj Teutës, - foli ajo që kish hapur derën.

- Atëherë mos i trego, - folën me një gojë dy të tjerat.

- & -

Nuk pati guxim ta gënjente Mirin, edhe se nuk mund të ishte krejtësisht e sigurtë. I tha se kish parë një ëndërr të keqe dhe kish shkuar tek një fallxhore, për më tepër nxorri nga çanta kartëvizitën e plakës, nëse nuk i besonte, mund të merrte në telefon e të pyeste. Ai vuri buzën në gaz me pahir dhe tha se rëndësi kish që ishte shëndoshë e mirë, pasi ai ishte bërë merak për të. Teuta ndiqte bisedën me sy të shqetësuar. Më pas e pyeti për ëndrrën dhe si ja kishin spjeguar.. Fakti se kishin qenë të tria motrat e turbulloi. “Nuk është shenjë e mirë”, i tha, “qëndro larg tyre”. Pjesën e dytë, nuk e zuri në gojë. Miri kish marrë një gazetë, ulur mbi divan, e bënte sikur lexonte. Ndjeu se qëndrimi i tij kish ndryshuar, në sytë e tij shihej qartë trurbullimi, si ditët e para pas ngjarjes së urës. Me siguri mendon se jam e çmendur dhe bëj ndonjë të pabërë, mendoi ajo. Kur erdhën prindërit e saj në mbrëmje dhe babai e pyeti se ku ishte zhdukur tërë ditën, në vend të saj u përgjigj Miri, që i tha se kish qenë tek një shoqe. E ndjeu veten keq, i shoqi ishte detyruar të gënjente për të, dhe kush, ai që i urrente gënjeshttrat. Ishte më keq se ta

kish goditur me shuplakë. Ajo mbrëmje nuk u mbyll me kaq, vonë erdhi Andi i pirë, projekti në të cilin po punonte që prej dy vjetëve, ecte ngadalë dhe universiteti i kish mbyllur fondet. Një zhgënjim që e kish çuar tek gota. I sëmboi në zemër, mos vallë ishte kjo ëndrra e saj, djali i zhgënjyer që gjente ngushëllim tek alkoli? Andi i alkolizuar..? I qëndroi tek koka duka pastruar të vjellat e tij e duke u munduar t'i jepte zemrër. I foli ëmbël e me durim, i tha se jeta është e mbushur plot me të tilla goditje e zhgënjime, e ai duhej të mësohej me to. Kur e zuri gjumi të birin, shkoi në shtratin e saj e qau në heshtje për të mos zgjuar Mirin. Por sytë e lodhur e me rrathë të zinj të të shoqit në mëngjes i dhanë të kuptonte se edhe ai nuk kish fjetur atë natë. Ai iku në punë dhe i tha të qëndronte në shtëpi e të kujdesej për Andin, por më parë i shkëputi premtimin se nuk do të bridhte nëpër fallxhore...

- & -

Miri iku, ndërsa ajo mendoi të rrinte dhe pak në shtrat. Kish dremitur e kur u zgjua pa se ishte goxha vonë. U çua e shkoi në dhomën e Andit. Nuk ishte aty. Një parandjenjë e keqe e bëri t'i zbriste shkallët me vrap duke e thirrur. Teuta i tha se kish ardhur një shok dhe e kish thirrur. Endrra i rrinte pezull para syve. I biri me fytyrë të gjakosur... E mori në telefon po nuk i përgjigjej. Ju këputën duart e këmbët e nuk ish e zonja të bënte as edhe një punë. U ul mbi divan dhe e priti aty duke parë akrepat e ngrirë të orës në mur. Sara me Dejvin u kthyen nga shkolla, pastaj ja mbërriti Arbena.

-Ai është i lojtur,- shfryu ajo, - ka vendosur të shkojë e të luftojë në Iran!

- Kush?- pyeti Sara.

- Ti e dije mama? Mama! Mama! Vera shpejt! Mama!

- o -

Kur hapi sytë, fytyra e Andit i rrinte mbi kokë. Qelbej alkol, por asaj aq i bënte. I biri ishte aty. Ai fliste e mendohej të bënte ndonjë shaka, por asaj nuk i vinte për të qeshur. E pyeti nëse ishte e vërtetë se kish vendosur të... Përgjigja e bëri të akullohej. Shihte fytyrën e bukur e të qeshur të djalit e një valë zemërimi e

pushtoi keqas. Bij bushtrash, mendoi, çoni bijtë e nënave të vriten. Po iku, nuk do ta shoh më kurrë të gjallë, do te vdesë... I shpëtoi një rënkim e i vërshyen lotët. Të gjithë ishin të habitur me vendimin e Andit, por asnjë nuk po ngulte këmbë ta ndalonte medoemos. As Miri me Agronin. I vinte t'i mbyste me duart e saj. Si mund ta linin të vendoste një copë fëmijë për një gjë kaq të rëndësishme? Ua përplasi në fytyrë dufin e saj, por Agroni tha se nuk mund të thuhej i vogël për një njëzetedyvjeçar, e edhe se atyre nuk u pëlqente, ai kish të drejtë të vendoste vetë. Megjithatë, duke parë sa e shqetësuar ishte e bija, u mundua ta qetësonte duke i thënë se si infermier do të ishte në prapavijë e pas gjashtë muajsh do të kthehej në shtëpi shëndoshë e mirë si kokrra e mollës. Pastaj, shtoi ai, përvoja e luftës do ta rriste e do ta burrëronte. Kundërshtoi, Andi, nuk e kish mbrojtur ende diplomën. Nuk prish punë, e mbron kur të kthehet, qe përgjigja e tij. Ishte e dëshpëruar, askush nuk e kuptonte ankthin e saj, asnjë nuk kish përjetuar tmerrin e ëndrrës së saj. Sytë e hapur e të ngrirë në përqaftimin e fundit me kaltërsinë e qiellit... të një qielli të huaj... Iran... Në imagjinatën e saj kish qenë Iraku ku kishin kërkuar për armë atomike e nuk i kishin gjetur... Terrorizmi... Largoi vegimet e vjetra, nuk kish kohë për to. Endrra... “është paralajmëruese”, i kumboi në veshë zëri i plakave. Nuk rris fëmijë unë që të vritene të vrasin për të tjerë, mendoj me mllef e ja nguli sytë pa ja shqitur Teutës derisa kapi shikimin e saj. I bëri një shenjë të padukshme që e kuptonin vetëm ato të dyja dhe pas pak ishte vetëm për vetëm me të në dhomën e saj.

- & -

Sapo hynë në dhomë, Teuta ndezi një qiri e nisi të lutej. Edhe këtë kish mangut tani...

- Teuta!

Ajo i bëri shenjë të mos e ndërpriste ndaj priti sa e mbaroi lutjen.

- Teuta, dua të të kërkoj një favor, por nuk di si të ta them. Më vjen turp.

- Bjeri shkurt!- i tha prerë Teuta.

- Babai më ka thënë se testamentin e ke bërë në emrin tim.

- Po, por unë nuk kam vdekur akoma. - Teuta ishte e rëndë e serioze por Era dalloj se sytë po fillonin t'i përshkënditeshin.

- Më fal, zëre se nuk të thashë gjë,- u kthye ngadalë e bëri të dalë nga dhoma.

- Eja këtu e spjegohu!

Ndali hapin, e kish ditur, kureshtja ishte më e fortë se gjyshja.

- Sa janë?- pyeti pa e kthyer kokën nga ajo.

- Nuk janë pak.
- Sa?
- Më parë më thuaj për çfarë të duhen!

Mira u kthye drejt saj.

- Të financosh projektin e Andit.
- Nuk do të mbetet gjë për ty.

Mira ra në gjunjë e i puthi duart.

- Nuk dua gjë. Shpëto tim bir!
- Po a ke menduar se mund të iki gjithsesi?
- Të paktën kemi provuar.

Teuta i përkëdheli flokët e i puthi sytë e përlotur.

- Di si bëhen këto punë? – e pyeti.
- Jo.
- As une. Do të zbavitem, Teuta Kruja që financon eksperimente mjekësore. Ah moj bijë, çfarë nuk kam menduar në jetën time, por një gjë të tillë, kurrë. Ik, shko e më sill tët bir, flas unë me të.

- o -

Nuk kish kaluar ende muaji, kur Zana, e fejuara e Andit u dha në derë e pyeti për të. Sytë i kish të skuqur.

- C'ka ndodhur? - e pyeti e alarmuar Era.
- U vranë... të tre...

Erës i ra tiganin nga dora. E dinte se tre shokë të Andit ishin inkuadruar në repartin që kish shkuar në Iran.

- Si... si ndodhi...
- Nuk e di. Do ta japin në lajmet e orës tetë.

Shikoi orën, dhe dhjetë minuta të shkante tetë. Dërgoi Dejvin të thërriste Andin që ish ngjitur lart të bënte dush e të pushonte pak. Në derë u dha Miri që u habit kur pa Zanën që po qante. I hodhi së shoqes një shikim pyetës, e ajo kafshoi buzën e poshtëme. Asgjë e mirë, mendoj ai, kur bën kështu... Ra zilja e portës e prindërit e saj hynë brenda e vështruan të habitur Enin, por Teuta u bëri shenjë të ulëshin mbi divan. Ishin të gjithë aty me përjashtim të Andit. Elona ish ulur në krah të kolltukut ku ish ulur Agroni, ndërsa Arbena pranë Mirit. Dejvi me Sarën i rrinin ngjitur së ëmës. Sapo filloi sigla e fillimit të lajmeve, zbriti Andi që fiksoi një moment Zanën, por kur vuri re se të gjithë ja kishin ngulur sytë ekranit të televizorit, ktheu sytë

andej. Lajmi i parë, tre djem nga vendi i tyre kishin humbur jetën në Iran. Makina ishte hedhur papritmas në erë në një zonë të minuar. Thanë emrat, datëlindjet, vendlindjen... Në fund, spikeri e mbylli me frazën se me vdekjen e tyre kishin nderuar atdheun. Era u rrënoqeth tek kujtoi ëndrrën e saj.... Tre djem të rinj, në moshën më të bukur, të copëtuar aq sa edhe copat nuk e dinte se si mund t'i mblihdnin, tre jetë të humbura që nuk zinin më shumë se pesë minuta lajme. C'atdhe kishin nderuar? Ajo luftë nuk kish të bënte fare me atdheun e tyre. Mjerë ato nëna, ç'do tu fusnin në arkivolet kur t'ua binin në shtëpi? Mund të kish qenë dhe i biri atje... kish ndërruar mendim momentin e fundit dhe kjo falë Teutës e parave të saja... Kishin shtangur të gjithë e shikonin Andin që mezi i mbante lotët, ish rritur me ta...kishin ardhur kaq herë në shtëpi. Andi u ngrit e doli në oborr, Era desh ta ndiqte por pa Zanën që u ngrit pas tij. I pa të përqafoheshin, ajo vajzë që nuk e duronte në fillim i ishte bërë simpatike që kur e kish përkrahur për ta ndaluar të birin të bënte atë marrëzi. Një vajzë më shumë në shtëpi, mendoi tek ktheu kokën e pa Elonën e Arbenën që flisnin me zë të ulët e me sy të përplotur. Tashmë ishte e bindur, në shtëpinë e saj nuk do të flitej më për të shkuar në luftë e për t'u vrarë për interesat e të tjerëve. Mori frymë thellë e u ndie e lehtësuar, por kjo nuk zgjati shumë tek mendoi ato nëna të shkreta që pritnin arkivolet e bijve të tyre... Për pak...

- & -

Ditët kalonin e dyshimet ju kthyen më të forta se kurrë. Tundimi për të marrë në telefon plakën e filxhanit, e torturonte nga mëngjesi në mbrëmje. Kish frikë se... E fundja përse? Jeta e saj po rregullohej përditë e më mirë. Fëmijët ishin mirë, e donin dhe e respektonin, Teuta gëzonte shëndet, Miri e rrethonte me dashuri ndërsa prindërit i vinin çdo mbrëmje në shtëpi. Andi, optimist, punonte mbi projektin e tij e përgatitej për të dhënë provimet e diplomës. Sara me Dejvin rriteshin e hidhnin shtat, por i gëzoheshin asaj sikur ishin ende të vegjël. Elona, kish gjetur veten e saj në botën e modës. Vizatimet e modelet e saj pëlqeheshin e kërkoheshin gjithnjë e më shumë. Arbena, ishte tip tjetër, interesat e saj drejtoheshin drejtfizikës. Ish fejuar me profesorin e ri të fakultetit të saj, tashmë dhe ai vinte pothuaj çdo mbrëmje aty, e sillte atë buzëqeshje të bukur. Ndërsa ajo... duhet të jem e lumtur, qortonte vehten. C'ka është që më pengon? Endrrat, përgjigjej po vetë, ai ankth i mbrëmjes, frika se mos të të shfaqen në mes të natës e të kapin për fyti... Endrrat... kishin filluar ta vizitonin rregullisht...

- & -

Trokiti lehtë. Po sikur të mos ketë njeri në shtëpi, mendoj dhe u pendua që nuk kish telefonuar më parë. Trokiti më fort, duke mos e ditur as vetë nëse do të dëshironte të hynte brenda apo jo. I ish nënshtruar impulsit, kish vendosur në një çast e gjithë rrugës ishte munduar të mos mendonte më. Ngriti dorën për të trokitur, këtë herë më fort, e dora i mbeti pezull në ajër. Mbresat e asaj dite të kaluar aty e sulmuan e trupi ju mbush me mornica. Ju duk sikur cepi i një perdeje lëvizti në dritaren pranë e ajo ktheu majat nga thembrat e u largua me nxitim.

- & -

Mbrëmje vonë, zilha e celularit të saj në skermën e të cilit shkruhej se numri ishte i panjohur. Ngurroi një çast, zemra nuk i ndillte asgjë të mirë e megjithatë e hapi, njohu menjëherë zërin që kishte atë timbër që nuk mund ta ngatërronte me asnjë tjetër e zemra i rrahu si zog i trembur. Kemi të reja, duhet të vish medoemos nesër, ora dhjetë, i tha me ton urdhërues e autoritar që nuk pranonte kundërshtim dhe e mbylli. Fiksoi një copë herë celularin derisa u kujtua se Miri dhe Teuta ishin aty e nuk ja ndanin sytë. Me mundim sajoi një buzëqeshje.

- Një shoqe,- tha dhe doli në oborr sepse po i merrej fryma. Nata ishte e bukur, me hënë dhe yje. Aroma e luleve sikur e qetësoi. Cudi, i bënte gjithnjë këtë efekt. Edhe atje...Para syve të saj u shfaq një varr i thjeshtë, mbjellur lule anash. Atij i kishin pëlqyer gjithnjë lulet e freskëta, urrente ato artificialet... nuk i kish dashur kurrë në shtëpi... i thosh se po të ishte e zonja t'i mbillte e t'i mbante... E ajo ishte kujdesur që të mos i mungonin... sa herë shkonte i ujiste e aroma e tyre sikur ja sillte më pranë kujtimin e tij, sytë në fotografinë e porcelanit nënqeshnin e i krijonin ndjesinë se edhe buzët do të lëviznin e do ti flisnin... Baba i dashur, ku je në të vërtetë, a do ta zgjidh vallë ndonjëherë këtë mister, mermëritipadashje. Zot, më ndihmo! Befas ndjeu aromë manushaqeje. Nuk kishte mbjellur manushaqe as atje e as këtu. Nga vjen kjo aromë... nga... thonin se ai shenji kur të dëgjonte një lutje dhe e mirrte përsipër të ta zgjidhte e të bënte një mrekulli, të dërgontekëtë aromë. Ajo vetë, nuk u kish besuar kurrë mrekullive, këto gjëra i kish dëgjuar e aq. Kisha e kish luftuar në të gjallë, e kish shpallur mashtrues, kish thënë se kush shkonte dhe i drejtohej atij vepronte kundër saj. Por njerëzit me hallet e tyre nuk kishin reshtur së shkuari... Një frat që bën mrekulli... kisha kundir mrekullive kur vetë i kish rrënjët në mrekullitë e Jesuit... Do të shkoj nesër, ndoshta i ka ardhur koha të zgjidhet ky mister, ndoshta... do të shërohem... Nëse ndodh një mrekulli, shtoi ajo...

- & -

Trokiti e vendosur, fort, pa ju dridhur dora. Në shpirt i kish mbetur ende diçka nga besimi i mbrëmjes se kaluar. Ja hapi plaka sykaltër, por ajo e dinte se ata sy ndryshonin ngjyrë shumë shpejt. Ndoshta dhe kjo bën pjesë në mrekullitë, vuri buzën në gaz ajo, të shohim atë që më kanë përgatitur mua. Por buzëqeshja i ngriu në buzë a çakërriti sytë nga britmat e një burri, i cili nga veshja dukej si endacak, i cili brofi i trembur nga çiltja ku ish ulur e shishja e verës i ra përdhe dukeu zbrazur mbi dysheme, ndërsa tregonte Erën me gisht.

- Kjo ishte atë natë atje! Përse nuk më thatë që do të vinte këtu? Unë nuk mund të rri ndën një çati me të...

Njëra nga plakat, ajo që ndodhej më pranë tij, i vuri një dorë mbi sup dhe duke e shikuar ngultas në sy, e detyroi të ulej mbi çilte. I tmerruar burri nuk ja ndante sytë Erës e bënte kryqin pa pushim.

- Ku isha? - e pyeti e hutuar dhe e zemëruar duke bërë një hap drejt tij. Cfarë po i kurdisnin, ç'donte ai burrë atje?

- Larg meje demon! - klithi burri duke ngritur duart për tu mbrojtur.

- Nuk është demon! - tha njëra nga plakat e çuditërisht zëri i saj e qetësoi e ai rrëmbeu shishen që ndodhej përtokë.

- Eshtë bosh! - u qa ai. I zgjatën një tjetër të mbushur plot dhe ai e ktheu duke gëlltitur gjysmën e saj, fshiu buzët me mëngën e xhakëtës së vjetër e ja nguli sërish sytë Erës.

- Ku isha? - ngulmoi ajo.

- Të mendova të vdekur dhe ja mbatha, - ai ktheu sërish shishen, - kur qielli të hodhi aty mbi rërën e plazhit... T'u afrova por m'u duk se nuk merrje frymë. Sapo të kish përpirë... - befas ai qeshi, - Ai... ai maskarai të rrahu aq shumë sa thashë se të kishte vdekur, e ajo që po shihja ishte shpirti yt që ngjitej në qiell, kur ja pa vonuar shumë të flaku përsëri aty. Ishe e vdekur. U bëfsha qorr në të gënjej. Thashë... kushedi ç'mëkat ka bërë kjo grua që qielli nuk e pranon shpirtin e saj... nuk e do, thashë, as parajsa as ferri...

- Mjaft! - njëra nga plakat ju afrua burrit dhe i zgjati para, - ik e bli një shishe tjetër e mos ec më këtu.

Ai mori paratë e duke ju marrë këmbët bëri për nga dera. Njëra nga plakat e shoqëroi dhe u kthye shpejt. U ul mbi çilten e saj përbri dy të tjerave e fiksuan Erën.

- C'ishte ai? - pyeti ajo e zemëruar.

- Një dëshmitar që të ka parë natën që përkon me urën tënde.

- Urën!? Një i dehur? Vë bast se ai nuk njeh as gruan e vet në atë gjëndje.

- Ndoshta ke të drejtë. E nëse jo?

- Cfarë? Se kam vdekur?

- Ky është mendimi i tij, e nuk na intereson, edhe se ishte një variant që nuk e kemi lënë pas dore. Ti ke folur për një tunel...

Era solli ndërmend rrotullimin e llahtarshëm në tunelin e errët ku kish humbur ndjenjat. Ndoshta kish kaluar me të vërtetë ferrin.

- Në ferr shkon shpirti, ti ke kaluar në një tjetër botë që nuk është e jotja.

- Po talleni?

- E thonë ëndrrat, dyshimet e kujtimet e tua. E thotë shenja e kryqit që bën.

Vija vertikale është një, e fortë, e drejtë, do të thotë se ekzistenca jote shpirtërore është një dhe e pandryshuar. Vija horizontale zhvendoset në një pikë, e kjo pikë përkon me tunelin, ekzistenca tokësore...

- Mjaft! - Era brofi me këmbë. Nga abisi i mendjes po i zgjohej bindja e vjetër, dyshimet edhe mund t'i duronte por bindjen... ishte tepër torturuese. Rrëmbeu çantën e nxitoi drejt derës me frikën se mos e ndalonin. Por ato nuk luajtën vendit. Para se dera të mbyllej pas krahëve të saj dëgjoi vetëm pak fjalë të thëna nga të tria njëzëri.

- Një jetë që nuk të përket!

- & -

Zëri dhe fjalët e plakave e ndoqën pas ditët në vazhdim e ajo zinte veshët me duar për të mos i dëgjuar por as kjo nuk i bënte dobi. Mundohej ta zinte kohën me punë që të mos mendonte. I pikonte në shpirt kur mendonte se... se kjo mund të mos ishte jeta e saj dhe... familja e saj. Endrrat ju bënë të përnatëshme, vetëm Andi me Elonën, të tjerët nuk hynin në to. Sikur të hynte dhe dikush tjetër, qoftë edhe një... I dukej sikur ishte zhytur në një vorbull nga ku nuk mund të dilte. E donte këtë jetë, ishte gati të vdiste për secilin pjesëtar të familjes së saj... e i thonin se... Një ditë ndaloi makinën e zbriti të blinte një paketë cigaresh. Dikur e kish pirë... dikur... Por kur u kthye në shtëpi, vorbulla u ngadalësua. Arbena i tha se kish caktuar ditën e dasmës. Cuditërisht dasma perkonte me ditëlindjen dhe ditën e kthimit të saj. Cuditërisht... aq i bënte, e kish aq për zemër lumturinë e së bijës sa u hodh kokë e këmbë në punët e përgatitjes. Pastaj, Pirro, kështu quhej burri i ardhshëm i së bijës, i pëlqente. Ishte shumë simpatik, i edukuar, i sjellshëm, inteligjent e shumë i dashur. Fizikant i apasionuar, kishte atë mënyrë simpatike të foluri e të treguari sa në gojën e tij, edhe një spjegim i nocioneve të thjeshta merrte dritëhijet e fantashkencës.

- & -

Qe një mbrëmje që po diskutonin se ku do ta kalonin muajin e mjalitit. Propozimet ishin nga më të ndryshmet e variantet aq të shumta sa të rinjtë nuk po dinin të vendosnin. Kundërshtonin njëri tjetrin e qeshnin. Era nuk ua vinte veshin, për të ishte njëlloj kudo që të shkonin, ajo që e trishtonte ishte mendimi se pas kësaj e bija nuk do të kthehej në këtë shtëpi, do të shkonte në shtëpinë e saj të re. Largimi i Arbenës nga shtëpia... pastaj e kish rradhën Elona, edhe Andi kështu kish thënë, kur të martohej... Do ti vinte rradha edhe më të vegjëlve. E përfytyroi veten të plakur, shtëpinë shurdhe pa gazin e poteren e fëmijëve, vetëm ajo dhe Miri... “ Nuk ka gjë më të dhimbshme kur shikon fëmijët që largohen duke të të marrë copat e zemrësme vehte... të duket sikur familja të copëtohet e të rrëshqet ndër duar...”, - zëri erdhi nga larg, shumë larg. E megjithatë mundi të sillte në kujtesë fytyrën e gruas së moshuar në azilin e pleqve. Të bijtë ishin martuar e banonin në qytete të tjera, i shoqi kish vdekur papritmas në gjumë, në shtrat bri saj dhe ajo e kish vënë re vetëm në mëngjes, e tronditja kish qenë aq e madhe sa nuk e kish marrë më veten... nga trutë... Veç nganjëherë kish ndonjë momente qartësie si ai ku kish shqiptuar këto fjalë... Anamaria... mërmëriti, quhej Anamaria... Lëvizti me kujdes drejt derës e doli jashtë pa rënë në sy kur fjalët e Pirros e gozhduan..

- Do të ishte bukur ta kalonim muajin e mjalitit në një botë paralele, si thua?

- Varet se ç'botë do të zgjedhësh, – qeshi Arbena e filluan të qeshnin të gjithë.

Por Pirro nuk ju përgjigj, kish qenë vetëm një mënyrë për të ndërruar me takt kursin e bisedës e filloi të fliste duke i mahnitur të gjithë me teorinë e botëve paralele. Tërë sy e veshë, Era nuk linte t'i shpëtonte as edhe një fjalë, edhe se i bënte vehtes pyetjen se ç'i interesonte ky diskutim. Ishin vetëm ide, teori, supozime, asgjë e vërtetuar. Mendja e saj përsëriste këto fjalë, por zemra nisi ti rrihte me forcë. Po sikur... Trekëndëshi i Bermudeve... Njerëz që zhdukeshin pa nam e nishan... Ufot? Herë herë hapeshin porta për të kaluar në një dimension tjetër... Kishin formën e stuhive, të një cicloni të zi... tip tunelesh... Secili mund të kishte kopjen e vet atje... mund të ishin të pafundme... edhe vetëm disa milimetra larg nesh, por ne nuk mund t'i perceptojmë... Para jo shumë vjetësh ishin zhdukur pa nam e nishan persona edhe nga qyteti i tyre dhe gazetatat kishin shkruar. I kishin kërkuar më kot, asnjë lajm prej tyre. Pirro tha se mbante mend edhe datën, por nuk ishte shumë i sigurtë, kish qenë fund maji. Era shkoi në dhomën e Sarës e hapi kompjuterin. Kërkoj në internet gazetatat e datës njëzetentë maj të para tre viteve,

por nuk gjeti gjë. Llafe, tha me vete, por u kujtua se lajmet dilnin një ditë më pas. Ose më shumë. Shikoi datat në vazhdim. Vërtet, mjaft persona ishin zhdukur. Kishte dhe dëshmi që i kishin parë të përpiheshin në vorbullën e syrit të zi që hapej në qiell. Njëri kish thënë se kish parë një grua në plazh, por pastaj vorbulla e kishte pështyrë, kështu ishte shprehur. U kthye në sallë. Pirro po fliste se ekzistonte një projekt kërkimi e studimi në Zvicër, bëheshin eksperimente, ishin mbledhur shkencëtarë nga të gjitha anët e botës e atje kishte dy shokë të tij të cilët e azhornonin herë pas here. Ajo që dinte ai, ishte se ishin bërë tentativa të cilat deri tani nuk kishin dhënë rezultat, por nuk i kishin humbur shpresat.

- Shpresat!? Për çfarë? - kish pyetur Era.

- Se nuk jemi të vetëm në univers, - ja kish kthyer ai.

- o -

Pasi u larguan prindërit e saj, Pirrua dhe miqtë e tjerë, Era doli në oborr dhe hapi paketën e cigareve. Kish vite që e kish lënë duhanin e kish ditë që e mbante në çantë paketën e blerë. E ndezi por pasi e thithi nja dy herë filluan ti mirreshin mendtë. Flaku tej cigaren e pambaruar e hyri brenda. Nuk ishte rasti që ta rifillonte. Shkoi drejt e në shtrat dhe e lodhur siç ish e zuri gjumi menjëherë. Por pas pak brofi e trembur nga shtrati. Këtë rradhë nuk kish qenë as Andi dhe as Elona, një legen materniteti i përgjakur dhe një copëz e vogël si qershizë e kuqe... ” Shikoje, ky do të ishte fëmija yt...” Arbena, mermëriti ajo, fëmija i parë që kam abortuar... Krahërori filloi ti digjte nga dhëmbja. Nuk është ëndërr, është ankth, mendoj. E kishfajin cigarja, i kujtohej mirë se kish filluar duhanin pas atij aborti. Nuk mund të vazhdonte më kështu... Po sikur të fliste me Pirron? Nesër do të shkoj tek psikanalisti, i premtoi vehtes, kam nevojë për ndihmë. Plakat u mundua t'i mbante larg mendimevetë saja. Tek psikanalisti. Në mëngjes u nis për në punë me këtë mendim, në të kundërt i telefonoi Pirros dhe i kërkoi ta takonte brenda asaj dite. U takuan në një kafene jo larg ndërtesës së punës. E dinte shumë mirë se nuk ishte personi që mund ta ndihmonte, por kish nevojë të shprazej. Dhe ashtu bëri, ende pa e përshëndetur mirë, zbrazti gjithë thesin e dyshimeve të saj, pa e çarë kokën që mund ta linte gojëhapur dhe ç'mund të mendonte ai. I tregoi për psikanalistin, filxhanët e plakave e burrin endacak e të dehur, i mbaroi të gjitha me një frymë, e pastaj u pendua tek pa se djali ja kish ngulur sytë gotës së ujit. Me siguri mendon se jam e çmëndur dhe do t'i thotë Arbenës, u alarmua ajo. U çua.

- Harroji gjithë çfarë të fola, më fal që të bëra të humbasësh kohën me këto budallallëqe! - dhe pa guxuar ta shikonte në sy desh të ikte por dora e tij e kapi nga kyçi dhe e detyroi të ulej.

- Prit! Mund të jenë budallallëqe, po më parë të vërtetojmë se janë të tilla. Pastaj të vazhdojmë për të gjetur mënyrën se si mund të dalësh nga kjo gjendje. Nuk mund të vazhdosh më kështu.

Erës ju mblodh një lëmsh në grykë e nuk mund të fliste. I ishte mirënjohëse atij djali që të paktën dinte të gjente fjalët e duhura.

- Ma lër mua këtë punë. Do të gjej dëshmitarin e plazhit e do ta pyes personalisht. Do të flas me psikanalistin. Më jep dhe numrin e plakës së filxhanit. Zhgarraviti numrin në një picetë letre dhe ja zgjati.

- Të lutem, Arbenës as edhe një fjalë! - u lut ajo.

- Asnjë fjalë. Kur të kem ndonjë përgjigje të marr unë në telefon.

- o -

I kaloi ditët në vazhdim si në ethe. Sa herë që binte telefoni, ishte ajo që rendte e para. Thellë, brenda saj, lutej të mos ishte Pirrua me ndonjë lajm që mund ta trondiste. Sa më shumë i thelloheshin dyshimet, aq më e shtrenjtë dhe e dashur i bëhej çdo gjë që e rrethonte. Kaloi një muaj, dy, mendoi se ai ose nuk e kish marrë seriozisht historinë që i kish treguar ajo, ose dhe kjo i pëlqente, nuk kish gjetur asgjë që të mund ta vërtetonte. Mblodhi mendjen për të qintmijtën herë të mos mendonte më për këtë. Dasma po afrohej dhe të gjithë ishin të preokupuar. Miri me Agronin kishin ndërmend të bënin festë të madhe.

- Mama, celulari yt, - dëgjo Sarën .

Ishte Pirro. Nuk i shpëtoi emocionin që tradhëtonte zërin e tij.

- Kam lajme.

- Si janë? - pyeti pasi heshti një hop.

- Nuk mund t'i them në telefon, shihemi nesër tek plaka. Të vjen mbarë në orën dhjetë?

U mendua një çast. Në atë orë bëhej mbledhja e këshillit teknik e ajo nuk mund të mungonte, babai me Mirin...

- Nuk mund ta lemë për më vonë?

- Atëherë më pesë pasdite. Shihemi atje.

Pirrua e kish mbyllur. Cfarë nuk do të kishte dhënë për të mos e marrë këtë telefonatë tani. Ndjeu ta shponin sytë e Teutës dhe e fundosi celularin në xhepin e përparësës. Nesër, kjo fjalë e bënte të kishte frikë dhe ti hynin të dridhurat. Asnjëherë nuk e kish trembur kaq shumë.

- o -

Ndenji një copë herë të mirë para se të vendoste të trokiste. Vetëm shpirti i saj e dinte se ç'kish hequr, se ç'luftë kish bërë me vehten e saj për të mos ardhur këtu. Përfundimisht ngriti dorën e trokiti.

Derën ja hapi po e njëjta që shkoi e u ul bri motrave në çilte. Në një tjetër ishte ulur këmbëkryq Pirrua, e i tregoi me gisht çilten e saj. Ju duk një komedi. U bind mekanikisht pa ja ndarë sytë atij që papritmas ju duk i largët dhe i huaj. Ai filloi të fliste pa e parë në sy. Fjalë pas fjale, tek spjegonte teorinë e tij, filloi të ngrinte shikimin derisa sytë e tij takuan të sajët, e ajo kuptoi se nuk po tallej, por besonte në ato që thoshte. Mbaroi së foluri pa ja ndarë sytë.

- Mendon se kam ndërruar vend me kopjen time të një bote tjetër paralele!? Mendon vërtet kështu?

- Pikërisht kështu. Edhe zonjat, - ai bëri shenjë nga plakat.

- Lermë një herë të kuptoj, nuk keni asnjë provë se këta njerëz të jenë transportuar në një botë tjetër, e ju më thoni se jam ndërruar me kopjen time. Pastaj, kjo teoria e Shumëgjithësive nuk më bind dhe aq. Spjegoma edhe një herë, është vërtetuar së ekzistojnë gjithësitë paralele?

- Nuk është vërtetuar ende, po të lëmë mënjanë rastin tënd. Praktikisht, një gjë është e sigurtë, ne ekzistojmë, për të tjerët nuk kemi siguri as se ekzistojnë, dhe as se nuk ekzistojnë. Praktikisht njohim vetëm katër përmasa që kanë të bëjnë me hapësirën dhe kohën, teorikisht ka dhe gjashtë përmasa të tjera. Me shpërthimin, në zanafillë, mund të jenë krijuar plot gjithësi të pavarura nga e jona.

- E çfarë!? Janë të pavarura, por mund të jenë të ndryshme, nuk mund të jenë si e jona.

- Mund të jenë krijuar gjithësi që do të ishin aq të ngjashme me tonën, sa që edhe atje të jetë krijuar jeta.

- Mund të jetë në forma të ndryshme.

- Mund të jenë edhe kopje e sonës e ndryshimi të qëndrojnë në kohë. Mundet që edhe vetë ne, të gjendemi njëkohësisht në gjithësi të tjera paralele por në një formë tjetër. Ose të ketë botë të tjera krejt si e jona ku mund të jetojnë kopjet tona.

- Pallavra! Fantazira! Nuk ka asnjë bazë shkencore.

- Shkenca nuk mund të shkojë më larg se kufijtë e njohurive tona. Me zgjerimin e tyre, zgjerohet edhe ajo. Por sa për dijeni, vetë Ajnshtajnit, i ka dalë në përfundim të një ekuacioni, qenia e një gjithësie pasqyrë me gjithësinë tonë.

- Përralla! Edhe nëse ekzistojnë, nuk mund të lidhemi me to.

- Teorikisht, nëpërmjet krimbvrimeve, një lloj tuneli që lidh dy gropa të zeza njëra me tjetrën. Gropat e zeza janë të fundme, fundi i një grope të zezë do të jetë një tjetër gropë e zezë që do të villte një send jashtë, në një botë tjetër. Por nuk dimë se ku do ta vjellë. Një krimbvrime është një shkurtim udhe përbrenda gjithësisë sonë, por edhe një urë për në gjithësi të tjera. Ndoshta do të na çonte midis kohëve të ndryshme, por rasti yt nuk është i tillë.

“Rasti yt”, këto fjalë e bindën përfundimisht Erën se ai djalë e kishte marrë vërtet seriozisht... e sikur të ishte...

- Ekzistojnë me të vërtetë këto ura... apo si i quan ti krimbvririma? - pyeti me gjysmë zëri.

- Teorikisht. Praktikisht kanë provuar në bazë të llogaritjeve të bëra, deri tani nuk kanë dhënë rezultat të dukshëm ose nuk ka qenë mundësia për ti verifikuar. Një eksperiment i tillë është bërë edhe natën e njëzetentëmajit tënd.

- Je i sigurtë? Do të kishin shkruar gazetata.

- Janë mbajtur sekret.

Erës ju kujtuan ato që kishte lexuar për njerëzit e zhdukur pa nam e nishan. Kishin eksperimentuar pa ditur e pa çarë kokën për efektin e dëmet që mund të kish e të sillte një gjë e tillë. I përfytyroi fatkeqët të hedhur në botëra të panjohura, i mungoi ajri në mushkëri nga brenga dhe ankthi që ju krijua në shpirt. Shkencëtarë!? Në emër të shkencës... në emër të saj ishte hedhur dhe bomba atomike.

- Nga i di këto?

- Dy shokë që kanë mbaruar studimet me mua bëjnë pjesë në stafin e projektit. Di se po përgatiten të bëjnë një tjetër së shpejti me shpresë se do të japë rezultat. Denoncimet për njerëz të zhdukur kanë vënë në alarm qeveri të ndryshmedhe rrethi i dyshimit po ngushtohet. Asnjë njeri nuk është kthyer, me përjashtim teje... nëse do ta quanim të tillë rastin tënd. Por këtë nuk e dinë dhe kjo është në favorin tënd. Mendo se ç’do të ndodhte po ta merrnin vesh.

I kaluan mornica tek e përfytyroi veten të mbyllur në një institut e të analizuar si një kavje aliene. Po a ishte e tillë vallë?

- C’keni ndërmënd të bëni me mua?

Pirrua bëri me shenjë nga plakati që ajo pothuaj i kishte harruar.

- Kanë premtuar se do të na ndihmojnë.

- Magji?! Vërtet u beson atyre?

- Mos i nënvlehtëso, komunikojnë me universin.

Pa folur, plakati ndezën qirinjtë dhe i dhanë një filxhan me lëng të ngrohtë me shije të ndryshme nga ai që kish pirë herën e parë. Pirrua shpalosi një hartë ku ajo njohu qytetin që i shfaqej në ëndërr. E pastaj? Ajo vetë jua kish thënë emrin e atij qyteti, nuk ishte e vështirë të stampohej një hartë të tij nga interneti. Ai i zgjati një laps dhe i kërkoi të shënonte vendin ku ndodhej shtëpia. Edhe këtë nuk e pati të vështirë, e gjeti pa mundim dhe e futi në rreth. E urdhëruan të pinte çajin e sapo e mbaroija hoqën filxhanin nga dora. Formuan një rreth duke u kapur për duarsh dhe i thanë të mbyllte sytë e të përqëndrohej në kujtimet e saja duke bërë shenjë e kryqit me mendje. Bëri si i thanë ato. Në veshë i vinte zëri i plakave që ndërthurej në një lutje të një gjuhe të njohur e të pakuptueshme njëherësh e që vinte duke u ulur derisa mori formën e mërmërimës.

- Nisu! -e urdhëroi Pirro.

Papritmas e ndjeu veten pa peshë e u ngrit në ajër. Hapi sytë dhe e pa veten tek ngrihej mbi flakën e qirinjve drejt një tuneli drite të bardhë. Uli sytë poshtë dhe e tmerruar i mbylli sërish. Atje poshtë ishin Pirrua, plakati dhe... ajo të kapur për dore. Nuk ka mundësi, mendoi, është efekti i drogës që më kanë dhënë. I hapi sytë sërish me frikë e ajo që pa e befasoi akoma më shumë. Ishte vërtet në ajër, jashtë tunelit. Në fillim u dukën konturet e qytetit që sa vinte e zmadhohej. Pastaj një rrugë, një tjetër, e një tjetër e ja, tek ndodhej mbi rrugën e saj. Ju duk sikur pallati po i afrohej dhe jo e kundërta, e dritaret ndodheshin para saj. Kish rënë muzgu e dritat ishin të ndezura. Ja dhe ballkoni, qëndroi mbi të për të shikuar nëse kish njeri brenda në dhomë. Vuri re se plakati dhe Pirrua zbritën e qëndruan pas saj e gjithashtu po mundoheshin të shikonin brenda. Një grua ishte ulur mbi divan e po lexonte. Kokën e kishte të ulur mbi libër e nuk i dallohej fytyra.

- "Era!" - dëgjoi plakati t'i thërrisnin e kur ktheu kokën drejt tyre kuptoi se nuk thërrisnin atë. Gruaja mbi divan kish ngritur kokën. Ngriu nga habia. Pa një herë veten e pastaj atë. Ishte sikur të shihej në pasqyrë, me përjashtim të rrobave.

- "Era! - zëri i plakave ishte më i fortë. Gruaja u çua nga divani, hapi derën e ballkonit dhe doli në të. Tashmë fytyra e saj ishte vetëm një pëllëmbë larg, vetëm disa centimetra. I kaloi përpara hundës tek u përkul për të shikuar poshtë në rrugë.

- Era! - dëgjoi zërin e Mirit që hyri në dhomë. Gruaja u kthye nga ai. - -
"Cfarë bën jashtë, është freskët".

- "Mu duk sikur më thirri dikush

- "Të thirra unë", - qeshi ai.

- "Cudi, mu duk sikur zëri erdhi nga jashtë," - gruaja u fut brenda e mbylli derën.

- Kthehemi! - urdhëroi Pirro.

Era nuk ja ndante sytë atyre të dyve në dhomë. Ju sul derës së mbyllur të ballkonit duke e goditur me grushte edhe se goditjet e saj ishin të shurdhëra e nuk nxirrnin as edhe një tingull. Katër palë duar e mbërthyen dhe e ngritën lart, pa jua vënë veshin kundërshtimeve të saj. Pas pak e gjeti veten ulur mbi çilte dhe katër palë sy që e zhbironin.

- Cfarë ishte kjo? Cfarë më keni bërë? - briti ajo duke mbledhur grushtet dhe ju vërsul plakave.

- 0 -

Sigurisht që e kishin qetësuar, pa qenë nevoja të lëviznin as edhe një gisht. Duart e këmbët nuk i bindeshin me gjithë inatin që i vlonte përbrënda.

- Sipas teje?- e pyeti njëra.

- Ishte magji. Me c'të drejtë ma keni bërë?

- Nuk ishte thjesht magji! - foli e dyta.

- Kërkove të vërtetën! - e pasoi e treta.

- Nuk është e vërteta! - briti.- E vërteta është se unë tani do të dal nga ajo derë e do të shkoj në shtëpinë time. E mjerë ju, po më kërkuat prapë.

- Nuk janë tuajat, as shtëpia, as burri dhe fëmijët që të presin. Ti nuk e ke vendin këtu! - tha plaka e parë. Këto fjalë ja shpuan zemrën si thika.

- Nuk mendon fëmijët e tu që të dalin në ëndërr, një grua tjetër ka zënë vendin tënd atje, a mund ti besosh familjen tënde asaj? - fjalët e plakës së dytë ja shumëfishuan dhimbjen.T'i besonte fëmijët e saj asaj gruaje mostër..? Andi, Elona...Befas një fije mendimi u ndez në mendjen e saj...

- Nëse... është e vërtetë... nëse kemi kopjet tona, ku janë Arbena, Sara, Dejvi... përse nuk janë atje?

- Mos e kërko përgjigjen nga ne, është shumë e hidhur. Kërkoja vetes dhe do ta gjesh! - sytë e plakës së tretë ishin më të zinj se nata. Mira u shkreh në vaj.

- Për atë Zot, vërtet i besoni këto? Thomëni, që nuk janë të vërteta! - foli me zërin që i shkëputej nga dënesat.

Pirro i vuri dorën mbi sup.

- Më vjen keq, por duhet t'i besosh. Në këtë pikë duhet të vendosësh të kthehesh, ose të rrish përfundimisht këtu.

- Eshtë e mundur?

- Në këtë moment jo, por nëse vendos të kthehesh do të mundohemi të bëjmë të pamundurën.

- Mendohu mirë, nëse ikën, nuk ka kthim prapa! Nëse rrin, do të të ndihmojmë të harrosh jetën tënde atje! Do ta bëjmë për hir të Teutës, ke qenë bekim për atë shtëpi. Bëji të fala nga ana ime! - sytë e plakës së parë ishin si dy liqenj tëkulluar. Kuptoi se kjo ishte shoqja e gjyshes së saj dhe se ajo mbrëmje torturuese kish mbaruar. U ngrit e i përshëndeti, Pirro e ndoqi pas.

- o -

U largua nga ajo shtëpi dhe shpirti ju lehtësua. Kjo mbrëmje kish qenë më e keqe se ëndrrat e saj, do ta fshinte nga kujtesa. Shpejtoi hapat, ishte shumë vonë. Kishin shtruar tryezë dhe e prisnin për të ngrënë darkë. U ul në tryezë por nuk i hahej. Nuk kish guxim të shikonte asnjërin në sy. Mendimi se ishte vetëm kopje e personit që besonin se ishte, e bënte të skuqej nga turpi. Mezi kaloi poshtë dy kafshata. Burri që i rrinte në krah nuk ishte burri i saj, ishte kopja e tij, vërtet më e

mirë, por nuk ishte ai. Ju mbushën sytë me lotë tek shikonte Sarën e Dejvin. Ata nuk e dinin se ajo nuk ishte nëna e tyre e vërtetë, se ajo në atë botën tjetër u kish hequr të drejtën për të jetuar që në embrion. C'do të mendonin po ta dinin se ishte vrasëse? Arbena i buzëqeshi. Sa e ëmbël që është, dhe atë e kish vrarë. Po të kthehej atje... nuk do t'i shihte më. Nuk do të kthehej, nuk mund të jetonte pa ta. Babai i tha diçka por nuk e pat mendjen. I foli sërish, ajo ktheu kokën nga ai e me të ndeshur sytë e tij, uli shikimin përdhe. Po ai... ç'do të mendonte po ta merrte vesh? Ai respekt e dashuri që ishte krijuar mes tyre... do të shëmbej... si kështjellë rëre... Do ta mendonte mashtruese e nuk do t'ja falte sa të kishte jetën. C'kish kombinuar kështu? Nuk ishte faji i saj! As që e kish ditur se mund të ekzistonte diçka e tillë, pale pastaj... Si nuk ishte faji i saj? Ishte që ç'ke me të. Përse duhej të shkonte tek ajo urë atë natë? Përcolli me zor lotët që ju mblodhën në grykë, vetja ju duk e huaj aty. Nuk ishte tjetër veç një mashtruese, hajdute, një kopje... Ata ishin aq te mirë... Andi mbaroi së ngrëni dhe u çua, ju afrua, e puthi në faqe dhe i pëshpëriti: "Ja arrita, shpejt ti dhe Dejvi do të keni nga një veshkë fringo të re". U lumturua, jo për veten, por për të birin... Të birin... Po Andi i saj ç'bënte tani, si i kish hallet? Përpara syve ju shfaq fytyra e tij tek flinte natën e fundit kur ajo kish hyrë në dhomën e tij... Po Elona? Mendimi se vajza e saj kish rënë në duart e asaj gruaje... e lemerisi. O Zot! U çua menjëherë e shkoi në dhomën e saj. Nxorri celularin nga çanta e bëri numrin e Pirros.

- Dua të shkoj në shtëpinë time! - tha dhe e mbylli. Kish frikë të zgjatej, mund të ndërronte mendje. Fundja, mos ishte e thënë se do të bëhej nesër. Ata nuk e dinin ende se çfarë duhej të bënin. Miri hyri në dhomë e ajo u alarmua. Siduhej të sillej me të tani që e dinte se... Ai e përqafoi dhe ajo ndjeu zemrën ti shkrihej. Kish aq shumë nevojë këtë çast për pak ngrohtësi e dashuri njerëzore... E la ta përkëdhelte e shijoi çdo prekje të tij... mendimi se do ta humbiste një ditë jo të largët, e bënte më të çmuar çdo çast pranë tij, e akoma... më të dëshërueshëm... më shumë se kurrë.

- & -

Ditët rrëshqisnin të ethëshme si dhe ankthi i saj. Ngjarjet e problemet rrëshqisnin po ashtu. Diskutimet e vendimet u bënë më të koklavitura. Duhej të ishte e sigurtë që ta kthenin në universin e saj e të mos e degdisnin në ndonjë tjetër, për këtë duhej t'i spjegonin se përse ajo mund të kthehej dhe të tjerët që ishin zhdukur nuk ktheheshin dot. Pirrua kish buzëqeshur, kish thënë se ajo ishte rasti i vetëm që kishte ndërruar vend me kopjen e saj, kështu që dinin destinacionin, të tjerëve nuk jua dinin. Ish vënë në kontakt me shokët e tij dhe plakat ishin përfshirë në projekt e shpresat ishin të mëdha. Ato perceptonin lutjet e të tjerëve, siç kishin

perceptuar lutjet dhe vuajtjen e kopjes së saj, e kjo i ndihmonte të lokalizonin vendin e të bënin llogari më të sakta. Do të hynin në kontakt me tjetrën, do ta thërrisnin mbi urë kur të vinte momenti. Pyeti nëse shanset ishin të mira, njëherë që kish vendosur, donte të bëhej sa më shpejt. Nuk është se nuk përjashtohen rreziqet, i ish përgjigjur ai duke e vështruar gjatë në sy. Do të bëhej një tentativë tjetër së shpejti, mbi të njëjtat parametra të atij të njëzetënëntë majit të saj, që të mos rrezikonte të hidhej në një univers të ndryshëm nga i saji. Mund të përfundosh mes dinosaurëve, ishte munduar të bënte shaka ai, por ajo ishte rrënjëqethur e kish shprehur frikë e dyshim.

- Nuk di ç'të të them, - i kish thënë Pirro pasi kish heshtur një copë herë kur kish pikasur frikën e saj, - në këtë pikë të këshilloj të heqësh dorë. E kam për zemër, jam i apasionuar pas kësaj pune e do të doja me mish e me shpirt të realizohej. Por jam i shqetësuar për ty, nuk do t'ja falja vetes nëse do të të ndodhte gjë.

- Jo, - u përgjigj ajo pasi dëgjoji rrahjet e zezës në krahëror, - dua ta provoj!

- Nuk më mbetet veçse të të lajmëroj kur të vijë momenti.

Me të mbaruar këto fjalë, ishte çuar e kish ikur. Kish qenë takimi i fundit i tyre për këtë çështje. E ndoqi me shikim tek doli nga kafeneja, të preokupuar e të dobësuar sa xhaketa dukej sikur ishte varur në një varëse. Dhe e gjitha për shkakun tim, qortoi veten ajo.

- & -

Tryeza ishte shtruar, prisnin Pirron që të uleshin. Festohej ditëlindja e saj, një ditë përpara dasmës, e kish kërkuar Agroni. Era e falenderoi me mendje, ndoshta ishte e fundit darkë ku do të ishin të mbledhur të gjithë. Ende asnjë lajm, por zemra seç i parandjente, do t'i vinte shpejt. Arbena që i buzëqeshte sa herë që u takoheshin sytë dhe ajo e imagjinoi të nesërmen në kishë veshur me të bardha... Zot, sa e bukur që është... Zemra e saj prej nëne u mbush me krenari për atë krijesë të mrekullueshme që të nesërmen do të bënte hapin e madh e befas u trishtua. E ajo tjetra... një xhelozë e paspjegueshme u shoqërua me një brerje të fortë ndërgegeje... Duhet të ishte ajo nesër dhe jo... Ktheu kokën nga ana tjetër dhe hasi sytë e babait. Ishin të shkëlqyeshëm tek e vështronin. Paptitmas u dëgjua zilja e celularit të tij dhe ai doli jashtë. I erdhi keq që e kish ngarkuar veten aq shumë me punë sa nuk e linin asnjë ditë të qetë. Në krye të rrugës u duk makina e Pirros. Arbena doli në rrugë e ju hodh në qafë sapo zbriti. Agroni hyri brenda dhe asaj nuk i shpëtoi tisi i shqetësimit mbi tiparet e tij, i kërkoi shikimin, por ai ju shmang. Nuk do të më shqetësojë mua, mendoi ajo dhe i ftoi të gjithë të uleshin në tryezë.

- & -

Asnjë darkë nuk kish qenë aq e bukur në atë shtëpi. Agroni e largoi shpejt atë hije preokupimi dhe e zbukuroi tryezën me batutat e shakatë e tij, duke i lënë me gojë të hapur të gjithë, nëna i buzëqeshte dhe herë pas here zgjaste dorën mbi tavolinë e kërkonte të sajën për t'ja përkëdhelur. Kështu kish bërë gjithnjë me të që kur ishte e vogël e kombinonte diçka të mirë. Miri i rrinte në krah, më i dashur se kurrë, sytë e Teutës shkëlqenin si fëmijë, Andi optimist me Zanën, Arbena me sy ëndërrimtarë e të lumtur krah Pirros, Elona e ëmbël e gazmore që nuk linte asnjë batutë të gjyshit të binte në tokë pa i kthyer përgjigje, ndërsa Sara me Dejvin... ishin më të mirët e botës për të. Një amvisë e mirë e din se kur afrohet rradha e tortës ndaj ajo u çua për ta marrë nga frigoriferi.

- Shpresoj të shprehësh dëshirën e duhur, – zëri i Pirros, i cili ishte ngritur dhe e kish ndjekur pas, nuk e fshihte një dridhje të lehtë.

- Je i vetmi këtu që e di dëshirën time, - pëshpëriti ajo, - shpresoj të mos pres tortën tjetër për ta përsëritur.

- Nuk do të presësh.

- Kur?

- Sonte, mes orës dy dhe tre të mëngjesit.

Sa nuk i ra torta nga duart. E rivendosi me kujdes në frigorifer e nxitoi në dhomën e saj, u ul mbi shtrat e shpërtheu në dënës. Nxorri nga rafti ditarët e saj, ishin katër. Mori një penë e në secilin kapak shkroi “Më fal baba!”. I mbështolli me kujdes ei futi në një zarf të madh. Sipër shkroi adresën e zyrës së Agronit. I futi në një çantë dhe i la pranë derës. Do t'i hidhte në postë rrugës kur të ikte. Hyri në banjë e i hodhi një grusht ujë fytyrës. Kur vendosi tortën mbi tryezë, sytë e saj ishin të shndritshëm por të kulluar. Ndezi qirinjtë dhe pasi mbajti një hop frymën sa i uroi rrugë të mbarë vetes, u fryu dhe i shoi nën duartrokitjet e zërat e tyre gazmorë. I përqafoi dhe i puthi të gjithë me rradhë e pastaj u ul pranë babait të saj me Sarën e Dejvin që nuk i shqiteshin. Nuk donte të humbiste asnjë çast, nuk do tii shihte më. Ju afrua Agronit e mbështeti faqen pas të tijës. Lamtumirë baba i dashur, tha me vete...

- & -

Priti sa e zuri gjumi Mirin dhe rrëshqiti nga shtrati, ora kish kaluar njëshin. U përkul dhe e puthi ngadalë mbi buzë, mori rrobat e shkoi të vishej jashtë

dhomës. Në majë të gishtërinjve hyri në të gjitha dhomat e i puthi të gjithë me rradhë. Në dhomën e Teutës nuk ja mbajti të futej, do ta gjente zgjuar e nuk dinte se ç'ti thoshte. Ledhatoi Bobon që e ndiqte pas, kish qenë mik i mirë, sidomos ditët e para kur kish vuajtur se nuk e donin më në familje. Ndërsa tani... e kish të vështirë të ikte, zemra i ishte çarë e kullonte gjak. Duhej të nxitonte, të kalonte nga shtëpia e babit, ta sodiste një copë herë nga jashtë. Ndezi motorrin e makinës duke lutur Zotin që zhurma e tij të mos zgjonte njerëzit e shtëpisë. Qëndroi disa minuta para shtëpisë së babait. Kishte dritë, ishte zgjuar. Kushedi ç'problem i ka dalë, mendoj ajo duke kujtuar telefonatën që kish marrë atë mbrëmje, dhe unë nuk e ndihmoj dot. U largua me lotë në sy. Kur mbërriti në plazh, ora ishte dy pa një çerek. Pirro e priste më këmbë në breg të detit. Ju afrua me hap të dridhur. Vetmia dhe trishtimi i tij i zgjoi frikë. E çmendur, i tha vehtes, ç'po bën? Mund edhe të vdesësh. Ai i qëndroi përkarshi.

- Shpresoja të mos vije.

Nuk u përgjigj një çast, edhe ky djalë do ti mungonte atje... Ju afrua dhe e përqafoi duke i uruar me zemër gjithë lumturinë që meritonte. U shkeput nga krahet e tij e beri nje hap pas.

- Ik! Pas pak orësh do të martohesh e duhet të pushosh pak.

- Nuk dua të të lë vetëm derisa...

- Ik!

Ai i mori dorën dhe ja puthi, pastaj u nis pa folur duke kthyer kokën pas herë pas here. Ndoqi me sy figurën e tij të zhytur në dritën e zbehtë të yjeve tek largohej derisa nuk e pa më. Psherëtiu dhe u ul mbi rërë. Tani ishte vetëm, vetëm dhe në pritje. Nga ana tjetër një hije ju afrua, por ajo nuk e vuri re se po shqyrtonte qiellin. Një yll, yll ju duk në fillim, sikur vinte duke u zmadhur. Të ishte...

- Era!

Brofi më këmbë e befasuar.

- Baba! C'bën... këtu?

Ai u afrua dhe i ndenji përballë.

- Si mund të të lija të ikje pa të përshëndetur.

Kuptoi në çast se ai i dinte të gjitha.

- Më fal, nuk isha ajo që mendoje.

- Ishe pikërisht ashtu siç të kam dashur.

- Si e more vesh? Ke vënë përsëri njerëz për të më spiunuar?

Ai heshti një hop dhe ajo pa se i kishte rënë pikës.

- Për të të ruajtur. Më fal!

- Të kam falur.

- E di, - tha ai dhe vuri buzën në gaz. Buzëqeshi dhe ajo.

U ulën mbi rërën e plazhi duke vështruar atë pikë të largët që zmadhohej. Nisi të ngrihej erë, në fillim si fllad i lehtë e pastaj më e fortë. Ndjeu të mbërdhinte,

mblodhi supet duke kryqëzuar krahët. Agroni hoqi xhaketën dhe ja hodhi krahëve. Ajo refuzoi, nuk donte që ai të merrte të ftohtë për shkak të saj, por ai këmbënguli. Futi krahët në mëngët e xhaketës, ndihej më mirë. Prania e tij i jepte siguri por nuk mund të fliste nga mallëngjimi. Ai i zgjati një kuti të vogël.

- Dhurata e ditëlindjes. Kish mbetur në çantën e nënës tënde.

Mori kutinë me duart që i dridheshin nga emocioni dhe e hapi. Një gjerdan, një byzylyk dhe dy vathë të zbukuruar me gurë të çmuar. Kushedi sa kishin kushtuar. Mbylli kutinë dhe ja ktheu.

- Nuk mund ta pranoj.

- Përse?

- Nuk jam jot bijë.

- Ti je ime bijë. Më ke dhuruar aq gëzim, sa jeta ime nuk ka patur kurrë kaq kuptim sa në këto katër vitet e fundit.- Agroni hoqi dhuratat nga kutia dhe ja futi në xhepin e xhaketës. Qëndruan ca çaste në heshtje.

- Sot mund të kthehet Era... tjetër - theu heshtjen ajo.

- E di, - zëri i tij ishte i preokupuar.

- Eshtë jot bijë, është... - desh t'i thoshte kopja e saj, - premtomë baba se do të sillesh mirë me të, po të jesh kaq i mirë...

Një vrundull ere i përfshiu, qielli dukej sikur do të çahet, një vrimë e zezë si një gojë e lemerishme po hapej në të. U çuan.

- Si ishte babai yt?

- I... mrekullueshëm... si ti.

Ai e kapi për krahu dhe e tërhoqi pranë vetes.

- Rri këtu! - zëri ishte lutës.

Ndjeu aromën e dashur të lëkurës së tij e ju kujtua se si dikur shkonte e u merrte erë rrobave të babait në raft që të qetësonte stuhinë e mallit të padurueshëm. Koha ja kish lehtësuar atë dhimbje e po ja hapte prapë. Goja e zezë ishte fare afër mbi sipërfaqen e ujit. Tani, mendoj, nëse nuk iki tani do të mbetem këtu. Mbushi mushkëritë me atë aromë të dashur lëkure, u shkëput me forcë prej tij e rendi drejt ujit. Ai e ndoqi pas.

- Ik! - i briti ajo tek ndjeu erën ti rrëmbente në fillim flokët e pastaj ta mbështillte të tërën e ta grinte lart. Ajri i mungoi në mushkëri tek filloi ta xhironte gjithnjë e më shpejt derisa u zhyt në terr...

- & -

Agroni e shikinte me tmerr tek zhdukej në atë vorbull terri. Dreqi ta hajë nuk duhej ta kisha lënë, mallëkoi ai me zë të lartë. Kush e siguronte se do të

dilte gjallë prej andej? E ai nuk mund ta ndihmonte, ishte i pafuqishëm para asaj goje të lemerishme. Këtu nuk hynin as paratë dhe as pushteti që mund të kishte mbi njerëzit. Ra mbi gjunjë dhe zgjati duart drejt qiellit duke u lutur. Njolla e zezë u zvogëlua larg derisa u zhduk e i la vend yjeve të shndritshëm. U çua e filloi të largohej ngadalë. C'do t'i thosh gruas, Mirit, Teutës, fëmijëve. .? Nuk ja falte vehtes që e kish lënë të ikte kështu. Befas era u ngrit sërish por në drejtim të kundërt. Një tjetër vrimë e zezë po zmadhohej. Mbajti hapin.

- Ja tek më ke, më merr dhe mua!- briti ai. Diçka u shkëput nga ajo gojë e ra jo shumë larg tij. Një siluetë gruaje filloi të ngrihej ngadalë.

- Era!? - një shpresë e vagullt u ndez në zemrën e tij.

Gruaja ishte ngritur më këmbë e afrohej tek era i ngrinte kindet e fustanit. Era kish veshur pantallona... nuk është ajo... Rendi drejt saj e shqoi tiparet e dashura që ngrinë një çast, çastin tjetër ajo ju hodh në qafë.

- Më kish marrë malli, baba!

Shtërngoi fort trupin e së bijës që dridhej.

- Shkojmë në shtëpi bijë! Edhe mua...

- & -

Ishte katandisur si mos më keq, i dhimbte gjithë trupi. Me mundim u kthye mbi kurriz. Befas një bori makine dhe zhurma e rrotave të një makine që frenoi gati ngjitur me ijën e saj.

- Pazza! Muoviti il cullo! Vatene!

Kjo nuk ishte gjuha e saj. U çua ngadalë duke rënkuar pa çarë kokën se ai burrë atje kish humbur durimin dhe e shante me sa zë kish. Duke çaluar ju afrua parmakut e u pështet në të. Poshtë ishte lumi pothuaj i tharë e i shëmtuar që zgjatej deri në det. Jakishte arritur, ishte kthyer! Ndenji dhe pak sa mori pak veten e pastaj mori rrugën për në shtëpi. Do të donte të vraponte por nuk mundej. Gjithë kyçet e trupit i dhimbnin, i dukej sikur do t'i zgjidheshin e gjymtyrët do t'i binin rrugës. Me ankth u afrua poshtë pallatit, po të mos ishte emri i saj aty? Ndezi dritën e shkallëve e ju afrua targetës së emrave. Zemra i rrahu fort, emri i saj ishte bri atij të Mirit. Po sikur... ajo tjetra të ishte aty brenda... Do ta marr vesh, tha me vehte, do t'i marr vesh të gjitha... Mbajti frymën e shtypi butonin e ziles. Porta e pallatit u hap, askush nuk pyeti se kush ishte. Fundja nuk kishin bërë gjithnjë kështu? Filloi

të ngjiste shkallët me zemrën që sa nuk po i çante krahërorin. Tek dera e apartamentit, Miri i buzëqeshi.

- Mirë që erdhe se u bëmë merak. Për pak do të dilnim të të kërkonim.

- & -

Ngjiste ngadalë e në heshtje shkallët e kullës së Pizës, një hap pas Miri. Ditëlindja e saj, plot një vit... një vit i vështirë plot me surpriza të zbuluara pak e nga pak... pa bërë pyetje. Nuk punonte më... që prej katër vjetësh...që prej asaj nate... asnjëri nuk dinte se ç'i kishte ndodhur atë natë që e kishin gjetur më shumë gjallë se vdekur mbi urë, të rrahur, të sakatuar, të mbushur me drogë. E kishin shtruar në spital ku kish marrë disi veten fizikisht por mendërisht... kish lajthitur. Fliste përçart e kishte aluçinacione, kërkonte fëmijë që i thërriste në emër e askush nuk i njihte, kërkonte babain e gjyshen e vdekur. Kishin dashur ta shtronin në psikiatri, por Miri e kish marrë në shtëpi dhe ishte përkujdesur për të. Kujdesi dhe dashuria e tij e kishin qetësuar e kish marrë rrugën e shërimit. Pastaj... Komplikacionet në veshka, pasojë e aksidentit të asaj nate kishin menduar mjekët, kish rrezikuar të vdiste. Elona i kish dhuruar një veshkë të saj. Era mbajti hapin duke dihaturmë shumë prej inatit e zemërimit, kur mendonte se ajo tjetra i kish marrë veshkën së bijës... ja kish falur të gjitha, edhe xhelozinë therrëse që i kish zënë vendin për katër vjet, por këtë nuk mund t'ja falte. Andi kish braktisur inxhenjerinë e kish filluar e mbaruar shkollën për infermieri, kështu të paktën e kish punën e sigurtë. Një rrudhë e thellë i brazdoi ballin. Para dy ditësh kish thënë se mund të inkuadrohej në trupat ushtarake për në Irak, pagesa ishte e majme. Duhet të kalosh përpara mbi kufomën time, i ish shkrehur ajo, nuk rris fëmijë unë që të vriten e të vrasin për interesat e të huajve. Ai nuk ish përgjigjur, e ajo kish frikë se ai e kish shtyrë për ta bërë në një moment më të përshtatshëm atë bisedë. Kurrë, tha me vete ajo e vazhdoi të ngjiste shkallët. Elona studjonte për fizikë. Vuri buzën në gaz tek e mendoi kërrusur mbi libra e dispensa. Miri u kthye drejt saj e i zgjati dorën. Kishin mbërritur në majë, e ai e dinte se asaj i merreshin mendtë në atë lartësi. Mbushi mushkëritë me ajër duke parë pejsazhin që hapej pas atyre shkallëve të ngushta. Fundja, tha me vete, jo keq, po të lëmë mënjanë ekonominë që e ngushton papunësia ime... dhe...

- & -

Sheshi i mrekullive... e la prapë pa frymë, ja tek ishte katedralja, batisteri, njerëzit poshtë që dukeshin të vegjël. Pëshpëritjet e ëmbëla të Mirit... Ndoshta sepse i bënte këtë efekt ky shesh, kish kërkuar të vinte sërish këtu. E kish bërë mirë, donte ta shijonte sa më shumë këtë çast, por sulmi i një kujtimi tjetër ja prishi magjinë e çastit. Para dy vjetësh... kish qenë pikërisht këtu me... Jo, kam bërë keq që erdha, nuk duhej të vija më... Kujtimet pasuan njëra tjetrën duke sjellë pyetjet torturuese, si janë, si e kanë hallin... Ato katër vjet, ish munduar t'i mbyllte thellë thellë në shpirtin e saj, e nuk i linte të dilnin në sipërfaqe, e ja tani... Dhimbja e malli e ngurtësuan trup e shpirt e Miri që ndjeu indiferencën e saj u largua pak i lënduar. Zot, u lut me vete ajo e duke bërë kryqin me mendjen e saj, më ndihmo! Veç një shenjë, një shenjë që janë mirë! Ju kujtua shenjti i profumeve e ju lut edhe atij. Pastaj kërkoi me sy Mirin dhe shkoi drejt tij. Nuk kish bërë ende dy hapa dhe u zhyt në aromë manushaqesh. Një hap tjetër, një tjetër aromë e njohur, profumi i babait të saj që përdorte pas rrojës. Mendoj se mos ndoshta këtë profum e kish hedhur ndonjë nga turistët e pa rrotull. Nuk kish njeri afër për momentin, turistët ishin mbledhur përreth ciceronit, por profumi lëvizte me ajrin në drejtim të kundërt të tyre. E ndoqi dhe ndjeu erën e lëkurës, të dobët, por ishte ajo, nuk mund ta ngatërronte. Baba, klithi ajo brenda vetes e zëri ju kthye me oshëtimë. Ai ishte aty, në universin e tij paralel me të sajën, por këtë moment ishte aty, mbi kullën e Pizës. Ndoqi gjurmën që linte pas aroma duke zbritur nëpër shkallë. Aroma e tij u përzie me profumin e nënës, e dallonte mirë. Mprehu veshët me shpresë se... asnjë zhurmë veç hapave të saj, turistët e grupit kishin mbetur lart. “Baba”, e thirri ajo me zë të ulët. Asnjë përgjigje, zbriti poshtë e doli jashtë. Një grup tjetër turistësh, prisnin rradhën të hipnin lart. Shau me vete, kish humbur gjurmët, nuk i ndjente më. Erdhi një copë herë rrotull duke nuhatur ajrin me flegra të hapura, por më kot. U ul mbi bar e ja plasi të qarit, nuk mund t'i harronte, i mungonin Dejvidi e Sara, Arbena, të gjithë. E kish marrë malli edhe për Bobon. Kujtimet edhe mund t'i fshihte në ndonjë cep truri, por... atë mall e dashuri që i ngrihej nga shpirti... Ishte zemra që nuk donte t'ja dinte për kufij, as ato të paimagjinueshmet e të pamundurat. Ishte kjo që i shkaktonte dhimbje, përpjekja për t'i harruar. Nuk do t'i shihte më, për këtë ishte e sigurtë. Por nuk do të përpiquej ti harronte më, dashuria për ta, ishte shumë e çmuar për tu lënë në harresë.

- Mira çfarë ke? Nuk ndjehesh mirë?

Miri nuk mori përgjigje e u ul mbi bar pranë saj. Ishte mësuar tashmë me sëmundjen e së shoqes. Mendja, herë herë e braktiste e endej larg, shumë larg tij, në botëra të tjera imagjinare. Para katër vjetësh fliste veç për to. Tani nuk i zinte në gojë e potë mos ishte për ato momente ku e shihte të përhumbur, me sy të mbushur me dhimbje, do të mendonte se ishte e shëruar. Dhe ai e priste me durim

me atë brerje ndërgjegjeje se kish qenë ai në një farë mënyre shkaktari... duke soditur ata sy të bukur, derisat'i nënqeshnin. Rrezet e diellit në të perënduar lanin fytyrën e saj jo aq të përsosur dhe të bukur sa të skulpturave që kishin parë atë ditë, por kish diçka që ato nuk e kishin... jetë... ndjenjë... mirësi. Papritmas ajo fytyrë u kthye drejt tij dhe i buzëqeshi ëmbël. Ishte gjithnjë emocionues ky moment... Sikur e kish humbur dhe... e kish gjetur prapë...

- & -

E lodhur fizikisht e shpirtërisht nga ç'kish përjetuar, dremiti që në fillim të rrugës së kthimit. Ishte sërish mbi kullën e Pizës tek sodiste pejsazhin e sheshin e mrekullive. Vuri re se Miri nuk ndodhej pranë saj e filloi ta kërkonte me sy mes turistëve që shikonin të mrekulluar sheshin e bënin fotografi. E pa e desh të shkonte drejt tij, këmbët i ngrinë. Miri... i kish hedhur krahun mbi supë një gruajë tjetër e u buzëqeshte dy fëmijëve adoleshentë. Gruaja... nuk ish tjetër veçse... ajo vetë e veshur ndryshe, e ata fëmijë ishin... Sara me Dejvin. Fiksoi me habi e kërshtëri përcëlluese atë profil që u kthye drejt saj e i buzëqeshi duke e lënë pa frymë nga tronditja. Më sheh vallë?! Ajo po i vinte përballë e Era nuk dinte se si të sillej me të duke numëruar pa dashje hapat që i ndanin, tre... dy... një... zemra pothuaj nuk i rrihte më e mbylli sytë. Kur i hapi gruaja i kish kaluar përmbri e gjendej pranë... Ai shikim i ëmbël e zhbirues njëkohësisht, ra mbi të... Baba, pëshpëriti ajo, por zëri i ngeci diku në fund të shpirtit. Tjetra u largua përkrahu me nënën, ndërsa ai erdhi e qëndroi pothuaj ngjitur me të. Ishte në gjendje të shquante çdo tipar, rrudhë e qerpik në atë fytyrë të dashur, e të ndjente atë shikim deri në skaj të shpirtit. Por ai shikim u largua prej saj në një kërkim të ethshëm përfaqë e një vel trishtimi e mbuloi. Befas, ngriti pak kokën lart duke nuhatur ajrin.

- Era, ku je moj bijë!? - dëgjoi zërin e dashur.

- Jam këtu baba! - briti ajo duke brofur në sediljen e makinës. Miri e pa me bisht të syrit e ajo kuptoi se kish folur në gjumë. Nuk dinte nëse duhej t'i gëzohej kësaj ëndrre të bukur apo duhej të shqetësohej sepse po fillonin sërish...

- & -

U mundua të mos dremiste më. Ndërroi nja dy fjalë me Mirin e kërkoi të gjente në radio ndonjë muzikë që i pëlqente. "Let me go home", zëri i Bubles vërshoi e përmbysi tërë qenien e saj. Home... Ku ishte shtëpia e saj? Pas nja treqint kilometrash, ju përgjigj me ton qortues vehtes. Nuk e kisha fjalën për të, u

justifikua ajo, desha të them ku e ka shtëpinë shpirti... i imi... Lëre kot flas me ty, u grind me veten. E mërzhitur shikoi autostradën që dukej pa mbarim e dritat e makinave që i vinin përballë. Si yje lëvizës, jo, si ufo... Ekzistojnë vallë? Ngriti sytë nga qielli i mbushur me yje duke hapur gojën. Sa gjumë kish...dhe sa ftohtë.

- Si nuk mora një triko me vehte, kam ftohtë, ky kondicioneri...

- Kam marrë unë një xhaketë, e ke në sediljen prapa,- tha Miri.

Mira zgjati dorën dhe e mori. E hodhi krahëve dhe profumi e sulmoi pa i lënë kohë të mendohej e lotët ju mbloodhën në grykë.

- Ku e gjete këtë xhaketë?

- Në raft ku tjetër.

- Përse këtë?

- Përse jo, ishte e para që më ra në dorë.

Nuk foli nga frika se zëri do ta tradhëtonte e do t'ja shkrepse të qarit. Ja kish hedhur mbi supe atë natë... kur kish dashur t'i jepte dhuratën e ditëlindjes që ajo ja kish kthyer. Aromë manushaqesh, thithi ajrin e mbushur me të dhe me profumin e xhaketës.

- Ke të drejtë, kam pirë shumë cigare,- u shfajësua Miri.

- Nuk e kam për cigaren, e ndjen erën e manushaqeve?

- Jo.

- Unë e ndjej,- vuri buzën në gaz ajo e futi duart në xhepat e xhaketës. - Ke dëgjuar për atë fratin e shenjtë që shfaqet... - pak nervoze që kish nisur atë diskutim me të shoqin që nuk u besonte gjërave të tilla, rراسi duart thellë në xhepa e fjala i mbeti në mes.

- Si ishte puna e atij shënjtë? - e ngacmoi pas pak Miri.

Nuk mori përgjigje dhe e shikoi me bisht të syrit. Dhimbja derdhej me sumbulla loti nga sytë e saj, ndërsa buzët formuan një buzëqeshje e cila u rrit e shpërtheu në të qeshur kumbuese.

- C'ka për të qeshur... e për të qarë?- u çuditur ai.

- C'duhet të bëj tjetër? - në duart e saj shndrinte një gjerdan e në prehër i derdhej një kaskatë diamantesh verbues nga një qese e vogë kadifeje. Humbi drejtimin e timonit e për pak u përplas në autostradë...

- & -

Shtëpia ishte e gjitha rrëmujë . Era lëvizte mes kutive, diçka shtonte e diçka tjetër hiqte, edhe se ishte e ndërgjegjeshme se shumë prej atyre sendeve kishin vetëm vlerë afektive. Tashmë kish mundësinë t'i blinte nga e para, paratë nuk mungonin. Andi me Elonën ishin rregjistruar në universitet më të mira, ndërsa ajo me Mirin do të kthehej në atdhe. Hapi kanatet e raftit dhe i hodhi një sy përciptas garderobës së saj. Vetëm nja dy plaçka, të tjerat do t'i linte. I zhvendosi rrobat e

varura me rradhë duke sjellë ndërmend për secilën, momentin që e kish blerë. Në fund ishte xhaketa, e kish fshehur aty se nuk donte t'ja prekte askush. Zhyti fytyrën në të dhe i mori erë. Si dikur... nëna ja kish marrë e ja kish fshehur e ajo kish qarë..... aromë lulësh në ajër... I kontrolloi me të shpejtë xhepat edhe se ishte e sigurtë se nuk kishte mbetur gjë aty. E... duhej të kish, diçka që i rrëshqiste, e pakapshme, magjike si ai profumi i lehtë. Tinguj melodiozë erdhën nga shtëpia e fqinjës... “let me go home”... Home... Ku është shtëpia e shpirtit tim, pëshpëriti pa dashje dhe u kujtua se ja kish bërë edhe një herë këtë pyetje vehtes. E palosi dhe e vuri në valixhen e saj mbushur dëng dhe u mundua ta mbyllte me forcë. Dëgjoi një fëshfërimë të lehtë e mendoi se i bënë veshët. Orvajtja e dytë e siguroi se vinte nga xhaketa. Duhej ta kisha parashikuar, mërmëriti ajo, im atë më njihte, nuk janë paratë... Ndoshta gabohej, ai nuk ishte babai i saj i vërtetë. Megjithatë, me një farë brerje të ndërgjegjes nisi të shqephte astarin. Nuk kish gjë, ndaj mori gjilpërën me fill dhe e tendosi mirë që të mos i bënte rrudhë. Ndjeu zhurmën e lehtë në gishta. Ajo që i ishte dukur si kanavacë... ishin një mori fletësh të holla, transparente si cipa e qepës. Mori me kujdes të parën dhe e vendosi mbi xhamin e dritares. Kaligrafia e Agronit... ju këputën gjunjët dhe lëshua mbi shtrat.

- & -

Bija ime!

Kam shumë pak kohë për të shkruar këto rreshta, edhe se kam muaj që përgatitem për këtë çast të dhimbshëm. Do të më falësh që kam lexuar ditaret e tua që kur ke filluar t'i shkruash, mendoja se ishin fryt i fantazisë tënde e Zoti e din sa kamshpresuar të ishte. Nuk të kam rënë në sy e nuk të kam ndërhyrë, pasi njoh zemrën tënde, e cila nuk do të linte të veproje ndryshe. Nisur nga ato që kam lexuar, jam munduar të të siguroj disa materiale që do të kenë vlerë për njerëzimin atje, dhe bindjense do të gjesh mënyrën që të bien në duar të sigurta. Nuk janë kushedi se çfarë, diçka për sidën, kancerin e sëmundje të tjera që nuk janë problem për t'u kuruar këtu, ndërsa Pirro nëpërmjet shokëve të tij ka mundur të shtijë në dorë pothuaj të gjithë punën e projektit sekret të Zvicrës që të dha mundësinë për të provuar të kthehesh pranë të dashurve të tu. Nuk dua të më falenderosh, merre si një suvenir nga babai yt, që lut Zotin t'ja arrish asaj që dëshëron. Të jam mirënjohëse për gjithçka ke bërë për nee... shpresoj që “kopja” të kthehet e të më japë mundësinë të korigjoj gabimet e mia. Them “kopja” se kështu e ke shprehur

në ditaret e tua, por mendimi im është ndryshe. Për mua jeni të njëjta edhe se shfaqeni ndryshe në karakter, thelbësor është shpirti. Ndryshe nuk mund të spjegoj lidhjen tënde shpirtërore me fëmijët, Mirin, nënën, Teutën dhe me mua. Kthehu bijë në tokën tënde, atje janë rrënjët e shpirtit tonë, atje... ndoshta do të ndjehemi më afër. Kur të ndezësh qiri mbi varrin e babait, më mendo dhe mua si pjesë e tij.

Me dashuri Babai yt.

P.S. Nëse kam arritur të të njoh siç duhet, do ta gjesh këtë letër. Ditëlindjen tënde të ardhëshme, do të jem në Sheshin e Mrekullive... edhe se nuk i besoj mrekullitë, do ta ndjej praninë tënde po të jesh aty... Merre si takim.

- & -

Nata e fundit. Kundroi yjet që digjeshin ethshëm si shpirti i saj i trazuar. Letrat i kish futur sërish në xhaketë, e kish qepur dhe e kish mbyllur në valixhen e saj. Suveniri i Agronit ishte me vlerë të madhe, e kish ekzaltuar për momentin, kish dashur të dilte në rrugë e të bërtiste me të madhe... pastaj e kish ndarë mendjen të mos nxitohej. Mund të binin në duar hipokrite që do të mendonin përfitimin se sa ndihmesën e njerëzve në nevojë. Le të rrinin dhe pak aty, ato që i përkisnin mjekësisë, do t'ja besonte Andit, kujt më shumë se sa atij. Ndërsa ato të fizikës e të urave lidhëse me... mund t'ja besonte Elonës, por... nuk ishte dhe aq e sigurtë. Mendoj peripecitë që kish hequr dhe sa vuante akoma. Kushedi se sa botë të tjera paralele ndodheshin në Univers. Si do të ishte në to, ç'jetë bënte? Trupi ju mbush me mornica dhe u tmerrua kur mendoj se ç'telashe mund t'i hapte ky kuriozitet. Universi është kaq i madh e i pafund, mendoj, njeriu është kaq i... vogël, zemra e tij mezi mban dashuritë e dhimbjet e një jete e jo më... Agroni kish të drejtë, nuk ishin thjesht kopje fizike, ishte problem zemre dhe shpirti... Ajo tjetra... E kish gjykuar, ishte bërë xheloze për të, e kish marrë inat por kurrë nuk e kish urreyer... Thellë në zemër e ndjente se ajo ishte e mirë, madje më e mirë se vetë ajo. Me gjithë gabimet që kish bërë në jetën esaj, asnjë nuk mund t'i afroresh ndoshta të vetmit gabim që kish bërë ajo, më të shëmtuarit e më të pariparueshmit...